



OKI NDIHMON KOSOVËN

Miratimi i një rezolute në mbështetje të Kosovës dhe dialogu diplomatik për përsheptimin e procesit të njohjes së shtetit të pavarur të Kosovës, ishte objektivi kryesor i delegacionit të Shqipërisë gjatë punimeve të Sesionit të 36-të të Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme i Organizatës së Konferencës Islamike. Shqipëria u përfaqësua në këtë sesion, të zhvilluar nga 23-25 maj 2009 në Damask të Sirisë, nga një delegacion i kryesuar prej ministrit të Punëve të Jashtme, z. Lulzim Basha. Në një deklaratë për shtyp, e lëshuar nga Ministria e Jashtme, mësohet se në këtë kontekst ministri Basha zhvilloi një sërë takimesh me drejtues të OKI-së dhe me një pjesë të mirë të homologëve të tij. Gjatë fjalës së mbajtur nga ministri ynë i Jashtëm në seancën plenare të Këshillit të Ministrave të Jashtëm të OKI-t, çështja e Kosovës zuri vendin themelor. Ministri Basha mes të tjerash theksoi se: "që nga 17 shkurti 2008, Kosova është bërë dëshmitare e zhvillimeve rrënjësore drejt progresit". Nga deklarata e Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë mësohet se në seancën përmbyllëse të Samitit të ministrave të vendeve të Konferencës Islamike, zhvilluar më 25 maj paradite, u miratua me unanimitet të plotë rezoluta për pavarësinë e Kosovës. Sidoqoftë, beteja për miratimin e rezolutës ka të paktën tre muaj që zhvillohet nën tavolina. Tirana zyrtare, ajo që propozoi rezolutën, ka lobuar fort me Arabinë Saudite dhe vende të tjera islamike për miratimin e saj. Rezoluta e iniciuar nga Shqipëria, në të cilën evidentohet qartë se që nga shpallja e pavarësisë më datë 17 shkurt 2008, Kosova ka bërë progres në shumë sfera, ka krijuar kuadrin e nevojshëm ligjor dhe institucional bashkëkohor, ka kontribuar në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon. Më tej, kjo rezolutë, e cila është e para e miratuar nga OKI-ja që pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, u bën thirrje vendeve anëtare të Organizatës dhe bashkësisë ndërkombëtare në përgjithësi, që të vazhdojnë të mbështesin forcimin e Kosovës dhe ekonomisë së saj.

Rezoluta, e votuar nga të gjitha vendet e OKI-së, edhe nga ata që nuk e kanë njohur pavarësinë, e Kosovës, demonstroi se Kosova e pavarur është një realitet i pakthyeshem dhe njohja ndërkombëtare e saj një proces i pandërprerë. Republika e Kosovës është njohur nga 60 shtete, 13 nga të cilat janë vende të kësaj organizate dhe të tjera pritet ta njohin së shpejti. Ajo ecën e sigurt dhe e vendosur përpara drejt konsolidimit të shtetit, zhvillimit ekonomik, anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare dhe integritit në strukturat evropiane e euroatlantike.

Redaksia

AKTUALE

Njohja e pavarësisë së Kosovës nga Arabia Saudite **3-5**

“Të shkruajmë dhe të përkthejmë drejt” **5-6**
Gruaja e parë që projektoi një xhami **7-9**

KËNDI IM

Fitneja e pasurisë **10-11**
“Epoka e sandviçit” **11-13**
I forti edukon me urtësi **14-16**

AKIDE

Çdo gjë e kemi krijuar me kader **17-21**

FIKH

Ku e kam babin!? **21-24**
Të drejtat e fëmijës në islam **24-27**

AVANCIMI PERSONAL

Kur do të fillosh? **27-32**

LIBRI

Prezantim i librit “Përmbledhje për fëmijë - historia e Pejgamberëve” **33-34**

FAMILJA

Nënë, më rrëfe për Pejgamberët **35-37**
Mbroni fëmijët tuaj **37-39**
Bëje një njeri! **40-41**

TEFSIR

“Shpëtojeni veten dhe familjen tuaj” **42-45**

HADITH

O djalosh, ruaje Allahun... **46-50**

BOTA ISLAME

Emiratet e Bashkuara Arabe (U. A. E.) **51-53**

FETVA DHE KONSULTIME

Rreziku që na kanoset nga filmat vizatimorë **54-58**

HISTORI

Heronj dhe heroizma **59-60**

REDAKSIA

Omer BERISHA – kryeredaktor
Anëtarë të redaksisë:

Ahmed KALAJA, Bekir HALIMI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Ali SHABANI, Ismail BARDHOSHI,
Talha KURTISHI, Bledar HAXHIU, Sedat SHABANI, Agron TERZIQI, Lulzim SUSURI, Genc PLUMBI, Zeki ÇERKEZI,
Enver AZIZI, Bashkim BAJRAMI, Bilal TEQJA.

Bashkëpunëtorë: Ekrem AVDIU dhe ENIS RAMA

Roald HYSA – redaktor gjuhësor

Halil BERISHA – redaktor teknik

Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio) - ballina

Sedat RAMADANI - shpërndarje dhe marketing

Boton: Albislam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000
email: revista@albislam.com

sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)
e-mail: albislam.abonues@gmail.com

ALBISLAM DOOEL


Xhironlogaria: 300000002770453

Komercijalna Banka A. D. – Skopje

Numri tatimor: 4030008038784

Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit
PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në www.revista-albislam.com

NJOHJA E PAVARËSISË SË KOSOVËS NGA ARABIA SAUDITE



Qëndrimi saudit do të kontribuojë për një varg njohjesh arabe të tjera, e sidomos nga vendet e Gjirit Persik , meqë Arabia Saudite është një shtet shumë i rëndësishëm në rajon dhe gëzon një reputacion të lartë politik dhe shpirtëror në botën arabe

XHEMAL SULTAN¹

Initiativa e fundit e Arabisë Saudite për ta konfirmuar njohjen e shtetit të Kosovës paraqet një pikë kthese shumë të rëndësishme në ndihmën e çështjes madhore të popullit musliman të Kosovës. Gëzimi i madh që solli deklarimi i Arabisë Saudite për pavarësinë ishte i dukshëm në qarqe të ndryshme të Kosovës, tek masa e popullit dhe ajo e zyrtarëve. Disa prej tyre madje i kam parë drejtpërdrejt nëpërmjet disa personaliteteve kosovare. Burim gëzimi nuk ishte vetëm fakti, se numri i shteteve që njohën shtetin më të ri deri atë ditë arriti në 58, mirëpo çështja lidhet me thyerjen e pengesës së hezitimit dhe shqetësimit që mbretëronte në botën arabe karshi njohjes së shtetit të Kosovës. Ky shqetësim rezultoi me mosnjohjen e shtetit të ri musliman nga asnjë shtet arab, me përjashtim të Emirateve të Bashkuara Arabe, në kohën kur Kosovën e patën njohur si shtet të pavarur më se 22 shtete të Bashkimit Evropian, si dhe në listën e shteteve që e njohën Kosovën gjendeshin SHBA-ja, Britania, Gjermania, Franca, Portugalia, Italia, Holanda, Turqia etj., shtete këto të pa marginalizuara, por përkundrazi që kanë peshën e tyre të rëndësishme në fushat politike, ekonomike,

sociale etj.

Në anën tjetër, aleatja historike e serbëve Rusia po bën presion ndërkombëtar të intensifikuar, e sidomos në botën arabe dhe atë islame për ta penguar njohjen e pavarësisë së Kosovës, për ta ndihmuar pozicionin serb, për ta përfshirë Kosovën në kuadër të Serbisë së “Madhe” etj.

Disa shtete arabe provuan t’i shmangen kësaj situatë të vështirë duke parandaluar ballafaqimin me fanatizmin rus në këtë çështje, gjë që paralizoi njohjet arabe për një vit e më tepër, kur dihet mirë që shpallja e pavarësisë së Kosovës kishte ndodhur më 17 shkurt të vitit 2008. Në këtë kontekst kemi mundësi ta kuptojmë seriozitetin dhe rëndësinë e hapit të ndërmarrë nga Arabia Saudite në çarjen e barrierës së hezitimit dhe në njohjen e pavarësisë së Kosovës, për shkak se qëndrimi saudit do të kontribuojë për një varg njohjesh arabe të tjera, e sidomos nga vendet e Gjirit Persik², meqë Arabia Saudite është një shtet shumë i rëndësishëm në rajon dhe gëzon një reputacion të lartë politik dhe shpirtëror në botën arabe. Prej këtu vjen rëndësia e dyfishtë për hapin e ndërmarrë të Arabisë Saudite për sa

¹ Publicist dhe analist egjiptian.

i përket çështjes së popullit musliman të Kosovës.

Realisht në qarqet kosovare mbretëronte një gjendje e rëndë zhgënjimi nga qëndrimi i Botës Islame, e sidomos kur disa shtete jo vetëm që nuk kishin refuzuar njohjen apo azhurnuar atë, siç kanë vepruar shumë shtete, por ato edhe shfaqën gatishmërinë për të asistuar Kosovën ndërkombëtarisht në përballje me barbarinë serbe kundër interesave të popullit të Kosovës. P.sh. qëndron e hapur tani çështja, të cilën e ka ngritur Serbia në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë rreth interpretimit të Gjykatës për legjitimitetin e pavarësisë të Kosovës. Serbët dhe kosovarët tanimë i kanë paraqitur faktet e veta ligjore dhe historike.

Është brengosës fakti kur një shtet islamik (deklarativisht) siç është Irani, me vetëiniciativë dhe vullnetarisht paraqitet me dokumentin e vet ligjor dhe politik në Gjykatën Ndërkombëtare, ku akuzon popullin musliman të Kosovës, kritikon vendimin për shpalljen e pavarësisë, propagandon refuzimin e të drejtës së Kosovës për pavarësi dhe mbron dokumentin serb në Hagë. Kjo është një sjellje politike absolutisht johumane dhe është vështirë ta interpretosh nga aspekti moral. Ti mund mos ta njohësh pavarësinë pasi je nën presionin e Rusisë, mund të heshtësh, mund ta azhurnosh këtë çështje, por të paraqitesh vullnetarisht me një dokument armiqësor kundër vuajtjes së një populli musliman, të cilit i është rritur shpresa e arritjes së pavarësisë dhe ta dorëzosh atë në Gjykatën Ndërkombëtare, kjo gjë padyshim është vetë zhgënjimi. Profesori kosovar **Beqir Ismaili**, i cili është përfaqësues zyrtar i Republikës së Kosovës tek shtetet e Botës Islame më ka thënë mua se shumë njerëz në botën arabe mendojnë se Kosova dëshiron të ndahet nga një shtet,

pjesë e të cilit ka qenë, e ajo është Serbia sipas asaj që është e përhapur. Mirëpo realiteti është krejt ndryshe, sepse Kosova ishte republikë, që gëzonte autonomi të plotë në kuadër të Federatës Jugosllave. Ajo ishte njësoj si vetë Serbia. Kur u shpërbë Jugosllavia ishte krejt e natyrshme që republikat e formuara ta ruanin pavarësinë e tyre, siç ndodhi me Slloveninë, Kroacinë, Bosnjën, Malin e Zi, Serbinë etj. Ai ka pohuar se me serbët nuk i lidh asgjë nga asnjë anë; as gjuha, as feja, as historia, as kultura, as kombi, as etnia dhe asgjë. Ai nuk harroi të apelojë tek bota islame me të gjitha institucionet e saj kulturore; zyrtare dhe ato private që të ndërtojnë ura lidhëse me popullin e Kosovës, duke përmendur se banorët e Kosovës dhe të Shqipërisë – ku Kosova është pjesë e Shqipërisë historike – kanë pasur kontributet e tyre të mëdha në fe dhe politikë në Botën Islame. Prej tyre ka pasur personalitete të shquara, që janë të njohura tek ju, siç janë dijetari i madh **Muhamed Nasirudin Albani**, pastaj hoxhallarët **Shuajb Arnauti**, **Abdulkadër Arnauti**, **Vehbi Gavoçi**, si dhe emra të tjerë të shumtë. Po ashtu gjatë Perandorisë Osmane, vazhdon ai, kishte prej atyre vendeve më shumë se 50 sadriazema (kryeministra). Kjo histori e bujshme, thotë Ismaili, ka nevojë për një rikthim dhe lidhje para se ta humbim vetëdijen e popullatës muslimane në Kosovë, e cila përfshin mbi 95% të popullatës kosovare, e cila tani është nën trysninë e madhe kulturore dhe arsimore të Perëndimit, të cilave u prijnë me mijëra qendra kulturore dhe kërkimore, shtetërore e private. Sido që të jetë hapi i Arabisë Saudite për njohjen e pavarësisë së Kosovës është një punë e mbarë dhe hap shumë dyer shprese për vëllezërit tanë në Kosovë dhe në tërë Ballkanin. ■

Nga arabishtja:
Muhamed DËRMAKU

² Në esencë ky gjë quhet Gjiri Arabik, por të ndikuar nga përdorimi i fjalorit gjeografik të Iranit, edhe bota perëndimore e quan si Gjiri Persik. Në OKB në një nga gjuhët zyrtare, gjuhën arabe përdoret ashtu siç e quajnë arabët, si Gjiri Arabik. (Sh. P.)

“TË SHKRUAJMË DHE TË PËRKTHEJMË DREJT”

OMER BERISHA

Duke u nisur nga domethënia e fjalëve të Allahut: *“Ne nuk kemi çuar asnjë të dërguar, përveçse në gjuhën e popullit të tij, për t’u shpjeguar atyre (shpalljet e Zotit) e pastaj Allahu e shpie në humbje kë të dojë dhe e udhëzon në rrugë të drejtë kë të dojë. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti”*; redaksia e revistës Albislam, më 02-03 Maj 2009 mbajti një seminar dyditor në Tetovë mbi gabimet gjuhësore të përkthyesve dhe të artikullshkruesve në gjuhën shqipe me titull: **“Të shkruajmë dhe të përkthejmë drejt”**.

Aty morën pjesë shumë hoxhallarë nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, si dhe emra të mirënjohur të letrave dhe të lëvrimt të gjuhës shqipe, poetët dhe publicistët Fatmir Baçi, Ervin Hatibi, Roald A. Hysa dhe Agim Baçi.

Gjatë debatit rreth temës “Rregullat e përkthimit”, ligjëruesi **Fatmir Baçi** theksoi rëndësinë e përkthimit të drejtë, e sidomos të përkthimit të fjalëve të Allahut dhe shpjegimeve të tij. Ai foli gjerësisht mbi psikologjinë e përkthimit dhe të përkthyesit, si dhe përvojën e tij personale gjatë punës. “Nëse duam të shkruajmë një tekst të mirë duhet saktësisht t’i përgjigjemi pyetjeve: Çka do të shkruash? Kujt ia dedikon? Ku do ta botosh? Pse do ta



publikosh atë temë” shprehet **Agim Baçi** në ligjëratën e tij “Si shkruhet një tekst”. Agim Baçi iu përgjigj gjerësisht interesimit të dëgjuesve për problemet e publicistikës. Poeti dhe publicisti **Ervin Hatibi** në ligjëratën e tij trajtoi problemet e të shkruarit drejt të shqipes si i një roli parësor në komunikimin me publikun e gjerë, po ashtu edhe si element përbashkues në të gjitha trojet shqiptare pa dallim.

Problemet gjuhësore gjatë përkthimit dhe shkrimit të artikujve u trajtuan nga redaktori gjuhësor i revistës **Roald A. Hysa**, i cili trajtoi rrugët e hyrjes së fjalorit të huaj dhe të atij terminologjik, ndërsa në ditën e dytë të seminarit ai trajtoi problemet e përkthimit dhe ato gramatikore që i janë paraqitur gjatë punës. Secili nga pjesëmarrësit paraqiti pyetjet sipas përvojës së tij gjatë punës dhe konkretisht për problemin e shfrytëzimit të fjalorëve foli **Bekir Halimi**. Më pas u kalua konkretisht në problemet e hasura gjatë punës. Duke marrë parasysh vërejtjet dhe propozimet e ligjëruesve, si dhe duke parë gjendjen e librave, shkrimeve apo përkthimeve me tematikë fetare Islame, ku secili thuajse bën një transliterim vetjak, redaksia e pa të arsyeshme të bëjë një mbledhje për të vendosur disa standarde gjuhësore, që fillimisht do t’i ndjekë revista AlbIslam me shpresën që edhe revistat e tjera, si edhe shtëpitë botuese ta ndjekin një rrugë të tillë, kështu që bashkërisht të kontribuojmë për njësimin e gjuhës së shkruar fetare Islame shqipe.

Konkretisht, bëhet fjalë për:

a. Fjalë, të cilat në origjinalin e tyre (në arabisht) kanë teshdid (dyfishim i shkronjës), në shqip do të shkruhen pa teshdid, sepse gjuha shqipe nuk ka teshdid. P.sh. Allah (jo All-llah), Abas (jo Abbas) e kështu me radhë.

b. Disa fjalë arabe që tashmë janë bërë pjesë e gjuhës shqipe do të mbeten të atilla, edhe pse ndryshojnë nga origjinali, si p.sh. dynja (në vend të “dunja”), risk (në vend të “rizk”) namaz (në vend të “salat”) etj. Përfundim nga ky rregull bën fjala musliman, që do të shkruhet “musliman” dhe jo “mysliman”.

c. Fjalët që në origjinal kanë shkronjën ع (ajn) gjatë transliterimit – deri më tani “ajni” është shkruar me apostrof (‘). P.sh. emri سعد është shkruar: Sa’d, gjë e cila u vlerësua e panevojshme, sepse ai që nuk e shqipton “ajnin” dot, apostrofi nuk i bën dobi. E njëjta gjë vlen edhe për hemzen (أ) . P.sh. Kuran (jo Kur’an), Sad (jo Sa’d) e kështu me radhë.

d. Rreth transliterimit të shkronjës و u bë një debat i gjerë dhe në fund u vendos: Kur shkronja و, pas transliterimit gjendet mes dy zanoreve, do të shkruhet “v”, ndërsa kur gjendet afër një bashkëtingëlloreje, atëherë shkruhet “u”.

P.sh. fjala: توبة – pas transliterimit: teube – pra, pasi erdhi afër bashkëtingëllores “b” do të shkruhet: teube, (jo tevbe); e ngjashme me këtë është edhe: teuhid, teurat, etj.

Emri: نوءي – pas transliterimit: Ne uoe – pra, pasi erdhi mes dy zanoreve, do të shkruhet: Neveui (jo Neueui).

e. Lavdërimet dhe bekimet për Pejgamberin në transliterim do të shkruhen: **sal-lallahu alejhi ue selem**. Viza te “sal-la...” nuk është venduar për zëvendësim të teshdidit në origjinal, por për shkak të ikjes nga kuptimi i fjalës “sala”(pa teshdid) që d.m.th. e dogji ndërsa “sal-la...” e lavdëroi. ■

GRUAJA E PARË QË PROJEKTOI NJË XHAMI

Të vazhdojmë me këndvështrimin prej perëndimori; në një Turqi së cilës është problem t'ia caktosh kallëpin, kur bëhet fjalë për një xhami me një projekt, ku tradicionalja përzihet me modernen. Dhe kjo nuk mjaftoi. Ajo që në të vërtetë shtoi përmasat e lajmit ishte se projektuesi i kësaj xhamie është një grua...

SHKRUAN: PËNAR ÖGÜNÇ

Për një kohë të gjatë u bë fjalë për këtë lajm. **Zejnep Fadëllëoglu** do të projektonte brendinë e xhamisë **Shakirin**, që do të ndërtohej nga familja Shakir, ku do të bashkohej modernia me tradicionalen. Para se të hapej xhamia për kryerjen e ibadeteve më 8 Maj 2009 ne u takuam me znj. Fadëllëoglu dhe biseduam për barrën, shqetësimin, krenarinë dhe këndelljen e të qenit grua e parë në botë që projektoi një xhami.

Kaluan tre ditë ndërmjet marrëveshjes për bisedë dhe bisedës që bëmë me znj. Zejnep Fadëllëoglu. Më parë ajo kreu detyrimet që kishte në Itali, mandej shkoi në Katar, ku dha disa intervista, kështu që kur u takuam te xhamia Shakirin, korrespondenti i Nju Jork Tajms-it dhe kamera e kanalit televiziv gjerman RTL ishin aty në vendin e ngjarjes.

Zejnep Fadëllëoglu ishte shumë e turbulluar, si asnjë herë më parë në jetën e saj, që kur mori përsipër projektimin e Xhamisë Shakirin, që u ndërtua nga ana e fëmijëve Gazi, Gassan dhe Gade në emër të Ibrahim dhe Semiha Shakirit dhe që ishte një dhuratë për banorët e Stambollit. Para së gjithash nuk kishin të mbaruar kërkesat për intervista nga ana e shtypit të huaj. Sipas përkufizimit që bëri gazeta Le Monde,

Fadëllëoglu është pjesëtare e një familje të aristokracisë laike, ndërsa në qarqet ndërkombëtare dizajni i saj ishte shumë i përfolur edhe më parë, si dhe i shpërblyer nga ana e shumë institucioneve të respektueshme. Si një Fadëllëoglu mjafton prania e saj në faqet e gazetave, ku flitet për elitat... por jo, kjo ishte diçka tjetër...

Të vazhdojmë me këndvështrimin prej perëndimori; në një Turqi së cilës është problem t'ia caktosh kallëpin, kur bëhet fjalë për një xhami me një projekt, ku tradicionalja përzihet me modernen. Dhe kjo nuk mjaftoi. Ajo që në të vërtetë shtoi përmasat e lajmit ishte se projektuesi i kësaj xhamie është një grua...

Zejnep Fadëllëoglu nuk dëshiron të flasë në mënyrë absolute, por ajo ende nuk ka hasur në ndonjë informacion, ku ndonjë grua në botë të ketë dizajnuar xhami. Në vendet e tjera muslimane kjo gjë zor se do të ndodhte. Sipas asaj, fakti që ka marrë shumë e-maila urimi nga muslimanët e Amerikës tregon se këtë nuk e ka bërë asnjëri më parë, as edhe në Amerikë. Nga njëra anë ajo krenohet, por nga ana tjetër ajo është duke përjetuar periudhën më të bujshme të jetës së saj. Në çdo lajm që vjen nga Turqia, në çdo intervistë jepet një perspektivë tjetër. Më kryesorja është se asaj ia masin dijen për Islamin, po ashtu edhe më e pakta është se asaj i parashtrojnë pyetje mbi Islamin në nivelin më makro të mundshëm...

Fjalët e saj sa vijnë e shkurtohen dhe bëhen më të prera. Në një vend mund të lexoni se ka thënë se si dizajner është duke i sjellë estetikë Islamit. Kurse po të lexoni bisedën më parë dhe më pas këtij rreshti do të dalë diçka tjetër. Ajo vetëm thotë: “Si mundet unë të jem aq e pa edukatë sa ta them këtë gjë!” Kur t’i tuboni të gjitha këto para vetes do të keni një njeri që ka gjetur veten në një pozicion të atillë, ku duhet të flasë për Turqinë, krejt botën islame dhe krejt gratë e botës islame!

Po, a nuk i pëlqejnë krejt këto asaj? Dhe si... vetë ajo tregon se sa shumë dëshiron që të flasë për shtypin botëror. A mos mërzhitet se çdo hollësi e shpjegon për të 182-tën herë? Jo, nuk është kjo gjë aspak. Por vjen momenti kur të gjitha këto vijnë njëra me tjetrën... pse është ndryshe një njeri ende në dhjetë minutëshin e parë të intervistës, pa pasur asnjë pyetje provokative, të fillojë të qajë përnjëherë...

Një grua që shqetësohet, për fjalët që i zgjedh, për dukjen si do t’i kuptojnë të tjerët...

Marrja përsipër e dizajnit të brendshëm të xhamisë Shakirin nga ana e Zejnep Fadëllëoglu, në një kohë kur kjo gjë ka të bëjë me fenë sjell te kjo grua një frikë për atë se mos ndoshta do të kuptohet gabimisht. Sado që gjatë punës mund të konsultohesh me këdo që të duash prej njerëzve të fesë, sado që ke në dispozicion këdo nga kompetentët që mund t’ju ndihmojë... njerëzit e fesë etj., prapë se prapë kjo është një frikë e thellë. Mu si dizajni që ka xhamia Shakirin, ndoshta kështu ndodh kur puqet tradita me modernen.

A është interesi i medias botërore për këtë xhami, sepse ju njohin si dizajner nga çmimet ndërkombëtare, apo se keni bashkuar tok Islamin, gruan dhe xhaminë?

Sigurisht që u shfaq interes edhe nga ata që nuk na njohin. Media Angleze na njeh

“...Të dish mënyrën e jetesës islame është një gjë dhe të bësh dizajn është një gjë tjetër. U munduam shumë që të mos bëjmë ndonjë gabim...”

neve dhe punët tona. Pati ndikim një regjistrim në radio, që kisha dhënë për Bosforin dhe fëmijërinë time. Me informacionet që kanë marrë prej aty BBC u mor me xhaminë dhe nga aty krejt bota e mori vesh për këtë.

Nga Anglia kemi dy çmime dhe ata shfaqin një patronat mbi ne, ata na kanë shpërblyer më shumë se në vendin tonë. Gati të gjithë gazetatat gjermane më pas, mandej erdhën nga Suedia... kurse në Turqi u bëmë lajm pasi doli një lajm i madh në faqen e tretë të gazetës Le Monde.

Duke i folur shtypit të huaj, a ndjeni se keni një mision për të përmirësuar këndvështrimin e Islamit që njihet gabimisht në Perëndim?

Ashtu është. Për këtë gjë nuk më kishin pyetur më parë, shumë mirë. Këtu më duhet të falënderoj për gjithçka familjen e Gazi Beut (Shakir). Në fund të fundit ata janë që ma mundësuan mua këtë. Por menjëherë pasi filluan të merren me këtë temë shtypi dhe televizionet e huaja e gjeta veten duke u përgjigjur në emër të Islamit. Kjo nuk është fushë e imja, menjëherë u konsultova me teologë dhe Hysein Atajin. Kur m’u besua kjo punë u entuziazmovua shumë. Por dhamë shumë mund që të mos më keqkuptojë xhemati, i cili do të shfrytëzojë xhaminë, duke u munduar që nga njëra anë të sjellim risi e nga ana tjetër mundoheshim të bëjmë një projektim, që nuk do t’i përjashtonte ata vetë (xhematin). Me sa duket e kemi

munduar veten së tepërmi. Për shumë punë kur merrnim mendimin e tyre pasi më parë kishim planifikuar gjithçka, merrnim si përgjigje një “Pse jo?”. Edhe dekani i fakultetit teologjik Mustafa Fajda ishte me të njëjtën qasje.

A kishte ndonjë detaj për të cilën thanë se nuk bën?

Jo, nuk kishte, por kishte udhëzime për kafen. Unë zaten jam njeri që i dua xhamitë, dhe që jam ndikuar në dizajnet e mia nga xhamitë; kam punuar shumë nëpër xhamia, ato nuk janë një temë e huaj për mua. Por të dish mënyrën e jetesës islame është një gjë dhe të bësh dizajn është një gjë tjetër. U munduam shumë që të mos bëjmë ndonjë gabim.

A ndjenit brenda për brenda se jeni duke hyrë në histori?

Atë gjë e vërejta më vonë. Po, pata një ndjenjë shumë të theksuar. Por pata edhe një stres të madh për këtë gjë. Kjo pasi së pari... kjo më ndodhë ndonjëherë (*menjëherë i rrjedhin lotët nga sytë, ndalemi për pak çaste*). Kishte qenë një punë me shumë rëndësi, më vonë e kuptuam. Isha e ngazëllyer nga fakti, se përkaj shumë arkitektëve të çmuar, dizajnerëve mua më ishte dhënë ky rast. Por duke i menduar këto gjëra e gjeta veten duke dhënë përgjigje për pyetje që i takojnë grave. Mandej pyetjet mbi Islamin... Unë nuk kam një identitet, as përgatitje... por menjëherë ndiheni të detyruar...

A mos ishin tepër të gjitha këto për ju?

Të mos themi tepër pasi kuptohet keq, ishin me tensione. Kur fillojnë me “Si një grua, Islami...” menjëherë ndryshon çdo gjë.

A ishte kjo puna më e rëndësishme në jetën tuaj?

E, ashtu më duket. Gjatë këtyre viteve bëra shumë restorante për burrin tim dhe për të tjerët, bëra punë speciale për njerëz të tjerë... krejt këto i bëra duke kuptuar

shpirtrat e njerëzve të atyshëm, krijuam hapësira të kënaqshme, por për disa struktura të caktuara njerëzish...

Kjo a ishte një grup njerëzish që i nuk njihnit?

Mu ashtu. Prandaj u nisa prej asaj: “Si do dëshiroja të ndihesha në një xhami”. Fola me shumë njerëz. Fola shumë me kaligrafin tonë imamin Hysen Kutlu.

Në përgjithësi a dini për usul, a jeni e rrugës, e udhës?

Po di, gjyshja ime ka qenë hafize. Unë u rrita me fe, i di krejt duatë, pa bërë dua nuk shkoj askund.

A mendoni të dizajnoni ndonjë xhami tjetër?

Tani kam dy propozime.

A mund të dalë dikush që do ta cilësonte syrin tuaj, si sy perëndimori, se nga andej shihni për këndej?

A e njeh kulturën e vet ai që do ta mendonte kështu? Çfarë është bërë këtu ndonjë gjë me sy perëndimori? Asgjë nuk ka perëndimore, është krejtësisht e kundërta, është nga vetja.

Në një intervistë ju thoni se frikësoheni nga politizimi i kësaj xhamie...

Normalisht...

Ju edhe nëse jeni nisur nga një rrugë tjetër, a nuk mendoni se jeni duke dhënë një mesazh politik?

Unë bëra rezistencë të madhe që të mos jap ndonjë mesazh vetë, por me sa duket e kam dhënë atë me vetë faktin se ndodhem në këtë punë. Për fat të keq kohëve të fundit ka disa mungesa në imazhet e Islamit me theksin te gruaja dhe kjo e tërhoqi shumë vëmendjen. E dyta, është se nuk e njohin sa duhet Islamin, si dhe në Perëndim mendimtarët e mëdhenj muslimanë nuk shpjegohen mjaftueshëm. ■

(Marrë me shkurtime nga e përditshmja turke “Radikal”)

Nga turqishtja: Ramadan RAMADANI

FITNEJA E PASURISË

Allahu i Madhëruar i qorton ata njerëz, të cilët mendojnë, se nëse Ai ua zgjeron pasurinë atyre ajo do të jetë nder për ta, e nëse ua ngushton pasurinë ajo është nënçmim për ta.

HEJTHEM ZAFAN

Bota është rrotë. Ndonjëherë njeriut i ngushtohet risku dhe e bën të varfër, saqë nuk mund ta përballojë atë, kështu që në një mënyrë apo tjetër ai fillon të ankohet. Por i parë në një aspekt tjetër ai stoliset me cilësinë e durimit dhe të asketizmit me shpresën se një ditë do t'i largohet kjo sprovë. Kështu vepron njeriu, i cili është deri diku asket. Sprova e varfërisë është e qartë. Njeriu që është i varfër e ndjen varfërinë, sepse nuk mundet që t'i kryejë të gjitha gjërat që i kërkon jeta. Por kur i shndërrohet ajo gjendje me një gjendje tjetër dhe të ketë pasuri të bujshme, qoftë e tundur apo e patundur, të pakët janë ata që e kujtojnë të kaluarën. Ata nuk janë në gjendje ta perceptojnë, se tani janë në një sprovë edhe më të madhe, se sa sprova e fukarallëkut e ajo është sprova e dhuntive dhe se sa herë që i shtohet atij pasuria, paralelisht i shtohen edhe detyrimet.

Allahu i madhëruar në një ajet kuranor thotë: ***“E njeriu, kur e sprovon Zoti i tij, e nderon dhe e begaton, ai thotë: “Zoti im më ka nderuar!”*** Fexhr 15.

Komentuesi i njohur i Kuranit Ibën Kethiri Allahu e mëshiroftë, kur e komenton këtë ajet thotë: Allahu i Madhëruar i qorton ata njerëz, të cilët mendojnë, se nëse Ai ua zgjeron pasurinë atyre ajo do të jetë nder për ta, e nëse ua ngushton pasurinë ajo është nënçmim për ta.

Pra, dihet se detyrimi i pasanikut është që të falënderojë Allahun, të shpërndajë ***fi sebililah*** aty ku e lyp nevoja etj. Këtu rreziku nuk është vetëm tek ata prindër, të cilët harrojnë se janë në një sprovë të madhe, por rreziku është edhe tek ata fëmijë, të cilët kanë lindur dhe janë rritur në bollëk, dhe nuk janë në gjendje ta kuptojnë se prindërit e tyre kanë

bërë një jetë me kushte të vështira. Bota është rrotë. Prapë mund të kthehen në gjendjen e prindërve të tyre. Për këtë arsye prindi duhet t'i edukojë fëmijët e tij, që ata të jenë gjithnjë falënderues të dhuntive, dhe ta rikujtojnë fjalën e Resulullahut ***sal-lallahu alejhi ue selem*** që na thotë: ***“Ka dashur Allahu që t'i sprovtojë ata”***. Në këtë kontekst ata duhet të bëhen falënderues të Allahut për dhuntitë që u ka dhënë dhe ta rikujtojnë gjendjen e tyre të kaluar kur ishin të varfër. Po ashtu edhe prindi duhet t'i edukojë fëmijët, që ata ta dinë se çfarë haku i kanë njëri-tjetrit, si të veprojnë me pasurinë e Allahut në rrugë të Allahut, dhe si duhet të sillen në çastin kur ballafaqohen me fukarallëk.

Në ditën kur kalifi Mensur e mori këtë, një dijetar shkoi tek ai për ta vizituar. Kalifi i tha: Më këshillo! Dijetari ia ktheu: A të të këshilloj për diçka që kam parë apo për diçka që kam dëgjuar? - Jo më trego çfarë ke parë. - Dijetari i tha: O prijës i muslimanëve... Omer ibën Abdulazizi kishte njëmbëdhjetë fëmijë. Kur vdiq la tetëmbëdhjetë dinarë. Qefini i kushtoi pesë dinarë. Varrin që ia blenë i kushtoi katër dinarë. Të tjerat ua shpërndau bijve të tij, që do të thotë se nëntë dinarë i kanë ndarë njëmbëdhjetë djem. Kurse Hisham ibën Abdulmeliku kishte njëmbëdhjetë djem. Kur vdiq ai i la çdonjërit prej tyre mijëra dinarë. Pasha Allahun! O prijës i muslimanëve, e kam parë njërin nga bijtë e Omer ibën Abdulazizit, duke dhënë në një ditë njëqind kuaj për luftë në rrugë të Allahut, ndërsa njërin nga bijtë e Hishamit e kam parë duke lypur në treg!... ■

Nga arabishtja:

Enver AZIZI

“EPOKA E SANDVIÇIT”

Për të mos përjetuar tretjen dhe zhdukjen ai duhet të vendosi urgjentisht objektivat për të ndërtuar planin dhe në fund arritjen e qëllimeve. Këto fjalë janë të nevojshme për të gjithë, e në veçanti për muslimanët

SHKRUAN: ULVI FEJZULLAHU

Të menaxhosh do të thotë të shfrytëzosh format dhe mënyrat që e ndihmojnë njeriun në përdorimin maksimal të kohës, duke krijuar dhe baraspeshuar bilancin jetësor në mes detyrave, dëshirave dhe synimeve.

Përdorimi i kujdesshëm i kohës vendos dallimin në mes të suksesshmit dhe dështuesit në këtë jetë. Ajo që karakterizon të gjithë të suksesshmit është kapaciteti i ekuilibrit në mes synimeve që dëshiron të realizojë dhe detyrave të

domosdoshme. E gjitha kjo varet nga mënyra e menaxhimit të vetvetes nëpërmjet kohës. Kjo pikë së pari kërkon qëllimin dhe mesazhin, kështu që nuk ka nevojë për sistematizimin e kohës apo të vetvetes para se njeriu të vendosë për qëllimet se për çka ai jeton. Pa qëllime dhe synime ai përjeton në të gjitha sferat hallakatje, sa andej e sa këndeje. Edhe nëse realizohet diçka, ajo nuk është e mjaftueshme dhe ekuivalente.

Kujtoj këtu shembullin e njohur, kur një ditë bujku i thotë të shoqes: Nesër do të plugoj fushën. Të nesërmen që në mëngjes doli për të lubrifikuar traktorin, por i



mungonte vaji dhe shkoi në dyqan ta blejë. Rugës u kujtua se nuk i kishte dhënë për të ngrënë bagëtime, u kthye drejt hambarit për të marrë misrin. Duke parë thasët u kujtua se duhet të mbillte patatet. Duke shkuar për t'i mbjellë u kujtua se duhet të çonte dru në shtëpi, por më parë ai duhet t'i priste ato dhe e kishte lënë sëpatën në kotec. Duke shkuar për të marrë sëpatën takoi gruan që po ushqente zogjtë, e cila e habitur i thotë: "Mbarove së pluguari?" Mbarova!- bërtiti bujku,- por "Unë as që kam filluar".

Menaxhimi i kohës nuk do të thotë të bësh sa më shumë të mundesh, e çfarë mundesh pa një objektiv të qartë. Por së pari duhet të identifikohen prioritetet, duke pyetur veten: Çfarë të bësh? Çfarë të bësh të parën? Çfarë mund të shtyhet për më vonë?

Të nderuar lexues!

Sot po jetojmë në botën moderne, ku koha po lëviz shumë shpejt, saqë disa mendimtarë e quajten **"epoka e sandviçit"**. Kur njeriu nuk i kushton vëmendjen e duhur menaxhimit të kohës në mënyrë inteligjente, dhe mbetet karrem në **"sandviç"** ai përjeton kështu gëlltitjen, tretjen dhe një përfundim jo produktiv.

Për të mos përjetuar tretjen dhe zhdukjen ai duhet të vendosi urgjentisht objektivat për të ndërtuar planin dhe në fund arritjen e qëllimeve. Këto fjalë janë të nevojshme për të gjithë, e në veçanti për muslimanët, të cilët janë kthyer sandviç në pjatë për shkak të mos menaxhimit të mirë të kohës. Dhe shumë marrëzisht e humbin kohën duke mos vendosur disiplinën e administrimit. Investimi në kohë është detyrë kryesore për muslimanët që e kanë harruar. Ndërsa Islami e vlerëson lart kohën dhe investimin në te. Kurani i kushton një rëndësi të paparë kohës dhe

“...Ngritja e civilizimeve fillon nga dëshira e individëve për ta respektuar kohën si vlerë civilizuese...”

shumicën e adhurimeve (ibadeteve) i vendos në lidhje me kohën. Në data kohore, specifike dhe fikse si: namazi, agjërimi, haxhillëku.

Pjesa dërmuese e muslimanëve nga mos respektimi i vlerave të kohës janë viktimizuar dhe po përjetojnë shumë të këqija të hidhura. Ndërsa perëndimorët me mendjemprehtësi rivendosën disiplinën në administrimin e kohës, duke vendosur objektiva dhe ia arritën qëllimit.

Respektimi i denjë i kohës prodhoi civilizime dhe kultura, ku sociologët thonë: "Ngritja e civilizimeve fillon nga dëshira e individëve për ta respektuar kohën si vlerë civilizuese." Islami erdhi me objektiva të qarta mbi kohën, duke e këshilluar njeriun për kujdesin që duhet ta ketë ndaj ymrit. Allahu i Lartësuar është betuar për kohën, sepse ajo është një nga krijimet më madhështore të Allahut, për shkak të rëndësisë që paraqet ajo në jetën e njeriut. Ai përбетohet edhe në muzgun e agimit dhe në netët, përmend paqen e një dite të nderuar: **"Beto hem për muzgun e agimit, dhe për dhjetë netët."**¹, **"Beto hem në shkëlqimin e paradites, dhe në natën kur terret e qetësohet."**² **"për natën kur bie terri"**³, **"Paqe është ajo deri në lindjen e agimit."**⁴

Nata, dita dhe ndërrimi i tyre janë shenja për ata që kanë mend, i pranojnë këshillat, i frikësohen Allahut dhe janë falënderues ndaj Tij duke e falur namazin: **"Allahu ndërron ditën dhe natën. Me të**

¹ Hexhër, 1-2.

² Duha, 1-2.

³ Tekvir, 17.

⁴ Kadër, 5.

vërtetë, në këto (dukuri natyrore) ka mësim për ata që kanë mend.”⁵, “Vërtet, në ndërrimin e natës me ditën dhe në atë që ka krijuar Allahu në qiej dhe në Tokë, ka shenja për njerëzit që i frikësohen Allahut.”⁶, “Fale namazin në mëngjes e mbrëmje dhe në një kohë të natës, sepse veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija. Kjo këshillë vlen për ata që i pranojnë këshillat.”⁷, “Ai krijoj natën dhe ditën që të vijin njëra pas tjetrës, si këshillë për ata që duan ta kujtojnë ose duan ta falënderojnë.”⁸

Koha është jetë.

Koha shkon bosh dhe nuk i kushtohet vëmendje. Teoritë materialiste thonë “Koha është pasuri”, kurse në konceptin Islam “koha është jetë”. Me rëndësi është të mendohet për qëllime dhe synime duke e harmonizuar me mesazhin e jetës. Gjithashtu e rëndësishme është të dihet roli i individit në jetë, ai mund të jetë baba, nënë, djalë, punëtor, udhëheqës, drejtor etj. Çdo rol ka kërkesat dhe nevojat e veta, që merr një pjesë të kohës dhe që kërkon strategji dhe objektivitet.

Për të qenë të suksesshëm në administrimin e kohës duhet t’i lexojmë disa përvoja të mendjendriturve, që të jenë manual për të gjithë ne, në jetën tonë praktike. Në vazhdim do të japim një reflektim.

Njëzet e katër orët në vete përmbajnë 86400 sekonda të çmuara, të cilat duhet të shfrytëzohen për përparim dhe sukses. Që në fillim të bëhet një vetë-vlerësim duke çmuar organizimin e kohës, se vetëm në këtë mënyrë kemi një tregues pozitiv.

Të përcaktohet faktori humbës i kohës, të cilët janë të shumtë si:

Vënia e gjërave në vend të gabuar, ku shpesh herë detyrohemi t’i rivendosim për

së dyti.

Tubimet e shumta që kanë kohën e saktë të fillimit, por jo edhe të mbarimit.

Telefoni rrëmben një pjesë të rëndësishme të kohës me stërzgjatje bisedash.

Ndërprerjet, pauzat, shtyrjet e një pas njëshme shpërdorjnë kohën.

Dëfrimi, zbavitja dhe loja e tepruar jep kahe negative në jetë.

Pasi të zbërthehen këto faktorë duhet të ndërmerren hapat e ndryshimit duke:

shënuar faktorët, të cilët ndikojnë në humbjen e kohës së individit.

Numëruar problemet, të cilat rrëmbejnë kohën.

Perceptimi normal i administrimit të kohës.

Zhvillimi normal duke siguruar kohën.

Kujtoj këtu fjalët e njërit prej muslimanëve të parë, i cili ishte duke ecur dhe dikush i tha: Ndal të bisedojmë. Ai i tha: Ndale diellin, dhe më pas eci rrugës. Padyshim që koha nuk ndalet dhe nuk pret, çdo njëri ka në dispozicion 24 orë me 86400 sekonda. Dhe nuk është e tepërt asnjëherë të thuhet nga dhuntitë e mëdha të Allahut të Lartësuar për robërit e Tij është koha. A mund të mendohet jeta pa kohë?!

Allahu i Madhëruar është betuar për kohën, sepse ajo është një nga krijimet më madhështore të Allahut dhe për shkak të rëndësisë që paraqet ajo në jetën e njeriut. Në përmbyllje të këtij shkrimi modest kujtojmë suren 103 të Kuranit, ku Allahu i Lartësuar thotë: **“Për kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.”** ■

⁵ Nur, 44.

⁶ Junus, 6.

⁷ Hud, 114.

⁸ Furkan, 62.

I FORTI EDUKON ME URTËSI

Psikologët pohojnë se fëmija e merr sjelljen nga prindërit dhe e përvetëson atë në një mënyrë, e cila i ngjan gdhendjes në gur. Me siguri që rezultatet do të janë akoma më të mira, nëse sjellja e prindërve është shembullore

UEFA MUHAMED EBU MUSA

Dhuna dhe personaliteti i dobët janë dy pamje të së njëjtës monedhë dhe kjo është një e vërtetë që përsëritet shpesh nga pedagogët dhe psikologët. Sipas tyre personi i dhunshëm karakterizohet me ngurtësi në ndjenja, me dobësi në theksimin e egos, me emocione jo të balancuara, si dhe me paaftësi në pasqyrimin e vetes dhe thelbit të tij.

Personi i dhunshëm ka një histori edukimi, që merr njërën nga këto dy drejtime: edukim dhe rritje të karakterizuara me përkëdhelje të tepruara, ose me ankth dhe qasje diktatoriale. Të dy qasjet janë të rrepta/të ashpra për njeriun në përgjithësi dhe për fëmijën në veçanti.

Edukimi shoqëror brenda familjes

Familja është mbretëria e parë e fëmijës në të cilën ai rritet dhe zhvillohet. Familja është një sistem i edukimit shoqëror, që zakonisht përbëhet prej prindërve, fëmijëve, kufijve të familjes etj... Çdo familje ndjek filozofinë e saj të edukimit, të cilën do të mundohem ta analizoj në pikat vijuese:

Filozofia e edukimit në familje shtjellon kufijtë e familjes, kufij këto që tregojnë a bëhet fjalë për një familje të hapur në të cilën këmbëhet ndikimi dhe të ndikuarit, apo bëhet fjalë për kufij të mbyllur, që pamundësojnë këmbimin e ndikimeve. Filozofia e edukimit në familje përfshin edhe kujdesin prindëror, ose thënë me saktësisht mënyrën e sjelljes së prindërve ndaj fëmijëve të tyre, si dhe metodat e përdorura gjatë edukimit dhe përgatitjes së fëmijëve për ardhmërinë.



“...Mundësoji fëmijës që të zbulojë aftësitë që ka dhe zhvilloja ato sipas mundësive që ke...”

Katër modelet e edukimit shoqëror brenda familjes:

Edukimi shoqëror i fëmijëve brenda familjes ka katër modele, që duhet t'i dijë çdo prindër dhe çdo i ri që përgatitet për krijimin e familjes së tij.

Modeli diktatorial/mbisundues gjatë edukimit:

Ky model mbështetet kryesisht në forcën e pushtetit që në kulturën e përgjithshme njihet si pushteti i prindërit. Në këtë model ndikimi vjen nga “lart”, e babai është dominues. Rrallëherë ndodh që ky faktor dominues të jetë nëna. Rreziku i këtij modeli është rritja e fëmijës në kushte familjare të dominimit njëpolar, kushte këto që nuk mundësojnë shprehjen e vetes dhe shprehjen e ambicieve. Fëmija edukohet në kushte presioni, dhune dhe frike të vazhdueshme. Personaliteti i këtij modeli dallohet për hezitim, dobësi, përdor forma të dhunshme për të shprehur veten. Ky person është i paafte të vendosë vetvetiu, çdo vendim i tij varet nga miratimi i palës mbisunduese, të cilën ai e konsideron model ideal për çdo gjë.

Modeli “demokratik” gjatë edukimit i njohur ndryshe si modeli “pa kufi”:

Ky model është i posaçëm për familjet me shkallë të lartë të mundësive ekonomike, për familjet që kanë vetëm një fëmijë. Kjo familje krijon kushte të një lirie të plotë për fëmijët, kufijtë disiplinues dhe korrigjues nuk ekzistojnë në këtë rast.

Rreziku i këtij modeli është formimi i fëmijëve me tipare të theksuara egoiste, fëmijë që shikojnë interesin e tyre dhe që

kërkojnë plotësimin e kushteve të tyre. “Ashtu si dua unë” është një emërtim tjetër për të rriturit në kushtet e një lirie të pakufizuar. Për ta përgjigja jo, nuk është opsion i mundshëm dhe refuzimi konsiderohet fyerje që i ngjan krimit. Si do të jetojë ky fëmijë, dhe si do të sillet ndaj atyre që përgjigjen me jo është pyetja përgjigjen e së cilës po ua lë juve.

Modeli kontradiktor i edukimit i njohur ndryshe si “anarkik”:

Mendoj se ky model edukimi është më i rrezikshëm për personalitetin e fëmijës. Në këtë familje fëmija rritet i rrethuar nga kontradiktat, ndryshojnë përkufizimet, madje edhe ndeshen, të asaj që është e mirë (që pastaj bëhet e keqe) dhe të asaj që është e keqe (e që mundet pastaj të konsiderohet e mirë). Te ky fëmijë kufijtë e së mirës dhe asaj që konsiderohet e keqe nuk janë të qarta. Për të njëjtën vepër, fëmija nga ndonjëherë inkurajohet dhe shpërblehet, kurse herën tjetër ndëshkohet. Gënjeshtria, si ves që duhet ta mënjanojmë nga jeta e fëmijës, shpeshherë përgënjeshtrohet nga vetë prindërit. Për shembull, ne i kemi thënë fëmijës, se gënjeshtria është ves i keq dhe se ai/ajo duhet ta thotë vazhdimisht të vërtetën, pastaj vetë në rastin e telefonatës, të cilës nuk duam t'i përgjigjemi i themi fëmijës të thotë, se baba/nëna nuk janë në shtëpi.

Fëmija që rritet në këtë lloj sistemi është i humbur, nuk di cilën rrugë të zgjedhë, nuk ka tipare të qarta personaliteti, heziton, frikësohet dhe është i paafte të mendojë dhe të vendosi në mënyrë të përshtatshme. Ky personalitet nuk ndërmerr iniciativa dhe i mungon planifikimi dhe angazhimi, çdo gjë që bën është zbatim i urdhrave, nuk është i aftë të vendosë synime dhe të fillojë me unë. Kurdo herë i nevojitet një planifikues dhe shtytës i jashtëm.

Modeli i edukimit të orientuar:

Është një model të cilin e promovon Islami, është një model të cilin e shohim në jetën e të Dërguarit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të. Shtylla e këtij modeli është shëmbëlltyra e mirë. Psikologët pohojnë se fëmija e merr sjelljen nga prindërit dhe e përvetëson atë në një mënyrë, e cila i ngjan gdhendjes në gur. Me siguri që rezultatet do të janë akoma më të mira, nëse sjellja e prindërve është shembullore, e urtë, sjellje që buron nga respekti i personit dhe vlerësimi i tij, që orienton më tepër se sa urdhëron, që mbështetet në përvojë dhe mësim e jo në presion dhe detyrim...

Një sjellje e këtillë i mundëson fëmijës kushte të shëndosha edukimi, brenda kornizave fleksible, me theks të veçantë mbi kriteret pozitive morale, i tolerohet gabimi me qëllimin e mësimi. Në këto rrethana brenda kushteve familjare, fëmija mëson bartjen e përgjegjësisë, pjesëmarrjen në dhënie, zbatimin e detyrave dhe respektimin e të drejtave.

Propozime të rëndësishme për zhvillimin dhe ndërtimin e personalitetit të fëmijës:

Shfrytëzoje potencialin e fëmijës:

Çdo fëmijë ka një potencial të veçantë. Mundohu që potencialin e fëmijës ta shfrytëzosh në mënyrë pozitive. Mundësoji fëmijës që të zbulojë aftësitë që ka dhe zhvilloja ato sipas mundësive që ke. Mos u nevrikos me lëvizjet e shumta, shfrytëzoji të njëjtat gjëra për zgjerimin e njohurive për veten. Investo në rritjen e përvojave të fëmijës.

Pranoji gabimet e fëmijës sate:

Nëse fëmija gabon mësoji atij mënyrën, se si të përfitojë nga gabimi i bërë, kjo qasje është më e mirë se hidhërimi me to dhe ndëshkimi i ashpër.

“...Nëse libri është miku i prindërve e njëjta gjë do të ndodhë edhe me fëmijën...”

Kujdesi për takimet familjare:

Takimet familjare janë boshti i mbështetjes brenda familjes. Në këto takime mësohet dashuria mëshira dhe altruizmi, forcohet besnikëria dhe ndjenja e përkatësisë. Në erën e ankthit global dhe de-sensibilizimit emocional këto takime familjare, që kanë qenë aq të pranishme në të kaluarën tonë, filluan të rrallohen dhe u zbeh ndikimi i tyre edukativ. Kjo le të jetë një thirrje për rikthimin e tyre në agjendat tona ditore.

Mëso durimin:

Edukimi i fëmijëve ka nevojë për durim. Merr frymë thellë në çastet kur ndien ngushtimin e gjoksit për shkak të sjelljeve të fëmijëve. Bindu se ndoshta fëmija nuk do ta mësojë atë që dëshiron përnjëherë. Ndoshta do të duhet t'ia përsërisësh atë dhjetë herë. Vitet e fëmijërisë janë vite të këshillimit dhe durimit, për një ardhmëri më të shndritshme.

Mos e privo fëmijën nga ngrohtësia dhe respekti:

Fëmija çdoherë ka nevojë për ndjenjën e sigurisë. Ai do të ndihet i sigurt nëse e ledhaton, e përqafon i shpreh respekt dhe sillesh mirë me të...

Inkurajoje fëmijën tënd për lexim:

Tregimi para gjumit është i dobishëm, sepse i mundëson fëmijës të mësojë vlera të dobishme dhe sjelle pozitive me anë të dëgjimit. Nëse libri është miku i prindërve e njëjta gjë do të ndodhë edhe me fëmijën. Leximi është mjeti më i dobishëm për zgjerimin e njohurive dhe ndihmon në zhvillimin e të menduarit. ■

Përshtati nga arabishtja:
Talha KURTISHI

ÇDO GJË E KEMI KRIJUAR ME KADER

lidhja më e ngushtë është lidhja e besimit, sepse lidhja e gjakut ndërpritet në dynja ndërsa ajo e besimit vazhdon dhe në tjetrën, dhe se fëmijë real është ai prej të cilit prindi ka dobi në këtë botë dhe në tjetrën

SHKRUAN: BLENDAR HAXHIU

Në pamje të parë titulli lë të dëshirosh se në këtë temë do të flasim në mënyrë akademike për Kaderin (caktimin) e Allahut dhe shtjellimet që kanë të bëjnë me të, por në realitet ne do të trajtojmë vetëm një anë të kësaj çështje kaq të madhe dhe të rëndësishme në jetën e muslimanit, e cila ka të bëjë me: “Fëmijët dhe pajtimi me kaderin”.

Meqenëse ky numër i AlbIslamit u është dedikuar fëmijëve e shohim të domosdoshme që këtë temë ta lidhim me ta, në mënyrë që të shohim së bashku, se ne kemi aq shumë nevojë të jemi të kënaqur me kaderin e Allahut në lidhje me fëmijët. Çdo musliman e di fort mirë, se është pjesë e imanit besimi në kaderin (caktimin) e Allahut, i mirë apo i keq qoftë, dhe se ai nuk mund ta plotësojë besimin, madje nuk e meriton atë, nëse nuk beson në caktimin që Allahu ka vendosur për të.

Kjo është ana teorike tek çdo njëri prej nesh, ku në shumicën e rasteve çdo kush nga ne e kalon lehtësisht klasën, por kur vijmë në praktikë, atëherë e kuptojmë se sa shumë kemi nevojë të kujdesemi për të. A do të kënaqemi me atë që është caktuar për ne?

Çdo çift i sapo kurorëzuar, gjënë e parë që mendon janë fëmijët; nëna mendon për rrobat e babai për emrin, çdokush shpreh preferencën e tij se çfarë do të dëshironte: vajzë apo djalë. Por sapo kalon një apo dy vite martesë fillojnë shqetësimet, nëse ende nuk kanë fëmijë. Disa me të drejtë shkojnë e bëjnë kontrollet e duhura tek mjekët për të parë se ku çalon problemi, dhe kjo është shumë e drejtë, sepse Profeti lavdërimet dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“Allahu ka zbritur sëmundjen dhe ilaçin dhe çdo sëmundje ka ilaçin e saj; kurohuni o robër të Allahut, por mos u kuroni me haram”*.¹ Porse shqetësues është fakti, se në mesin tonë ka ende nga ata që thonë se janë muslimanë dhe në këto raste e humbin toruan dhe shkojnë sa ke fallxhori, tyrbja, mekami, varret a gjetiu.

Sa keq, këta çifte nuk e kanë njohur Krijuesin e tyre Fuqiplotë, as realitetin e Fesë Islame me të cilën identifikohen dhe ende nuk e kanë kuptuar se Allahu çdo gjë e ka krijuar me kader. Ata kanë kërkuar gjetiu atë që mund ta japë vetëm Allahu i Lartësuar, Ai që e ka caktuar atë, që kur ti ke qenë ende në barkun e nënës, madje pesëdhjetë mijë vjet para se të krijonte krijesat, nëse ti do të kesh

fëmijë apo jo. Atëherë si mund ta lësh veten që ty të rrëshqasë këmba në këtë shtyllë të besimit e të tregosh pakënaqësi për atë që Allahu ka caktuar për ty, e aq më keq që t'ia kërkosht dikujt tjetër veç Tij!

Megjithatë them se ndoshta ti e ke bërë një gjë të tillë pa dashje dhe nga mosdija, ndaj dhe e ndiej detyrim të t'i drejtoj dy fjalë.

Dije se caktimi i Allahut do të thotë, se Ai di çdo gjë në mënyrën më absolute: të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen; më pas ato i ka shkruar në një regjistër të ruajtur, të cilin e ka vendosur pranë vetes, pastaj ka dëshiruar ekzistencën e tyre e më pas i ka krijuar ato. Pra, të jesh i bindur, se atë që Fuqiploti nuk e ka dëshiruar, ajo nuk mundet kurrë të ndodhë. Prandaj çdo çift, i cili është sprovuar me mos lindje të fëmijëve duhet të jetë i duruar dhe njëkohësisht i kënaqur me atë që Allahu ka caktuar për ta.

E mirëkuptoj gjendjen e prindërve, të cilët nuk kanë fëmijë, sepse jam edhe vetë prind; e kuptoj ndjesinë që ata kanë në zemrat e tyre për ta pasur një fëmijë. Një ndjesi e tillë është normale, është natyrshmëri e vendosur tek njeriu dhe nuk është e qortuar, sepse ata janë bukuria e kësaj bote, por e qortuar është që ky privim të shkaktojë moskënaqësi për caktimin e Allahut Fuqiplotë, që Ai ka vendosur për këta prindër. Dëgjo se si i drejtohet Allahu robërve të Tij: ***“Pasuria dhe djemtë janë stoli e jetës së kësaj bote. Por veprat e mira që mbeten përherë janë më të mira te Zoti yt, sa i përket shpërblimit dhe janë më të mira sa i përket shpresës (për shpëtim)”***.¹

O ju prindër, që jeni privuar prej fëmijëve! Të jeni të bindur se kjo është një sprovë për ju, se çfarë do të punoni e si do të reagoni. A do të jeni të kënaqur me caktimin që Allahu ka vendosur për ju, apo do të ankoheni për Të te krijesat që s'mundet t'ju ndihmojnë?

“...Shqetësues është fakti, se në mesin tonë ka ende nga ata që thonë se janë muslimanë dhe në këto raste e humbin toruan dhe shkojnë sa ke fallxhori, tyrbja, mekami, varret a gjetiu...”

Ndoshta ju mendoni se kjo që ju ka goditur është e keqe për ju dhe ndodh që mirësia është tek e kundërta e asaj që ju mendoni: ***“Por mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini”***.³

Ku e di ti se në këtë që ka zgjedhur Allahu nuk ka mirësi për ty, edhe pse ajo në pamje të parë duket e keqe?! Ku e di ti se ndoshta ai fëmijë që e dëshironi kaq shumë mund të jetë shkak që ju të përfundoni në humbje a në zjarr –Allahu na ruajt-. Mos vallë ti je më i mirë se Nuhu –Profet dhe i zgjedhur i Allahut në popullin e tij-, absolutisht që jo, atëherë pse nuk mediton për historinë e tij me djalin e vet, të cilën ne herë pas here e lexojmë në Kuran dhe ashtu pa e kuptuar as dhe vetë nuk arrijmë të përfitojmë prej saj: ***“...ndërsa Nuhu thërriste birin e vet, i cili ishte ndarë veç: “O biri im, hip me ne e mos u bëj me mohuesit!” (I biri) tha: “Unë do të strehohem në një mal i cili do të më ruajë nga uji”. Nuhu iu përgjigj: “Sot askush nuk do të kursehet nga dënimi i Allahut, përveç atij që e mëshiron Ai!” Një valë në mes tyre i ndau dhe ai u fundos”***.⁴

Disa ajete më poshtë Allahu tregon e thotë: ***“Pastaj Nuhu iu lut Zotit dhe i tha: “O Zoti im, biri im është nga familja ime, premtimi Yt***

¹ Tirmidhiu. Hadithi është i mirë.

² Sure Kehf, 46.

³ Sure Bekare, 216.

⁴ Sure Hud, 42-43.

është i vërtetë dhe Ti je Gjykatësi më i drejtë!" (Allahu) **tha: "O Nuh, ai nuk është nga familja jote, ai ka bërë punë të keqe. Mos më pyet për atë që ti nuk e di. Unë të këshilloj që të mos bëhesh nga të paditurit!"**⁵

A nuk e shikon sesi Allahu ia mohoi këtë fëmijë Nuhut, dhe kjo për vetë faktin se lidhja më e ngushtë është lidhja e besimit, sepse lidhja e gjakut ndërpritet në dynja ndërsa ajo e besimit vazhdon dhe në tjetrën, dhe se fëmijë real është ai prej të cilit prindi ka dobi në këtë botë dhe në tjetrën!

Po në historinë e Musait me Hidrin a ke medituuar ndonjëherë? **"Dhe që të dy vazhduan të ecin, derisa takuan një djalosh, të cilin ai (Hidri) e vrau. (Musai) Tha: "Përse vrave një njeri të pafajshëm, që nuk ka vrarë askënd?! Vërtet që ke bërë një punë të tmerrshme!" "Sa për djaloshin, prindërit e tij ishin besimtarë. Ne e dinim se (dashuria për të) do t'i çonte ata në të keqe dhe mohim!"**⁶

Po, është e vërtetë që fëmija ndonjëherë të çon në të keqe dhe mohim. A do të kënaqeshe ti të kishe një fëmijë prej të cilit do të përjetoje poshtërimitet më çnjerëzore?! Jam i sigurt që këtë nuk do ta doje, atëherë ku e di se ndoshta Allahu të ka privuar nga fëmijët për këtë shkak?

Këta janë një kategori prindërisht, të cilët tregojnë pakënaqësi për kaderin e Allahut në lidhje me fëmijët.

Kategoria e dytë, janë ata prindër, të cilët Allahu i ka gëzuar me fëmijë, por që gjatë jetës ndoshta askush prej tyre nuk ka mundur të jetojë. Subhanallah, sprova e këtyre çifteve në lidhje me kaderin e Allahut, ndonjëherë është më e madhe se e të parëve. Të takon të hasësh shpesh njerëz, të cilët janë goditur me këtë sprovë dhe që shprehin fjalë që bien ndesh me caktimin e Allahut: ç'që ky fat i zi për mua; përse o Zot sillesh kështu me mua; mallkuar

qoftë ajo ditë që rrëmbeu djalin tim; ma mori djalin/vajzën në lule të rinisë etj. Etj. Etj...

Në realitet këta prindër harrojnë se ata janë gëzuar qoftë edhe disa çaste me të qenit prind, ata ndoshta kanë harruar se të tjerët ende nuk e kanë përjetuar këtë; vërtet harrojnë se Allahu edhe me kaq i ka privilegjuar, ndoshta jo si ata që u kanë rrojtur fëmijët, por po i drejtoj edhe këtyre të njëjtën pyetje: Ku e dini ju se ç'do të sillej me fëmijët tuaj? Ndoshta në këtë zgjedhje të Allahut ka urtësi, madje mirësi të paimagjinueshme për besimtarët, të cilët bëjnë durim në situata të tilla. Në këto raste vërtetohet besimi në kaderin e Allahut; në çastet në të cilat njeriu nëse lajmërohet për të tilla gjëra thotë: **"Të Allahut jemi e tek Ai do të kthehemi; e Allahut është ajo që mori dhe të Tijat janë ato që ka dhënë dhe çdo gjë ke Ai ka kohën e caktuar"**. Apo në çastet kur ai merr shembull zotërinë e bijve të Ademit – Muhamedin, Profetin e Allahut- i cili kur e mori djalin e tij Ibrahimin në duar tha: **"Syri loton dhe zemra brengoset, porse ne themi vetëm atë që e kënaq Zotin tonë"**?

A ke menduar ndonjëherë, nëse do të duroje për këtë brengë dhe do të ishe i kënaqur me caktimin e Allahut, se çfarë shpërblimi të pret në botën tjetër? Profeti Muhamed në një hadith ka thënë: **"Kur vdes fëmija e dikujt, Allahu i thotë melaqeve: "A e morët frytin e zemrës së tij? Ata thonë po. Ai përsëri i pyet: "Çfarë tha rob i Im? Ata përgjigjen: Të falënderoi Ty, o Zot. Atëherë ndërtoni për robin Tim një shtëpi në Xhenet dhe quajeni atë shtëpi e falënderimit!"**⁷

Dëgjoje dhe këtë: Një herë Profeti salallahu alejhi ue selem, iu drejtua shokëve të tij dhe iu tha: **"Kë e konsideroni ju farëshuar? Thanë: Atij që nuk i jetojnë fëmijët. Përkundrazi, -ia ktheu ai-, farëshuar është ai që nuk rrezikohet**

⁵ Sure Hud, 45-46.

⁶ Sure Kehf, 74-80.

⁷ Buhari.

⁸ Dhe Ai është i mirëditur për atë se çka vepruar e thënë rob i Tij. # Tirmidhiu, hadithi është i saktë.

⁹ Ahmedi dhe Muslimi.

tek fëmijët aspak!”

Pra, ai na lajmëroi se realisht ky është farëshuar, për shkakun se ai nuk ka arritur të përfitojë asnjë shpërblim prej fëmijës së tij, sikurse kanë arritur të përfitojnë ata që kanë qenë para tij, të cilët janë sprovuar tek fëmijët. Pra, Profeti sikur do t'i thotë se vdekja e fëmijës në këtë botë është e madhe, por humbja e shpërblimit ndaj durimit dhe dorëzimit ndaj caktimit në ahiret është akoma edhe më e madhe se kjo.¹⁰

Një kategori tjetër prindërisht, që tregojnë pakënaqësi për kaderin e Allahut janë dhe ata të cilëve u janë dhuruar vetëm vajza. Kësaj kategorie dëshiroj që t'i drejtoj përzemërsisht këtë mesazh.

Nuk është për t'u çuditur që shumica e çifteve i duan më shumë djemtë, sepse ajo është natyrshëm e mbjellë tek njeriu, por asnjëherë nuk duhet të harrojmë se Allahu i jep kujt të dojë djem dhe u jep të tjerëve vajza dhe kjo për një urtësi të madhe.

“Ai i dhuron vajza kujt të dojë e djem kujt të dojë. Disave u dhuron të dyja gjinitë: djem e vajza; e kë të dojë e lë pa fëmijë. Vërtet, Ai është i Gjithëdijshëm dhe i Fuqishëm”.¹¹

Baballarët i dëshirojnë djemtë, sepse ata iu shtojnë fisin dhe do t'u bëhen krah kur të rriten, ndaj dhe shpeshherë hidhërohen e prishen në fytyrë kur Allahu u jep vetëm vajza. Të thuash të drejtën këta baballarë nuk e dinë rëndësinë e vajzave dhe mirësinë e tyre, sepse në të kundërt nuk do të vepronin ashtu sikurse veprojnë disa prej tyre.

Vajzat janë dhunti e madhe dhe dhuratë e vyer, ne duhet të gëzohemi për ardhjen e tyre dhe të përpiqemi e të angazhohemi siç duhet, që ato të edukohen sa më denjësisht.

Profeti Muhamed ka thënë: *“Kush i ka tre vajza dhe tregohet i durueshëm ndaj tyre, i ushqen dhe i veshmbathë ato, do të jenë për të pengesë nga zjarri Ditën e Gjykimit”.*¹²

¹⁰ Nihajetu fi garib el hadith.

¹¹ Sure Shura, 49-50.

¹² Ibënu Maxhah.

Dikujt Allahu i kishte dhuruar gjashtë vajza dhe sa herë që i shihte, apo mendonte për to e kapte një hidhërim i papërshkruar, hidhërimi i tij dukej qartë në fytyrë dhe shpesh herë e demonstronte atë edhe me fjalë ndaj gruas. Nuk kaloi shumë kohë kur ja gruaja e tij mbeti shtatzënë për të shtatën herë, atij filloi t'i ndryshonte fytyra, shenjat e shpresës për djalë filluan të dukeshin qartë. Megjithatë pak kohë para lindjes vendosi ta dërgonte tek njerëzit e saj, që ta kishte më të lehtë, por para se të ndahej me të i tha: Kur të lindësh mos më thuaj që ke bërë vajzë, se kam frikë se nuk do të jesh më gruaja ime. E gjora! Çfarë faji kishte ajo? Gruan e tij po atë natë e çojnë në spital për të lindur, ndërsa burri vendosi vajzat e tjera në gjumë dhe e kap dremitja, ndërkohë ai shikon sikur u bë Kiameti, sikur e afruan pranë zjarrit dhe sa herë që e çonin në ndonjë derë të tij për ta futur brenda, gjente atje një nga vajzat e tij, e cila i pengonte që ta fusnin brenda. Vazhduan me të, të shkonin nëpër të gjashta dyert dhe në çdonjërin prej tyre gjenin njërin nga vajzat e tij, por kur e çuan në derën e shtatë gjeti që ajo ishte bosh dhe kur shkuan atje për ta hedhur në zjarr i doli gjumi i tmerruar. Kur e kuptoi që ishte ëndërr e falënderoi Allahun, i ngriti duart nga qielli dhe tha: O Zot të lutem më dhuro të shtatën. Më vonë i telefonoi bashkëshortes së tij, që për çudi kishte lindur tashmë vajzën e shtatë e i tha: “Të lutem më thuaj që është vajzë.” E pra, a nuk janë vërtet vajzat dhuratë dhe dhunti, që duhet ta falënderojmë Allahun për to.

Prindër të nderuar! Në çdo situatë ne duhet të jemi të kënaqur me caktimin e Allahut; të jemi të sigurt se atë që na e ka caktuar Ai do të ndodhë; e atë që s'e ka dashur, kurrë nuk mund të vijë, sepse kështu ne me të vërtetë besojmë në kaderin e Zotit; në këtë shtyllë të besimit. ■



Ndoshta dikur shoqëritë njerëzore, jo vetëm që nuk kanë menduar t'u dalin në ndihmë fëmijëve të braktisur, por ata vetë i braktisin, apo edhe i keqtrajtonin këto qenie njerëzore. E drejta hyjnore Islame qysh para 1400 viteve e zgjidhi këtë problem

SHKRUAN: RASHID ZYLFIU

Atë ditë kur telefoni cingëroi, thirrja ishte e qëllimtë nga ky dinak dhe kjo viktimë ra pre' e atij ujku, që kur filloi t'i fliste me një zë mashtrues, gjoja se ishte nevojtar, i vetmuar dhe se kishte nevojë për dikë që ta shoqërojë, por synimi i tij ishte kapja e këtij gjahu.

Vajza i besoi dhe i hapi zemrën e saj, meqë ishte e gatshme ta ndihmojë e me këtë prolog u hap historia e hidhur e kësaj vajze, turpi i së cilës do të përfshijë të gjithë familjen e saj. Ditët kalonin dhe lidhja në mes të këtij çifti shtoej edhe më shumë, megjithëse në shtëpi nuk vërehej ndonjë gjurmë për këtë tradhti. Atë ditë, kur çdo gjë ishte përgatitur nga ky dinak..., a thua kjo vajzë, e dinte se çfarë po përgatitej kundër saj! Ajo ishte dita në të cilën i ra perdja e turpit nga fytyra, kur ky dinak ia mori gjënë më të shtrenjtë që ka me vete një vajzë e ndershme. Këtë, ajo e kuptoi vetëm atëherë kur u kthye në gjendjen e saj normale, pasi ishte e mashtruar me lloje të

ndryshme barnash... dhe nuk kishte vend më për qortim dhe kthim prapa.

Ditët kalonin sikur në shtëpinë e saj të mos kishte ndodhur gjë, kapërcyen muaj që ky dinak e përdorte kodin e kësaj viktime në duart e veta dhe e përdorte atë sa herë që donte.

Vajza po e shihte, se gjendja e saj shëndetësore nuk ishte më normale dhe Zoti kishte caktuar, që një fryt i ri të mbinte në barkun e saj. Kujt t'ia rrëfente këtë turp, çfarë t'i tregonte kësaj nëne të gjorë, kur tashmë vajza e saj ishte me barrë; ajo u alivanos nga pikëllimi! A do të mbulohet ky lajm që mos t'i arrinte babait, por është e kotë, e vërteta do të dalë në shesh herët a vonë me gjithë orvatjet dhe përpjekjet e nënës dhe të bijës për ta dështuar këtë barrë; Zoti kur cakton diçka nuk ka kush që ta kthejë atë mbrapa.

Lajmi si rrufeja depërtoi në veshin e babait, por tashmë kishte kaluar koha për qortime, për përkujdesje, për rrahje e ndëshkim, këto duhej të ishin bërë me kohë, tani koha kishte ecur. Ky prind sa herë që

dilte në rrugë, ngado që shkonte, një zë i vinte nga pas: “Turp të qoftë, a e di se çfarë ka bërë bija jote, turp.. turp...!”

Ndërsa babai i këtij fryti që tani po pritej të dilte në dritë, ku është? Kush do ta marrë në përgjegjësi? Kush do të jetë kujdestari i kësaj foshnje? Ku do të strehohet? Kë do të trashëgojë?... Sikur ai ende pa dalë në këtë botë po pyeste: “Ku e kam babin tim?” Ai tashti i kishte humbur gjurmët e veta, sikur u zhduk nga kjo botë e tashti është koha të kuptohet, a ishte dashuri apo tradhti kjo lidhje?

Ndoshta shpresat janë ende për t'i mbuluar gjurmët e kësaj foshnje, por caktimi hyjnor është mbi të gjithë. Më mirë vdekja për këtë vajzë me këtë foshnje, se sa të dalë ky turp në dritë. Por ngjarjet rrodhën ashtu që ky fryt erdhi në këtë botë.

Vajza po i thoshte babait të saj: “Turp o baba, që nuk u kujdese, ku ishe që më le të bie në kurthin e atij dinaku turp, turp!...”. E kjo foshnje thërriste: “Nënë, ku e kam babin tim?” Për këtë familje nuk mbeti ndonjë alternativë tjetër për ta mbuluar turpin e tyre, pos braktisja e kësaj foshnje¹.

Ku e ka vendin kjo foshnje?

Ndoshta dikur shoqëritë njerëzore, jo vetëm që nuk kanë menduar t'u dalin në ndihmë fëmijëve të braktisur, por ata vetë i braktisnin, apo edhe i keqtrajtonin këto qenie njerëzore. E drejta hyjnore Islame qysh para 1400 viteve e zgjidhi këtë problem. I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, tërhoqi vërejtjen për të drejtat e fëmijëve të braktisur, edhe pse ai vetë, *sal-lallahu alejhi ue selem* u rrit në një ambient ku fëmija nuk i gëzonte të drejtat elementare të jetesës. Dijetarët e **fikhut** që kanë sqaruar dispozitat e sheriatit i kanë dhënë hapësirë të mjaftueshme të drejtave të fëmijëve të braktisur dhe kanë bërë një shtjellim të mirë të këtyre dispozitave të bazuara në Sunetin e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*. Në

librat e fikhut ekziston një kapitull i veçantë në të cilin shtjellohet kjo problematikë.

Edhe pse tani fëmijët mbrohen dhe zotërojnë të drejta sipas konventave ndërkombëtare² për të drejtat e fëmijëve³ shtrohet pyetja, a i gëzojnë sot të gjithë fëmijët e botës këto të drejta apo jo?

Dispozitat fetare për fëmijët e braktisur:

Përkufizimi:

Në aspektin terminologjik: fëmija i braktisur është: “Çdo fëmijë që nuk i dihet prejardhja pa marrë parasysh a është rob apo i lirë, i hedhur në rrugë apo në ndonjë vend tjetër”.

E Drejta e mbijetesës, argumentet:

Është detyrim për muslimanët në rast se gjejnë ndonjë fëmijë të braktisur ta marrin dhe ta mbrojnë atë, sepse është qenie njerëzore që duhet respektuar. Në këtë rast përkujdesja ndaj tij kthehet në **“farz kifaje”**, që do të thotë, se nëse dikush e merr në mbikëqyrje të tjerët lirohen nga mëkati, lirohen nga përgjegjësia. Argument për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar: **“Ndihamojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në punë të mbara dhe mos u ndihmoni në gjynahe dhe armiqësi!”**

“...Dhe nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve.”

A detyrohet ai që e gjen i pari ta marrë atë?

Ai që e sheh i pari duhet ta marrë atë, kjo është në esencë. Po që se nuk i përmbahemi këtij mendimi, atëherë mundësia është që këtë fëmijë mos ta marrë askush dhe kështu do të shkatërrohet nga ndryshimet klimatike apo fatkeqësitë e tjera me të cilat kjo foshnje do të përballlet e kur dihet mirë se në shumicën e rasteve hidhen në vende të ndryshme.

E Drejta e lirisë dhe e fesë .

Fëmijët e braktisur janë të lirë në të gjitha dispozitat dhe i gëzojnë të drejtat e tyre për

¹ Shkëputur nga libri “Umi ejne ebi”.

“...Është detyrim për muslimanët në rast se gjejnë ndonjë fëmijë të braktisur ta marrin dhe ta mbrojnë atë...” ”

jetesë, sepse njeriu në thelb është i lirë kurse robëria është diç që mund të ndodhë. Sa i përket të drejtës së tij fetare dhe gjykitimit ndaj tij, se: a është musliman apo nuk është, dijetarët kanë mospajtime rreth asaj se në çfarë vendi është gjetur. Në një vend me muslimanë, me shumicë muslimane, apo në një vend të banuar me jo-muslimanë dhe kështu në bazë të këtij rregulli i bazojnë mendimet e tyre. Por ajo që është më afër të saktës është se ai është musliman, sepse përveç shkëputjes prindërore ndaj tij është bërë edhe shkëputja e fesë. Duke u bazuar në hadithin e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*: “Çdo foshnje lind në natyrshmërinë e pastër, e pastaj prindërit e bëjnë të krishterë, çifut apo zjarrputist”².

Shpenzimet për fëmijën e braktisur.

E tij është gjithçka që ka me vete, qoftë të holla apo ndonjë pasuri tjetër. Kujdestari i foshnjës së braktisur shpenzon nga kjo pasuri e gjetur me te, përndryshe shpenzimet për të duhet të sigurohen nga “Bejtul mal”³. Në rast të mos ekzistencës së dy formave të lartpërmendura për shpenzimet, atëherë kujdestari i tij momental duhet të shpenzojë për te, apo dikush që dëshiron ta ndihmojë

këtë foshnje.

Kujdestaria ndaj fëmijëve të braktisur.

Kujdestaria bie mbi atë person që e ka gjetur, me një kusht që kujdestari të jetë njeri besnik. Nëse kjo cilësi nuk është e pranishme te ky kujdestar dhe nëse ai njihet si njeri, i cili është i prirë për manipulime, mashtrime etj., atëherë në këtë rast duhet të ndërhyhet dhe t’i dorëzohet kujdestaria dikujt tjetër, ose nëse ekziston strehimore, që të përkujdeset për fëmijët e braktisur i dorëzohet mbikëqyrja asaj.

E drejta e Trashëgimisë.

Fëmija i braktisur nuk mund të trashëgojë askënd, deri sa nuk i dihet paraardhësi i tij. E nëse ai le pas vete pasuri, atë e trashëgojnë:

1. Gruaja dhe fëmijët e tij.
2. Bejtul mali.

3. Mendimi i saktë është se nëse nuk le trashëgimtar, pasurinë e tij e trashëgon ai që e ka gjetur dhe është përkujdesur për të e jo “Bejtul mali”, sepse ai që është përkujdesur ka dhënë mund për te. Ky është mendimi i Ibën Tejmiut dhe Ibën Kajimit.

Nëse dikush pretendon për fëmijën e braktisur që është i tij.

Nëse dikush pretendon se fëmija i gjetur është i tij, duhet t’i jepet por duke pasur parsysh dy kushte:

1. Të verifikohet një pretendim i tillë .
2. Të mos ketë pretendent tjetër për atë fëmijë në të njëjtën kohë. ■

² Të pranuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 11 dhjetor 1989.

³ Paragrafin më poshtë e kemi shkëputur nga libri “Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut” (Botim i dytë, 2001). Prof. Dr. Zejnullah Gruda, me qëllim që lexuesi të bëjë një krahasim mes asaj se kur Islami u dha të drejta fëmijëve të braktisur dhe kur lindi mendimi që të mbrohen të drejtat e njeriut me ligj: “...Pikërisht revolucionet borgjeze, të cilat kanë inspiruar Ligjin për të Drejtat të vitit 1689, Deklaratën për pavarësinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të vitit 1776 dhe Deklaratën për të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit të vitit 1789, të cilat kanë vënë standardet më të përgjithshme të të drejtave të njeriut.

⁴ “Hashijet ervul buri sherh zadul musteknij”, Abdurahman bin Muhamed bin Kasim, vëll: 5, fq. 518, Kapitulli i Shitblerjes.

⁵ Shënon Imam Buhariu nga hadithi i Ebu Hurejres.

⁶ Bejtul mal - është thesari i shtetit islam, fondi në të cilin mblidhen të ardhurat e shtetit Islam. Në sistemet tjera kjo njihet me Ministria e Financave.

TË DREJTAT E FËMIJËS NË ISLAM

Këtu do të përmend edhe abortin, si shkelje e të drejtave të fëmijëve, që është përhapur në tërë botën pa kontroll. Me abort shkelet e drejta e fëmijës për jetë

SHKRUAN: ALI SHABANI

Allahu i ka krijuar krijesat dhe ka vendosur raporte ndërmjet tyre. Të gjitha ato raporte i gjejmë në fenë e Tij. Ne si individ në shoqëri kemi detyrime ndaj Krijuesit, ndaj vetes dhe ndaj shoqërisë. Në shoqëri fëmija ka të drejta, të cilat prindi duhet t'i përmbushë. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *"Secili prej jush është bari (kujdestar) dhe secili prej jush do të pyetet për kopenë e vet. ..."* Buhariu

Në zhvillimin e fëmijës dallojmë disa etapa. Çdo etapë ka veçoritë dhe karakteristikat e saj. Periudha fëmijërore fillon me lindjen e fëmijës dhe mbaron me pubertetin e tij. Allahu i Madhëruar ka thënë: *"...Ndërsa atë që e dëshirojmë Ne, e përqendrojmë në mitër deri në një afat të caktuar, e mandej u nxjerrim foshnje..."*, pastaj në vazhdim thotë: *"... dhe ashtu të arrini pjekurinë tuaj..."* (Haxh 5).

Në Fenë Islame fëmija gjatë kësaj periudhe gëzon të drejtat e veta, që ia ka garantuar legjislacioni islam. Prej tyre janë:

Zgjedhja e bashkëshortes, apo bashkëshortit.

Kjo është pikënisja e themelimit të familjes, ku njeriu kujdeset që pasardhësit të tij t'i sigurojë nënë edukatore dhe nëna t'i sigurojë një baba të ndershëm. Për këtë flet edhe hadithi: *"Kur të vijë dikush (për të kërkuar bijën për martesë), të cilit ia pëlqeni fenë dhe moralin, martojeni, se përndryshe do të ketë sprova dhe çregullime."*

Në një hadith tjetër thuhet: *"Martohuni me atë që lind dhe që është e dashur për juve, se unë do të krenohem me numrin tuaj të madh."* Këtu vërejmë se Feja Islame është përkujdesur për edukimin e fëmijës edhe para se të lindë ai, si e drejtë e tij (e fëmijës). Këtu është mirë të përmendet edhe lutja që bën prindi para kontaktit me bashkëshorten. Për këtë i Dërguari *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *"Nëse dikush bën marrëdhënie me bashkëshorten e tij dhe thotë: "Bismil-lah, Allahumme xhennibna shejtane ue xhenibi shejtane ma rezektena" (Në emër të Allahut, o Allah, na largo shejtanin prej nesh dhe prej asaj që do na furnizosh), e pastaj Allahu e cakton që bashkëshortja të mbetet shtatzënë, asaj foshnje nuk do të mund t'i bëjë dëm shejtani kurrë."*

Trashëgimia

Të drejtën e trashëgimisë e ka edhe fëmija. Të gjithë fukahatë kanë rënë dakord që të pezullohet trashëgimia, nëse nëna është shtatzënë, derisa të lindë fëmijën për të ditur gjininë e fëmijës dhe t'i ndahet trashëgimia, meqë trashëgimia e mashkullit dallon nga ajo e femrës. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“...për mashkullin hise sa për dy femra...”** (Nisa 11).

Këtu do të përmend edhe abortin, si shkelje e të drejtave të fëmijëve, që është përhapur në tërë botën pa kontroll. Me abort shkelet e drejta e fëmijës për jetë. Në hadithin e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*, thuhet se duke qenë në mitrën e nënës i vjen shpirti. Nëse abortohet pa ndonjë shkak të arsyeshem, kjo konsiderohet si mbytje. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“...të mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë juve dhe ata...”**. (Enam 151).

Të drejtat e fëmijës pas lindjes

- Detyrueshmëria e nënës për kujdesin ndaj fëmijës.

Këtu së pari do të përmendim recitimin e ezanit në veshin e fëmijës së porsalindur.

Është nga veprat e pëlqyera në Islam dhe aty hasim në urtësi të shumta.

Prej tyre: Fëmija e dëgjon këtë thirrje të madhe, ku përmendet njësimi i Allahut të Madhëruar.

Ai fëmijë lind musliman i pastër dhe në veshin e tij depërtojnë menjëherë fjalët e shehadetit (dëshmisë). Po ashtu nga ezani ikën edhe shejtani, siç është përmendur në hadith.

- Tekniku.

Tehnik d.m.th. të përtypësh hurmën e pastaj të marrësh pak me gisht një pjesë nga ajo dhe vendosësh në gojën e foshnjës duke e fërkuar nga pak që të pikojnë disa pika në gojë. Kështu ka vepruar Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, Ebu Musa thotë: **“Më lindi një djalë dhe vajta te Pejgamberi, e emërtoi Ibrahim, ia bëri tehnikun me hurmë, bëri dua për bereqet dhe pastaj ma ktheu.”**

- Zgjedhja e emrit të mirë

Kjo është e drejta e fëmijës që duhet ta bëjë prindi, t'i zgjedhë emër të mirë me të cilin ai do të thirret të tërë jetën e tij, në dynja dhe në Ahiret. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, na ka porositur me këtë gjë në hadithin e tij: **“Me të vërtetë ju do të thirreni në Ditën e Kijametit me emrat tuaj dhe me emrat e baballarëve tuaj, prandaj zgjidhni emra të bukur”**. Emrat më të bukur janë ato emra që janë të dashura për Krijuesin tonë, emra të cilat janë në suaza të Fesë Islame. Sa për ilustrim do të përmendim hadithin e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*;; **“Emrat më të dashur tek Allahu janë: Abdullah (rob i Allahut) dhe Abdurrahman (rob i Mëshiruesit).”**

- Rruajtja e kokës

Pejgamberi ka preferuar t'i rruhet koka fëmijës mashkull në ditën e shtatë të lindjes dhe të jepet lëmoshë me peshën e flokëve në vlerë të argjendit. Na përcillet nga Enes ibën Maliku, se i Dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka urdhëruar t'ua rruajnë kokat Hasanit dhe Husejnit në ditën e shtatë të tyre dhe pastaj ka dhënë lëmoshë me vlerën e argjendit.

- Synetimi

Edhe synetimin e ka urdhëruar



“I Dërguari i Allahut ka thënë: “Mishi që rritet me haram, nuk i shpëton Zjarrit.” ...”

Pejgamberi të bëhet në periudhën fëmijërore, si e drejtë e fëmijës që e ka për detyrim ta zbatojë prindi. Gjithashtu Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka përmendur se është nga sunetet e fitres, intuitës së njeriut. Ai ka thënë: “*Pesë gjëra janë prej fitres...*” dhe ka përmendur synetimin.

- Therja e kurbanit

Therja e kurbanit i ka rrënjët e thella në historinë e njeriut dhe është një nga adhurimet e shumta. Në kohën e xhahilijetit vetë fëmijën e sakrifikonin për idhujt. Në Fenë Islame sakrifikimi bëhet me kafshë, të cilat Allahu i ka nënshtuar për njerëzit, për këtë i Dërguari i Allahut ka thënë: “*Kush dëshiron të theri kurban për fëmijën e lindur, le të theri për djalin dy dele të majme, ndërsa për vajzën një dele!*”

- Gjdhënia

Periudha e gjdhënies është dy vite, siç është përmendur në Kuran në Suren Bekare ku thuhet: “*Nënat, ato që duan ta plotësojnë gjdhënien, janë të detyruara t’u japin gj fëmijëve të vet dy vjet të plota. ...*” Bekare 233. Në lidhje me këtë në tekstet e burimeve të sheriatit islam gjejmë se Feja Islame është kujdesur për këtë veprim, kur e ka toleruar nënën në këtë periudhë që mundet ta lerë agjërimin, që është detyrim i saj.

- Furnizimi dhe veshmbathja

Nga të drejtat e fëmijës janë edhe furnizimi i tij dhe veshmbathja. Allahu i Madhëruar ka thënë: “*...I ati i fëmijës është i*

detyruar me furnizimin dhe veshmbathjen e tyre (gruas) ashtu si është rregull...”. Bekare 233. Këtu do të përmend se nga të drejtat e fëmijës është që prindi të fitojë pasuri me hallall, ta ushqejë fëmijën e tij dhe ta veshëmbathi me hallall. I Dërguari i Allahut ka thënë: “*Mishi që rritet me haram, nuk i shpëton Zjarrit.*”

- Edukimi

Nga të drejtat e fëmijës janë edhe edukimi me frymën e Islamit. Kjo pikë ngërthen në vetvete një tërësi të madhe elementesh dhe angazhim të pandërprerë. Në këtë sferë prindërit duhet të kujdesen për shumë gjëra: fëmija të përfitojë virtyte të mira, t’u largohet veseve të këqija. Të kujdeset për shoqërinë e tij, për mësimin dhe shkollimin e tij e kështu me radhë. Ai duhet t’i mësojë atij detyrimet fetare, si namazin, agjërimin etj. T’i mësojë etikën Islame, si thënia e besmeles para ngrënies dhe pijes, falënderimi pas hajes, ngrënia dhe pija me dorën e djathtë. Nderimin e prindërve, dijetarëve dhe më të moshuarve etj.

- Kujdesi për zhvillimin e fëmijës dhe ruajtja e shëndetit të tij

Nga të drejtat e fëmijës në Islam është që prindërit të kujdesen për zhvillimin e tij trupor dhe po ashtu kur të sëmuret të ndërmarrin veprimet e duhura për shërimin e tij.

Ka edhe shumë të drejta të tjera që i kanë përmendur dijetarët islamë në librat e fikhut dhe të tjera edhe për raste të jashtëzakonshme, si p.sh. në rastin e ndarjes së prindërve, apo në rast se vdesin dhe mbetet jetim, e kështu me radhë.

Të drejtat e fëmijës në Islam janë shumë, por këto janë më kryesoret, Allahu e di më së miri. ■

KUR DO TË FILLOSH?



Atëherë fillo tani!!! Udhëtimi më i gjatë fillon me një hap, poezia më e bukur nis me një strofë dhe ndërtesa më e lartë starton me një kat. Nëse dëshiron këshilla praktike, atëherë qëndro me mua.

SHKRUAN: AGRON TERZIQI

Të gjitha përgatitjet dhe gjërat që ke bërë deri më tani konsiderohen si një angazhim i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për hapat që do të ndërmarrësh më tej. Mirëpo realisht ato nuk kanë kurrfarë vlere nëse nuk e ke përcaktuar paraprakisht kohën zero për fillimin e realizimit të projektit tënd. A mjafton të planifikosh një udhëtim, ta përgatitesh mirë, t'i bësh gati të gjitha gjërat që të nevojiten dhe t'i vendosësh

në makinë, pastaj t'i lësh të gjitha sendet aty, ndërsa ti vazhdon jetën e përditshme si zakonisht?

Sigurisht pajtohesh me mua se kjo sjellje është një budallallëk i vërtetë. I tërë ky mund do të shkojë huq, sepse thjesht nuk ke përcaktuar kohën kur do të nisesht për në udhëtim, nuk e di për sa kohë do të mbërrish atje dhe se me çfarë shpejtësie duhet të udhëtosh që të arrish në kohë.

Fillo tani. Nisja është gjëja më e vështirë në të gjitha punët. Çdo gjë madhështore që sheh në këtë botë ka

nisur me një ide të thjeshtë, mirëpo vetëm idetë nuk ndryshojnë asgjë, sepse lypset patjetër që idetë që ke në kokë të konvertohen në realitet, e që më pas realiteti me ndikimin e tij të të çojë drejt një të ardhme të lumtur. Çfarë dobie kanë ëndrrat, idetë dhe planet nëse nuk shndërrohen në vepra të dobishme që preken me duar, shihen me sy dhe ndihen me veshë. Bota është e mbushur plot me imagjinues të mrekullueshëm, mirëpo ata janë si të vdekurit, të cilët nuk kanë kurrfarë ndikimi, ndërsa çfarë shohim prej sukseseve, arritjeve dhe zbulimeve, të cilat e kanë ndryshuar imazhin e botës janë punë e aktivistëve të palodhshëm. Ata i realizuan ëndrrat e tyre me dërsë dhe angazhim. Lumturia e vërtetë arrihet vetëm nëse i bëjmë realitet ëndrrat dhe aspiratat tona, e jo thjesht duke i lënë ato të mbesin të atilla.

A ke dëshirë që vetëm të ëndërrosh e pastaj të zgjohesh nga gjumi e të zbulosh se ato ishin vetëm një iluzion i çastit, që tanimë i takon të kaluarës? Sigurisht që jo.

Atëherë fillo tani!!! Udhëtimi më i gjatë fillon me një hap, poezia më e bukur nis me një strofë dhe ndërtesa më e lartë starton me një kat. Nëse dëshiron këshilla praktike, atëherë qëndro me mua.

Kurrë mos thuaj do të filloj nesër

Nëse sot ke kohë, atëherë pse e le punën për nesër? A je i sigurt se koha do të jetë në dispozicionin tënd edhe nesër? Ditët ecin ndërsa ti akoma deklaron se do të filloj nesër. A e di se çfarë fsheh e nesërmja?

Ajo që është e konfirmuar është vetëm e tashmja. Ajo i ngjason shumë parave që ke në duar me të cilat bën çfarë të duash. E djeshmja është sikurse çeku, i cili ka shkuar në xhirollogarinë tënde, është

harxhuar dhe nuk konsiderohet më pasuri e jotja, ndërsa e nesërmja është sikurse çeku i afatizuar prej të cilit nuk mund të përfitosh tani, sepse duhet prituri deri te një e ardhme, e cila nuk është e garantuar. Një herë i kanë thënë Omer ibën Abdulazizit: Pse nuk ndalesh të pushosh e pjesën e mbetur të punës ta vazhdosh nesër?! **Sot nuk po mundem, sipas jush, të përfundoj punën e sotme, e si do ta kryej nesër edhe këtë e edhe punën e së nesërme,** u përgjigj ai.

Ngecja dhe vonimi nuk është në interesin tënd. Mos e mashtro veten duke thënë: Do të filloj nesër, verën e ardhshme, pas ramazanit, pas diplomimit, pas martesës...!

Nëse je i bindur se vendimi yt është i drejtë, atëherë fillo tani, shndërroje ëndrrën në realitet sepse koha nuk pret.

Mos u bëj vetëm një shikues pasiv

Një mendimtar i urtë thotë: Jeta është si një mbrëmje gala. Disa arrijnë me vonesë, disa e braktisin atë para se ajo të përfundojë, ndërsa ka prej atyre që mbesin edhe pasi të shkojnë shumica e të ftuarve. Në këtë shfaqje solemne reflektorët përqendrohen vetëm te disa yje, ndërsa shumicën e të pranishmëve nuk i shikon askush dhe prezencën e tyre nuk e vëren asnjëri. Kur dritat ndalen të gjithë janë njësoj, ndërsa kur përfundon spektakli çdokush kthehet nga ka ardhur.

Ky është një perceptim material dhe i mangët i kësaj bote, sepse njerëzit nuk vlerësohen tek Allahu sipas formaliteteve të pavlera, që disa mashtrohen se i tërë suksesi fshihet aty. Mirëpo prej këtij përngjasimi mund të përfitojmë duke pyetur veten: A dëshiron të arrish në këtë jetë me vonesë? Natyrisht që jo. A ke dëshirë që në këtë botë të jetosh si një i panjohur? Absolutisht jo? A je i pajtimit

që të transferohesh nga kjo botë pa lënë ndonjë gjurmë të mirë, e cila nuk do të harrohet? Sigurisht që jo.

Atëherë fillo që tani rrugëtimin drejt suksesit, sepse ai nuk vjen te ti.

Nëse e fajëson veten tani, nesër do ta fajësosh edhe më tepër

Amiri dhe Samiri djem të rinj të moshës tridhjetë vjeçare qëndronin në një cep të mexhllisit dhe flisnin për rastet e humbura që kanë pasur në jetë dhe qanin për to. Në të njëjtën kohë Aliu dhe Abasi të moshës pesëdhjetë vjeçare në cepin tjetër bëjnë të njëjtën bisedë dhe ankohen dhe ndjejnë keqardhje të madhe për mosshfrytëzimin e shanseve të mëdha që ata kanë pasur mundësi. Ajo çfarë pritet është që Samiri dhe Amiri të vazhdojnë të pikëllohen dhe të qajnë hallin e tyre për gjërat që u kanë ikur edhe për njëzet vite të tjera, ashtu siç janë duke bërë tani Aliu dhe Abasi në këtë moshë.

Gjëja më e rëndësishme lidhur me këtë fakt është se nëse tani nuk bën asgjë, do të mbetesh duke përsëritur të njëjtat ankesa edhe pas 20 vitesh. Vetëm ankimi, keqardhja dhe vajtimi për gjërat që të kanë ikur, nuk do të ndryshojnë dhe nuk do të përmirësojnë asgjë. Për këtë arsye është jetike që gjërat që synon t'i arrish pas 20 vitesh, t'i fillosh që tani.

Përdor kalendarin

Zvarritja konsiderohet një prej shkaqeve kryesore të dështimit dhe është armiku kryesor i suksesit. Për këtë shkak është shumë e rëndësishme ta konsiderosh atë hasm të vërtetë, duke mos i lënë fare hapësirë që të depërtoj tek ti.

Vendos data të caktuara në kalendarin tënd për t'i realizuar objektivat. Ashtu siç duhet të jenë synimet e tua të

“Vetëm ankimi, keqardhja dhe vajtimi për gjërat që të kanë ikur, nuk do të ndryshojnë dhe nuk do të përmirësojnë asgjë...”

përcaktuara duhet që edhe datat të jenë të caktuara me përpikëri, tek njerëzit e suksesshëm nuk ka vend për vonesë, shtyrje dhe zvarritje.

Prej simptomave të zvarritjes janë: të menduarit e tepërt, dembelia, përgjigjja ndaj zbavitjeve, të cilat ta humbasin kohën dhe të devijojnë nga rruga e objektivave të tua, biseda telefonike të gjata dhe të përsëritura, vizitat, shoppingu, dhënia pas komoditetit, dëshira për të fjetur, shikimi i televizorit, preokupimi me gjëra dytësore dhe jo të rëndësishme duke e bindur veten se je duke punuar etj...

Kalendarët si instrument janë të pranishëm në të gjitha libraritë dhe në formate të ndryshme. Të njëjtën gjë ndoshta edhe më mirë këtë rol tani mund ta luajë celulari.

Ku je nisur?

Fatkeqësisht, të paktë janë ata persona që për jetën e tyre bëjnë plane edhe pse jeta është gjëja më me vlerë që zotërojmë. Nuk mund të paramendohet që dikush të deklarojë se jeta nuk është më e rëndësishmja apo ka diçka edhe më të vlefshme se ajo.

Rruga drejt objektivave të mëdha është zinxhir i objektivave të vogla, ose hapa të njëpasnjëshëm të cilët të afrojnë për çdo ditë tek objektivi kryesor. Prandaj kjo rrugë duhet të ketë patjetër shenja të

qarta, sepse arsyeja kryesore e dështimit për t'i realizuar synimet është paqartësia e rrugës.

Shkaqet më të shumta të dështimit, dëshpërimit dhe zvarritjes janë ndjenja e madhësisë dhe e largësisë së objektivave, për shkak se shpirti i urren vështirësitë dhe nuk e ndjen distancën. Ndaj është shumë e rëndësishme që ta mashtrosh shpirtin duke e ndarë objektivin e madh në synime të vogla ditore, kjo do t'ia lehtësonte atij dhe do t'i sillte një komoditet më të madh. Paskëtaj do të vendosësh synime javore, të cilat do të çojnë tek synimet mujore, ndërsa këto të fundit do të çojnë tek objektivat vjetore, ndërsa në përfundim kjo mënyrë do të të mundësojë ta realizosh objektivin tënd madhor edhe në qoftë se ky proces do të zgjatë me vite. E rëndësishme është se në fund ti do të korrësh sukses dhe do të triumfosh.

Shembull: Nëse mëson përmendësh katër ajete kuranore në ditë, kjo të mundëson memorizimin e 28 ajeteve në javë, më shumë se 112 ajete në muaj dhe diku rreth 1460 ajete në vit. Ndaj me lejen e Zotit të tërë Kuranin mund ta memorizosh përafërsisht brenda katër viteve e tre muajve.

Gjatë rrugëtimit tënd mbaje me vete një bllok shënimesh

Në këtë bllok shkruaj çfarë ke arritur deri më tani me qëllim që ta mbash entuziazmin përherë të ndezur. Përqendroji sytë tek objektivi yt i largët, vëzhgoje atë duke t'u afruar pak e nga pak, mos u shmang prej tij për shkak të objektivave anësore. Ajo çfarë të ndihmon në kontrollin e shpejtësisë dhe drejtimin e rrugëtimit është të përdorësh skemat, skicat, dhe diagramet, të cilat e konvertojnë para teje hartën e rrugës gjer

tek objektivat e tua. Këto të ndihmojnë dukshëm për të kontrolluar rrugëtimin, duke parë saktësisht se sa ke përshkuar? Sa të kanë mbetur? Kah je drejtuar?

Mos e tepro në planifikim

Prej shkaqeve më të përhapura të dështimit është: objektivat e shumta, të cilat nuk kanë asgjë të përbashkët, këto pastaj shndërrohen në iluzione dhe shpresa të kota për shkak se bëhen të pamundura për t'u realizuar. Edhe po qe se këto janë objektiva reale do të kenë nevojë për kohë dhe kapacitet, mos e kthe veten në grykë shisheje në të cilën ngecin të gjitha planet dhe thyhen të gjitha shpresat. Të mjaftojnë të kesh dy deri në tri objektiva me shenja konkrete, të përcaktuara dhe të identifikuara mirë, në gjendje për t'u realizuar dhe të përcaktuara në kohë, ndërsa objektivat e tjera mund t'i përcaktosh më vonë dhe të bësh plane të detajuara për to.

Kush është përgjegjës?

Kur përcakton një synim patjetër duhet të jesh në gjendje që t'i dish qartë përfitimet prej tij, ngase në jetë nuk ka kohë për të humbur në gjëra në të cilat s'kanë kurrfarë leverdie. Nëse në synimin që ti ke caktuar nuk ke asnjë fitim atëherë fshije menjëherë nga lista e objektivave, dije se nuk ka asnjë arsye që ai të qëndrojë aty, bile mund të ketë ndikim negativ në llogaritë e synimeve të tjera, të cilat janë më të rëndësishme dhe më të dobishme.

Vetja së pari!

Mos u zër me punët e të tjerëve. Një prej shtytësve kryesor të suksesit është ta udhëheqësh vetë anijen e jetës tënde dhe të mos preokupohesh me atë çfarë dëshirojnë të tjerët. Që ta kuptosh vetveten dhe ta provosh shijen e jetës

duhet t'i bësh patjetër vetes këtë pyetje: "Unë jetoj për vete, apo ka edhe njerëz tjerë për të cilët gjithashtu jetoj?" Mirëpo realisht ashtu siç e kuptoj unë është se ti, nëse jeton për vete ajo çfarë të rrethon duhet të vijë në rend të dytë, jo nga egoizmi dhe dashuria ndaj vetes, mirëpo për faktin se ai që nuk mund t'i bëjë mirë vetes nuk mund t'i bëjë mirë askujt tjetër.

Kur udhëtoja një herë me avion dhe kapiteni po jepte si zakonisht instruksionet që duhen ndjekur në rast se ndodh ndonjë problem në avion, më habiti fakti se ai këmbëngulte se udhëtari është i detyruar që ta vendos maskën më të afërt të oksigjenit, në qoftë se avioni do të ketë ndonjë defekt, ndërsa pastaj ai është i detyruar që maskën tjetër t'ia vendosë fëmijës, i cili është duke udhëtuar së bashku me të. Meditova për pak kohë rreth këtij fenomeni, sepse kisha parasysh që shqetësimi i prindërve do t'i bëjë ata që të veprojnë të kundërtën, të preokupohen me fëmijët që t'i rehatojnë fillimisht ata e pastaj të shikojnë veten. Mirëpo logjika e pastër thotë se ti nuk mund t'i ndihmosh dikujt tjetër para se ta ndihmosh veten.

Bëhu ti lideri

Nëse je përgjegjës për dikë tjetër, atëherë suksesi yt do t'u sjellë dobi të gjithë atyre që janë mbrapa teje, ashtu sikurse në të kundërtën dështimi yt do t'i fundosë të gjithë ata që varen nga ti. Nëse nuk interesohesh për jetën, shëndetin dhe të ardhmen tënde dhe atë që lidhet me të mirat e fesë dhe të mirat materiale tuat, nuk do të jesh në gjendje të përmirësosh çështjet e të tjerëve, qofshin ata fëmijët, familja apo shoqëria jote. Një fjalë e urtë thotë: "Mbi supet e njeriut të suksesshëm jetojnë 1000 të tjerë, të gjithë marrin pjesë në arritjet e tij." A dëshiron

që ti të jesh lideri i këtij rrugëtimi apo ke dëshirë që të jesh vetëm një pjesëmarrës i thjeshtë në të?

Vendimet merri shpejt

Para se ndryshimi efikas ta merr pozitën e tij duhet të jesh patjetër i gatshëm që të mbartësh përgjegjësinë e pozicionit të ri, me të gjitha ato gjëra që kërkojnë, siç janë vendimet e rëndësishme të cilat i ndërmerr për shkak të një vetëbesimi të lartë dhe bindjes për sukses. Pas Allahut të Madhërishëm, ti tani je i vetmi që kontrollon jetën tënde, nuk do të jesh në gjendje të kënaqesh me sukseset e ardhshme, nëse luan rolin e viktimës apo vendos që të dorëzohesh dhe të kapitullosh para barrierave.

Ki parasysh gjithmonë se njerëzit e suksesshëm i marrin vendimet e tyre shpejt mirëpo i ndryshojnë ngadalë, ndërsa dështakët vendimet i marrin ngadalë dhe i ndryshojnë shumë shpejt.

Mos prit që të gjitha vendimet që do të marrësh të jenë të lehta dhe të thjeshta, ka sëmundje për të cilat nuk ka ilaç përveç se me amputim ose me prerje, edhe pse kjo është e dhimbshme. Ka vendime të rëndësishme që duhet t'i ndërmarrësh patjetër, edhe pse janë shumë të vështira dhe të hidhërojnë shumë njerëz.

Nëse rrëzohesh, atëherë përpiku përsëri

Suksesi në të shumtën e rasteve ndodh si rezultat i vendimeve të qëlluara, marrja e vendimeve të tilla vjen si shkak i përvojës, ndërsa përvoja shpeshherë arrihet si rezultat i vendimeve të gabuara. Mos u çudit nëse dështon një, dy apo tri herë, bile edhe më tepër; gabimi mund të jetë rruga drejt suksesit.

Ky është shikimi real i jetës, ti je rrëzuar në tokë me dhjetëra herë para se

të mësosh ecjen, ke thyer rregullat e komunikacionit shumë herë para se të mësosh si duhet vozitjen e makinës.

Ti ke korrur sukses në të gjitha këto, vetëm kur ke marrë përgjegjësinë e gabimeve të tua dhe ke nxituar të mësosh prej tyre, me qëllim që ta përmirësosh rrjedhën e jetës tënde.

Mirëpo si është gjendja jote reale? Ai i merr ti vendimet apo synon vetëm t'i kënaqësh të tjerët? A je i gatshëm që t'i përmbahesh objektivave të tua? Apo bën lajka edhe në llogari të interesave të tua?

Nuk është e rëndësishme të dështosh, mirëpo është e rëndësishme të ngrihesh përsëri pas rrëzimit, ta fshish pluhurin nga pantallonat, të ngrihesh në këmbë dhe të thuash duke buzëqeshur: "Falënderimi i takon Allahu që më shpëtoi." Edhe më e rëndësishme është që të përfitosh nga dështimi dhe të krijosh prej tij një rast të ri për një fillim të mbarë.

Ji i bindur se nuk do të mbarosh nëse humbet, askush nuk ka garanci për sukses dhe mos humbje. Do të humbasësh vetëm atëherë kur të heqësh dorë nga gara e jetës dhe të kënaqesh me ngecjen në vend.

Përparo në përgjegjësitë e tua

Ka kaluar koha e rehatisë, joseriozitetit, zbavitjeve dhe lojërave të fëmijërisë. Ka trokitur ora e punës së matur dhe serioze. Në këtë uzinë të gjerë dhe të madhe, e cila quhet univers ti ke një rol që duhet ta kryesh me zell dhe përgjegjësi. Allahu i Madhëruar thotë: **"Atëherë ti, o njeri, që përpiqesh shumë, mundin tënd do ta gjeshe te Zoti yt."** (Inshkak, 6)

Ndjenja e përgjegjësisë është pasurim i dimensioneve të personalitetit, në

“Ki parasysh gjithmonë se njerëzit e suksesshëm i marrin vendimet e tyre shpejt mirëpo i ndryshojnë ngadalë, ndërsa dështakët vendimet i marrin ngadalë dhe i ndryshojnë shumë shpejt...”

varësi të sasisë së kohës dhe mundit që merr, ajo të dhuron mendje më të hapur, fuqi më të madhe për të mbartur, përvojë më të pasur dhe njohuri më të gjera. Dallimi në mes të atij që ndjen përgjegjësi ndaj vetes dhe të atyre që e rrethojnë dhe atij që e kalon kohën në lojë, në gjëra të kota, në vepra kaotike dhe rutinë të mërzitshme është se: I pari me mbartjen e përgjegjësisë dhe vështirësive shndërrohet në një njeri me vizion, i cili lëviz drejt objektivave e qarta, ndërsa i dyti lëviz në të gjitha drejtimet në varësi të epsheve dhe qejfeve, duke pësuar vetëm fiasko në këtë botë dhe në botën tjetër. Sa e bukur është fjala e Allahut në lidhje me këtë fakt: **"Mendo pak! Kush, përveç Allahut, mund ta udhëzojë atë njeri, që dëshirat e veta i ka bërë zot; atë njeri, të cilin Allahu, duke e njohur për të tillë, e ka shpënë në humbje, duke ia vulosur dëgjimin dhe zemrën e duke i vënë perde para syve të tij?! A nuk po merrni vesh?"** (Xhathije, 23.) ■

PREZANTIM I LIBRIT:

HISTORIA E PEJGAMBERËVE RRËFIME PËR FËMIJË



Të dashur lexues të revistës tonë dhe tuaj Albislam, duke pasur parasysh temën e këtij numri, e cila i dedikohet fëmijëve zgjidha të prezantoj para jush botimin e paradokshëm të librit “Përmbledhje për fëmijë - Historia e pejgamberëve” të autorit Semih Atif Zejn, nga shtëpia botuese “NUN”.

SHKRUAN: SEDAT SHABANI

Kjo buqetë librash përmban historitë e famshme të njerëzve të zgjedhur nga Allahu, që edhe i krijoi e pastaj i dërgoi për të na udhëzuar e për të na mësuar më të mirat e jetës së kësaj bote. Bëhet fjalë për rrëfime që rrjedhin nga ajetet kuranore **“dhe ne ty të rrëfejme rrëfimet më të mira”**. Pra, prindër të nderuar, ky libër është një komplet prej njëzet libërthash, ku do të gjeni inspirimin tuaj për edukimin e njerëzve tuaj më të dashur për të cilët pikërisht ju jeni të detyruar me amanet nga Krijuesi i Gjithësisë.

Historitë në fjalë i dedikohen moshës së adoleshentëve, të cilët sapo janë përshëndetur e kanë lënë pas gjuhën e të miturve, por shumë mirë e kuptojnë dhe dinë të flasin edhe me gjuhën e të rriturve. Thjeshtësia e të folurit dhe lehtësia e shprehjeve të përdorura në këtë libër e bëjnë lexuesin më të interesuar për përmbajtjen e tij dhe në të njëjtën kohë ia shtojnë interesimin për temat e jetës së të gjithë pejgamberëve. Vlen të përmendet se botimi në gjuhën arabe nuk e përfshin jetën dhe historinë e vulës së pejgamberëve Muhamedin *sal-lallahu alejhi ue selem*, meqë në atë gjuhë ka shumë jetëshkrime të veçanta për të, *sal-*

lallahu alejhi ue selem.

Ne si botues të kësaj buqete historish të luleve të njerëzimit deshëm t'ia bashkëngjitem edhe historinë e Muhamedit *sal-lallahu alejhi ue selem*. Patëm dëshirë që fëmijët shqiptarë ta kenë më të afërt historinë e gjithë vëllezërve pejgamberë. Meqë vetë Muhamedi *sal-lallahu alejhi ue selem* në një hadith e përshkruan vëllazërinë e pejgamberëve duke thënë: *“Shembulli im dhe shembulli i pejgamberëve para meje është si shembulli i një ndërtese, ku ka boshllëk vetëm për një tullë... ajo tullë jam unë dhe me mua u plotësua vargu i pejgamberëve”*. Jetëshkrimi për Muhamedin *sal-lallahu alejhi ue selem*, që u vendos në këtë libër u mor nga libri i mirënjohur “Shkëndija nga jeta e të Dërguarit dhe dhjetë të përgëzuarve” i autorit Abdulgani Makdisi.

Le të shpresojmë që sado pak ta kemi plotësuar nevojën tonë për njohuritë që duhet t'iu japim më të dashurve tanë e me këtë të zëvendësojnë tregimet dhe filmat vizatimorë të kota, që zgjojnë tek mosha e njomë vrazhdësi, dhunë dhe besime të rrejshme.

Duke shfletuar këto libërtha ju do të mund t'i rrëfeni fëmijëve tuaj për babain e njerëzimit, Ademin alejhi selam, të cilit Allahu i mësoi emrat, e me këtë do të keni rast të hidhni poshtë tezat helmuese darviniane të evolucionit, se prejardhja jonë vjen nga majmunët. Pastaj do t'i njoftoni me përpikërinë e Nuhit alejhi selam, që 950 vjet rresht e ftoi pa u lodhur popullin e vet vetëm në atë që i bën dobi edhe sot njerëzimit shmangien nga e keqja dhe shirku, për ndërtimin e anijes, e cila me ndihmën e Allahut shpëton besimtarët së bashku me shumë lloje kafshësh. Po ashtu keni rrëfime interesante për Salihun alejhi selam, Ibrahimin *alejhi*

selam, i cili për dashurinë e Zotit të vet u tregua i gatshëm të flijojë bimën e zemrës së vet Ismailin alejhi ma selam. Do të lexoni për Jakubin – dashurinë e babait për djalin e humbur Jusufin *alejhima selam*, i cili në fund takohet sërish me të si sundimtar. Durimi në sëmundjen e rëndë shtatëvjeçare të Ejubit alejhi selam dhe mos-humbjen e shpresës tek Allahu. Nëna e pejgamberit Musa alejhi selam, e cila nga rreziku i faraonit e lëshoi foshnjën në ujërat e lumit Nil, duke e lutur Allahun ta ruajë atë, e Allahu nuk e humb lutjen e sinqertë, e rriti Musain në oborrin e faraonit dhe ia mundësoi të pijë nga gjiri i nënës së vet.

Mos lejoni t'i helmoni fëmijët tuaj me gënjeshtat e Supermenit dhe Spajdermenit, por mësojini ata me të vërtetat e Kuranit, mrekullitë e Musait me hapjen e detit dhe shpëtimin e popullit të vet. E kështu me radhë do të gjeni histori plot me urtësi, sikurse ato të Davudit, Sulejmanit, Junusit në barkun e peshkut, Isait birit të Merjemes *alejhim selam* e deri tek Muhamedi *sal-lallahu alejhi ue selem*.

Këtu do të gjeni plotësimin e premtimit të Allahut, se ***“tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi të sinqertë”***. Këto karaktere do ta pasurojnë personalitetin e fëmijës tuaj me çka do të jetë i dobishëm, së pari për veten e vet, prindërit, familjen e me këtë edhe shoqërisë ku jeton. Kjo ka qenë edhe porosia e dërgimit të pejgamberëve, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ta.

Lus Allahun që ky libër të jetë vepër e sinqertë me çka do ta arrijmë kënaqësinë e Allahut në këtë dhe në botën tjetër. ■



NËNË, MË RRËFE PËR PEJGAMBERËT

SHKRUAN: REMZIJE KURTISHI

Nënë!

- Është vetëm një fjalë e ëmbël, këtë fjalë do ta dëgjosh dhe do ta ndjesh ëmbëlsinë e saj vetëm atëherë kur Allahu do të dhurojë fëmijë.

Kjo krijesë e vogël që fillon qysh në barkun tënd dhe pastaj ta zë rrugën, sepse vetëm ty të njeh, vetëm ty të shikon, të përcjell dhe nuk duron dot të largohesh asnjë moment. Hapat e para i bën drejt teje, tërheq fustanin tënd, ulet në prehrin tënd, fillon e të thërret nënë. Nënë, Nënë... sepse ti je shtylla në të cilën mbështetet, kandili që ia ndriçon hapësirën. E fëmija yt është si një letër e bardhë, që në të mund të

shkruash çfarë të duash, ndërsa ai kërkon dhe vetëm kërkon që ta mbushë dhe ta ngjyrosë këtë letër, sepse nuk mund të qëndrojë e bardhë. Ndërsa ti Nënë e dashur je ajo që në njërin dorë mban lapsin e në tjetrën brushën me ngjyra, herë shkruan, herë ngjyros.

Dhe kështu...

- Një ditë të nxehtë vere bënte shumë vapë, kishim vendosur të shkojmë në fshat, sepse vetëm flladi i atjeshëm mund të na e freskonte shpirtin. Rruga ishte pak e lodhshme, dielli me rrezet e tij të kapte në çdo çast, por gjelbërimi i natyrës, drunjtë përreth rrugës e bënë më të lehtë këtë udhëtim.

- Selam alejkum gjysh, ne erdhëm.

- Alejkum selam fëmijë të dashur,

qenkeni nxehur e përvëlur.

- Po është shumë vapë, ne do të lahemi në pishinë; të lutemi gjysh na ndihmo ta mbushim me ujë.

Oh sa kënaqësi!

- Kujdes fëmijë mos e derdhni ujin pa nevojë, ne duhet ta ruajmë atë, sepse me të ujisim kopshtin, përgatisim ushqimin, ja tani ju po freskoheni, nuk jetohet pa të!

- Nënë ç'janë këto?!

- Anije prej letre.

- Sa të mira i ke bërë si me qenë të vërteta, shih-shih sa bukur lundrojnë mbi ujë. Kush ta ka mësuar ty këtë?!

- Nëna ime.

- Nënë edhe anijet e mëdha bëhen prej letre?

- Jo bir, ato ndërtohen prej druri, hekuri ose prej ndonjë materiali tjetër.

- Po si nuk fundosen?

- Sepse deti është i gjerë, ka shumë ujë dhe anija lundron më lehtë.

- Nënë na rrëfe për Nuhun, *alejhi selam*, dhe anijen e tij.

- E harruat?!

- Jo por duam të na e rrëfesh përsëri.

- Edhe kësaj here po ua rrëfeje, sepse herëve të tjera do të ma rrëfeni ju mua.

- Nuhu, *alejhi selam*, është një prej të dërguarve të hershëm, që e ka dërguar Allahu i Lartësuar tek njerëzit. Ai ka jetuar shumë gjatë, afro një mijë vjet.

- Një mijë vjet! Aq sa di unë të numëroj deri tek njëshi me tre zero?

- Po pikërisht aq dhe vazhdimisht e ka ftuar popullin e vet që ta besojë Allahun, Krijuesin e çdo gjëje, vetëm Atë ta adhurojë, por shumica e njerëzve nuk iu përgjigj.

- Pse s'e dëgjuan, mos vallë ishin të shurdhër?

- Jo, nuk ishin të shurdhër, por nuk donin ta dëgjonin, sepse nuk i besonin Nuhut *alejhi selam*, se po flet të vërtetën. Për shembull kur unë të them ty: mos kështu se

nuk bën, por ti nuk më dëgjon dhe e bën, pse a je i shurdhër?!

- Jo, por ndonjëherë habitem, por kur gaboju unë vazhdimisht kërkoj falje.

- Pra, disa nga ata kurrë nuk e kuptuan gabimin, as nuk u penduan për atë. Çfarë u thoshte Nuhu, *alejhi selam*, popullit të tij? **"...që të adhuron vetëm Allahun.** (Përndryshe), **unë kam frikë për ju dënimin e një Dite të dhembshme".** (Hud, 26) **"Allahu për ju e ka bërë Tokën shtrojë të gjerë. Që të ecni nëpër të, nëpër rrugët e gjera."** (Nuh, 19-20)

- Nënë ata njerëz, a ishin të verbër! A nuk e shihnin ata, se Allahu sa të mirë e të gjerë e ka bërë Tokën, plot rrugë, gjelbërime, kodra, pyje, liqene e dete të mëdha!

- Nuk ishin të verbër me nënën, e shihnin, edhe ata jetuan në këtë Tokë, ecën nëpër këto rrugë, lundruan nëpër këto dete, por siç ju thashë nuk besonin se Allahu duhet të respektohet dhe adhurohet, prandaj nuk e dëgjuan Nuhun, *alejhi selam*. Por kësaj mosbindje dhe mosbesimi i erdhi fundi, kur një ditë Allahu i tha Nuhut, *alejhi selam*, të ndërtojë një anije, sepse do të ndodhë një vërshim i madh dhe çdo gjë do të përmbetet. Ndërsa Nuhu *alejhi selam*, po ndërtonte anijen e tij populli i vet vazhdonte ta përqueshte atë. Por Nuhu, *alejhi selam*, e vazhdoi punën dhe kur e mbaroi atë Allahu i tha: **"Ngarko në anije nga çdo lloj gjallese nga një çift..."** (Hud, 40)

- Nga të gjitha, të gjitha gjallesat?! - Pëllumb, flutur, mace, luan, lepur, lopë, dash, pulë, kalë, deve...?!

- Po, po pikërisht ashtu.

- Nënë ajo anije paska qenë shumë-shumë e madhe! Njerëzit që talleshin ku mbetën?

- Mbetën në vendin e tyre dhe vazhduan të jenë kryeneçë derisa i përfshiu vërshimi. Por edhe sikur të besonin tashmë ishte vonë, dallgët e ujit i mbuluan, e në mesin e

tyre ishte edhe djali i Nuhut, *alejhi salam*.

- Në mesin e atyre që nuk besuan?

- Po.

- Ai e thirri: *"O biri im, hip me ne e mos u bëj me mohuesit!"* (Hud, 42)

(i biri tha): *"Unë do të strehohem në një mal, i cili do të më ruajë nga uji."*

Nuhu, *alejhi salam* iu përgjigj: *"Sot askush nuk do të kursehet nga dënimi i Allahut, përveç atij që e mëshiron Ai!" Një valë në mes tyre i ndau dhe ai u fundos."* (Hud, 43)

- Sa keq që nuk e dëgjoi babën e vet!

- Ashtu është bijë, Allahu tek çdo popull ka dërguar pejgamberë, që t'i thërrasin në rrugën e vërtetë, ta besojnë Allahun se Ai është i Vetmi Krijues i Tokës, ujit, diellit, hënës... *"Ai ju lëshon nga qielli shi me bollëk... Ju bën të keni kopshte dhe ju jep lumenj."* (Nuh, 11-12)

- Nënë po të mos na jepte Allahu ujë, ne nuk do të kishim me se ta mbushnim pishinën që të freskoheshim në këtë ditë kaq të nxehtë!

- Ashtu është, prandaj duhet thënë: ELHAMDULILAH RABIL ALEMIN (Çdo lavd-falënderim i përket Allahut, Zotit të botëve.)

Pra, nënë e dashur, ti që e mban penën e artë në dorë, mos e neglizho për asnjë çast fëmijën tënd, edhe atëherë kur ai loz me anije letre, shkruaje të vërtetën në shpirtin e tij të bardhë, sepse të vërtetën nuk e fshin dot asnjë lloj gome e botës dhe fëmija yt do ta kujtojë edhe atëherë kur do të lundrojë me anije të vërtetë... ■

MBRONI FËMIJËT TUAJ

një numër i madh i tyre i japin rëndësi mësimeve fetare si namazin, nënshtrimin ndaj Allahut dhe të Dërguarit të tij, si dhe moralin e lartë që duhet të ketë një fëmijë duke i neglizhuar gjërat e jetës së përditshme

DR. MUHAMED DUVEJSH

Nga Xhabiri na përcillet se Pejgamberi ka thënë: **"Kur të bjeri nata ndaloni fëmijët tuaj, me të vërtetë shejtanët shpërndahen në këtë kohë, pasi të kalojë një farë kohe lejoni të lirë ata. Mbyllni dyert dhe përmendeni Allahun (thoni bismillah), sepse shejtani nuk mund ta hapë atë derë, mbulonin enët dhe përmendeni Allahun, qoftë duke vendosur edhe diçka mbi to, dhe fikni zjarret".** (p.sh.: qirinjtë, llambat me gaz, zjarri i hapur). Buhariu e Muslimi.

Në transmetimin tjetër nga Xhabiri thuhet se Pejgamberi ka thënë: **"Mos i lironi bagëtisë e as fëmijët kur të perëndojë dielli, deri sa të bjerë muzgu i natës, sepse shejtanët shpërndahen kur perëndon dielli, deri sa të largohet muzgu i natës (të erresohet)."** Buhariu dhe Muslimi.

Imam Neveviu këtë hadith e komenton kështu:

kur të bjerë nata – kur fillon të errësohet, **ndaloni fëmijët tuaj**- mos i lejoni të dalin jashtë në këtë kohë,

vërtet shejtanët shpërndahen – ekziston frika për fëmijët nga dëmi i shejtanëve, për shkak se numri i tyre është i madh në këtë kohë.

Ibën Haxheri thotë se Ibën Xhevzi ka thënë: arsyeja e frikës për fëmijët në këtë kohë është se me ndyrësinë, të cilën kanë shejtanët është e pranishme në pjesën më të madhe të kësaj kohe,



ndërsa dhikrin që të mbron prej shejtanëve shumica e fëmijëve nuk e dinë. Pastaj shejtanët që kanë mundësi t'i dëmtojnë ata, i dëmtojnë fëmijët, e kjo është arsye për t'u brengosur dhe për t'u kujdesur për fëmijët në këtë kohë. E urtësia kësaj pune këtu qëndron sepse shejtanët shpërndahen gjatë kësaj kohe dhe se lëvizja e tyre gjatë natës është më e lehtë se sa gjatë ditës, sepse errësira u ofron forcë më të madhe njësoj si çdo send i zi, ashtu siç ka ardhur në hadithin e Ebu Dherrit, kur është pyetur: **“Çfarë ta prish namazin? Ai iu është përgjigjur (Pejgamberi): Qeni i zi, është shejtan.”** Muslimi.

Me këtë hadith i Dërguari i Allahut i porositi prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve për një përkujdesje të veçantë dhe t'i largojnë fëmijët nga gjërat që e dëmtojnë shëndetin e tyre trupor dhe shpirtëror.

Sinjalin e parë që jep ky hadith është strategjia e gjerë e një edukatori të mirëfilltë. Kur të bisedosh me edukatorët për përkujdesjen e duhur ndaj fëmijëve e vëren se një numër i madh i tyre i japin

rëndësi mësimeve fetare si namazin, nënshtrimin ndaj Allahut dhe të Dërguarit të tij, si dhe moralin e lartë që duhet të ketë një fëmijë duke i neglizhuar gjërat e jetës së përditshme. Por gjithashtu është një numër i madh kujdestarësh që kufizohen vetëm me shëndetin e fëmijëve të tyre, shkollimin dhe gjërat e tjera të kësaj bote, duke u shkujdesur për mësimet fetare.

Feja Islame sillet me njeriun në atë formë, duke e llogaritur atë si qenie të përsosur trup – mendje – shpirt, siç është e ditur se feja nuk është dytësore dhe e kufizuar, por ajo është e lidhur ngushtë me të gjitha specifikat e njeriut. Çdo vegël ose aparat, i cili kryen një funksion nuk ka mundësi ta kryejë një punë përveçse me ndihmën e pjesëve përbërëse të saj. Sado vlerë të ketë ndonjë prej pjesëve të saj nuk mundet që e vetme të kryejë funksionin pa ndihmën e pjesëve të tjera.

Çështja nuk mbaron me kaq, tani vijmë te një rregull i rëndësishëm në funksionimin e kësaj vegle, konkretisht mënyra e përdorimit dhe e lidhjes mes

këtyre pjesëve. Njësoj është edhe çështja e njeriut, ai nuk duhet të angazhohet vetëm me anën shpirtërore, duke e lënë anash atë trupore apo të kundërtën, por duhet t'i bashkojë të dyja, si dhe nuk është puna dhe sjelljet e tij produkt i të gjitha pikëpamjeve të personalitetit të tij, por bashkëveprimi i njërës me tjetrën. Prandaj edukatorët që angazhohen me ndërtimin e personalitetit të njeriut dhe përgatitjen e tij duhet ta kenë parasysh këtë fakt, se nuk duhet të merren vetëm me një aspekt duke anashkaluar tërësinë e personit. Nëse njeriu e kupton fenë dhe i mëson mënyrat e praktikimit të saj gjatë jetës së tij nuk do të thotë se kjo e ndan nga krijimi mendor dhe mënyra e të menduarit e as nga stabiliteti, si dhe as nga shëndeti mendor. Sa prej njerëzve e kuptojnë këtë fe gabimisht, duke i vendosur dhe duke i kuptuar gabimisht argumentet dhe duke i komentuar gabimisht faktet, e kjo e metë është në ndërtimin e personalitetit të atij personi. Sa burra dështojnë në detyrimet ndaj grave të tyre, në administrimin e jetës familjare e si rezultat i kësaj është gjendja shpirtërore në të cilën jetojnë.

Ne duhet t'i përgatisim fëmijët dhe nxënësit tanë me dy gjëra të rëndësishme, që nuk kundërshtohen njëra me tjetrën e as nuk ndahen.

E para- Adhurimin ndaj Allahut të vetëm, si dhe shpëtimin në botën tjetër.

E dyta- Arritjen e suksesit në këtë botë dhe duke e bërë jetën tonë këtu më të lumtur.

Këto dy gjëra të rëndësishme të kompletuara nuk kundërshtohen njëra me tjetrën, ashtu siç thotë Allahu në librin e tij fisnik: ***“Dhe me atë që të ka dhënë Allahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos lër mangët atë që të takon nga kjo botë, dhe bëj mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty, e mos bëj të këqija në tokë, se Allahu nuk i do***

“... Vizita farefisnore, respektimi ndaj prindërve ndikon në vazhdimin e të menduarit dhe të vepruarit pozitivisht ndaj të tjerëve...”

çrregulluesit.” Kasas, 77.

Na ka treguar i Dërguari i Allahut se kërkimi i furnizimit të njeriut është adhurim dhe shpërblehet për atë, si dhe shpenzimi ndaj familjes llogaritet si shpenzim në rrugë të Allahut. Në lidhje me këtë i Dërguari i Allahut thotë: ***“Vërtet muslimani kur shpenzon për familjen e tij i llogaritet sadaka.”*** Muslimi

Në anën tjetër vendosmëria e njeriut ndikon në qetësimin e jetës shpirtërore dhe në jetën shoqërore. Vizita farefisnore, respektimi ndaj prindërve ndikon në vazhdimin e të menduarit dhe të vepruarit pozitivisht ndaj të tjerëve. Sjellja e gruas sipas mësimave fetare duke respektuar bashkëshortin e saj ndikon pozitivisht në menaxhimin e problemeve dhe në raport me sfidat që shfaqen në familje.

Ajo që u përmend më lart e vërteton rëndësinë dhe rolin e edukatorëve në formimin e plotë të personalitetit të njeriut, dhe kjo strategji në kontekstin e edukatës do të lerë gjurmë në synimet e edukatorëve, që të kenë një qasje më të gjerë dhe gjithëpërfshirëse, që të lë gjurmë në përmbajtjen dhe metodologjinë edukative, dhe në metodat e këshillimit, mësimin, formimit dhe në personalitetin e edukatorit dhe profesionalizmin e tij. ■

Përshtati nga arabishtja:
Bashkim BAJRAMI

BËJE NJË NJERI!

Një fjalë e urtë kineze thotë: “Nëse dëshiron të mbledhësh bereqet për një vit mbill grurë, për dhjetë vite mbill pemë, ndërsa për njëqind vite atëherë mbill njeri”.

ADIL IBËN SAD EL HAUFİ

Fëmijët tanë janë kapital i çmuar themelor, rrugë për fitim të bollshëm dhe me lejen e Allahut garanci nga varfëria. Fëmijët gjithashtu janë burim i mëvonshëm i sevapeve edhe pas vdekjes sonë: *“Kur vdes biri i Ademit i ndërpriten veprat e tij, me përjashtim të tre vetëve: kush ka dhënë lëmoshë rrjedhëse, ai që ka lënë dituri të dobishme dhe kush ka lënë fëmijë të hairit dhe lutet për prindërit.”* (Muslimi), si dhe fjalët e të Dërguarit *sal-lallahu alejhi ue selem*: *“Vërtet njeriu ngrihet në shkallë të lartë në xhenet dhe do të thotë: nga më vjen kjo pozitë? Atij i thuhet: në bazë të istigfarit të fëmijës tënd për ty.”* (Imam Ahmedi, Albani thotë: hadithi është autentik).

Dhe nesër do t'i shohim se si, me ndihmën e Allahut i marrin në duart e veta gjërat të rëndësishme jetësore për ndërtimin e vendit, të shërbimit të umetit dhe të fesë. Ne duhet ta investojmë mundin, pasurinë dhe fuqinë mendore tek fëmijët tanë, të ndajmë kohë për edukimin e tyre, t'i dërgojmë ta mësojnë Kuranin, t'ua mësojmë rregullat elementare të Islamit, si dhe disa gjëra tjera të vlefshme për jetën e kësaj bote. T'i nxisim ta lexojnë drejt Kuranin, të memorizojnë hadithe profetike dhe poezi të profetëve të zgjedhur. Të formojmë tek ata një personalitet të dalluar, të zhvillojmë tek ata aftësi për gjëra të dobishme, si dhe t'i ndihmojmë t'i skicojnë synimet dhe

qëllimet frytdhënëse në jetën e tyre, e nëse ne s'kemi mundësi, t'ua zgjedhim edukatorin. Të theksojmë tek ata qëndrueshmërinë në besimin e shëndoshë Islam, të interesohemi për lëndët që mëson fëmija, të kujdesemi për nevojat e tyre dhe të punojmë me ata me mirësjellje dhe butësi.

Nevoja e umetit për burra të dalluar qartësohet përmes aspiratës së Omer Farukut kalifi i dytë, i cili në një rast ka thënë: *“Dëshiroj një shtëpi plot me burra, siç janë Ebu Ubejde ibën Xherahu, Muadh ibën Xhebeli dhe Selimi, shërbëtori i Ebu Hudhejfes, që t'i shfrytëzoj ata në rrugë të Allahut”*. (“Sifetu safve” i Ibën Xheuzijes, fq. 155)

Studimet shkencore thonë se 70% të sjelljeve të veta njeriu fillon t'i kristalizojë në pesë vitet e para të jetës. Këtë e vërteton edhe Imam Gazaliu, i cili ka thënë: *“Fëmija është amanet në duart e babait, zemra e tij është e pastër si margaritari, e dëlirë, e pastër nga çdo vijë dhe laramani. Fëmija pranon gjithë çka i drejtohet atij, dhe kështu nëse mësohet dhe stimulohet për të mirë, atëherë ai do të jetojë në këtë ambient, dhe prindërit bëhen pjesëmarrës në shpërblimet e tij. Mirëpo nëse mësohet dhe udhëzohet për të keqen, të dëmshmen dhe shkatërruesen, atëherë mëkati do të bjeri në qafën e edukatorit dhe kujdestarit të tij”*. (Fejdul kadir, 3/522)

Fëmija edukohet në fazat e hershme të jetës së tij, kurse ndikimi më i madh i kësaj edukate vjen në shprehje në vitet e



“Nëse nuk sillemi mirë me këta margaritarë të çmuar, ne vetë me duart tona do t’i varrosim këta fëmijë të mrekullueshëm, të dalluar dhe mendjemprehtë...”

zhvillohet ky kreativitet dhe pastaj të ruhet, punohet në shkatërrimin dhe zhdukjen e mësimëve.

Shejh Ibën Sadiu për ajetin kuranor: **“Allahu ju urdhëron për fëmijët tuaj.”** (Nisa 11), ka thënë: “O ju prindër! Fëmijët tuaj janë amanet tek ju dhe Allahu ju urdhëron që t’u mësoni më të dobishmen në fenë dhe dunjanë e tyre, t’i arsimoni dhe t’i edukoni, t’i aftësoni që të mbrohen nga gjërat shkatërruese, t’i urdhëroni me nënshtrim e dëgjueshmëri ndaj Allahut, të mbahen fort pas devotshmërisë në vazhdimësi”.

Gjithashtu me rëndësi është që të dimë, se nuk është e domosdoshme që rezultatet e edukimit të fëmijëve t’i shohim para syve tanë menjëherë, në çfarëdo faze të jetës së tyre. Edukimi i fëmijëve i përngjan drurit të bambusë, i cili vazhdon të rritet për 4 vite pas mbjelljes së farës. Gjatë kësaj kohe duket vetëm bula e vogël nga koka e farës, e cila me fijet e forta të rrënjës e shpon tokën dhe del jashtë. Në vitin e pestë lartësia e drurit arrin në 25 metra!

Kështu edhe ne nuk i shohim menjëherë rezultatet e munit tonë gjatë edukimit të fëmijëve tanë. Mirëpo një ditë prej ditësh, me fuqinë e Allahut, do ta korrim bereqetin e të mbjellave tona. Pra, mos ta ngutim frytin dhe mos të presim si të mpirë gjatë tërë rrugës së edukimit. ■

Nga arabishtja: Zeki ÇERKEZI

mëvonshme. Siç thotë edhe Imam Gazaliu fëmija në mënyrë të zhdërvjellët i pranon udhëzimet dhe atë që sheh nga sjelljet e prindërve dhe të edukatorëve (mësuesve). Në këtë fazë fëmija e pranon atë çka i jepet, dhe ky fidan në të ardhmen do të jetë shumë frytdhënës, do të jetë i fuqishëm dhe do të piqet. Ibën Kajimi ka thënë: Korrigjimi më i drejtë bëhet që në fëmijëri e nëse lihet që fëmija të edukohet dhe adaptohet vetë me këtë joedukatë, pastaj drejtimi i tij bëhet i vështirë”.

Në të kundërtën, nëse nuk sillemi mirë me këta margaritarë të çmuar, ne vetë me duart tona do t’i varrosim këta fëmijë të mrekullueshëm, të dalluar dhe mendjemprehtë, e kuptuam këtë apo nuk e kuptuam. **Hulumtimet shkencore tregojnë se përqindja e talenteve të aftë deri në moshën 5 vjeç arrin në 90 %, që të bie në 10 % në moshën prej 5 deri në 7 vjeç, kurse në moshën 8 vjeç është vetëm 2 %.** Gishti akuzues i drejtohet mënyrës së sjelljes tonë me fëmijët, ose në rrugën e edukimit, ose në metodologjinë e arsimimit, e bile, bile në drejtim të sociologëve. Dhe në vend që të



“SHPËTOJENI VETEN DHE FAMILJEN TUAJ”

Allahu thotë: *“O ju që keni besuar! Shpëtojeni veten dhe familjen tuaj nga Zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëj të rreptë e të ashpër, që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë dhe bëjnë atë me të cilën urdhërohen.”*

SHKRUAN: GENC PLUMBI

Në Tefsirin e Ibën Ebu Hatimit shënohet: “Na përcillet nga Abdulaziz ibën Ebu Davudi se ka thënë: “Më është komunikuar se i Dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* ka lexuar këtë ajet *“O ju që keni besuar! Shpëtojeni veten dhe familjen tuaj nga Zjarri, lënda djegëse*

e të cilit janë njerëzit dhe gurët”, ai ia lexoi shokëve të tij e në mesin e tyre ishte një i moshuar që tha: “O i Dërguari i Allahut! A janë gurët e Xhehenemit si gurët e dynjasë?!” Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem* tha: “Pasha Atë që ka shpirtin tim në dorën e Tij. Një shkëmb prej shkëmbinjve të xhehenemit është më i madh se malet e dynjasë.” Burrit i ra të fikët dhe i Dërguari i Allahut *sal-lallahu*

alejhi ue selem vuri dorën mbi gjoksin e tij. Ai ishte gjallë dhe i Dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* e thirri dhe i tha: **“Thuaj la ilahe il-lallah”**. Burri e tha dhe i Dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* e përgëzoi me Xhenet.”

Ibën Batali shprehet në komentin e tij për Sahihul Buhari: “Çdo besimtar duhet t’i mësojë fëmijëve të tij besimin e pastër që në vogëli dhe t’i mësojë detyrimet që u takojnë. Ai nuk duhet t’u mësojë atyre kundërshtitë e mohuesve dhe as dyshimet që hedhin ata që anojnë nga e shtrembra në zemrat e tyre, sepse diskutimet në të tilla gjëra ka mundësi t’u trashëgojnë atyre dyshime.”

Ibën Batali vazhdon: “Na përcillet nga Ibën Eslemi, se kur zbriti ajeti **“O ju që keni besuar! Shpëtojeni veten dhe familjen tuaj nga Zjarri”** njerëzit thanë: “O i Dërguari i Allahut, ne e ruajmë veten tonë, por si mund të ruajmë familjen tonë?” Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem* tha: **“Duke i urdhëruar që t’i binden Allahut dhe t’i ndaloni ata nga gjynahet e tyre ndaj Allahut.”**

Muhamed Minaviu thotë në “Fejd el-Kadir”: “Sjellja më e mirë që mund t’i mësohet fëmijëve është sjellja me Allahun kur janë në vetmi, siç është turpi dhe mbështetja tek Ai. Ndërsa ndër sjelljet e shfaqura mund t’i mësojë ruajtjen e kufijve dhe të drejtave të njerëzve, edukimi me sjelljet e Islamit dhe të Profetit *sal-lallahu alejhi ue selem* në zbatimin e Suneteve të mëdha apo të vogla qofshin, shoqërinë me Kuranin dhe bindjen ndaj tij gjithë respekt. Pastaj të vazhdojë me dijet fetare, që janë kulmi i sjelljes dhe më tej sjelljen me njerëzit, butësinë, dashurinë dhe durimin ndaj tyre.”

Taberiu në Tefsirin e tij shprehet: “O ju që keni besuar tek Allahu dhe i Dërguari i

Tij **“Shpëtojeni veten”**, pra, mësojani njëri-tjetrit ato dije, të cilat i shpëtojnë të afërmit tuaj - që i mësoni - nga Zjarri, të cilin ata mund ta largojnë, nëse veprojnë duke iu bindur Allahut. Pra, punoni në adhurimin e Allahut.”

Më tej, Allahu xhele shanuhu thotë: **“familjen tuaj nga Zjarri”** që do të thotë: mësojini familjes tuaj adhurimin e Allahut nëpërmjet të cilit ata do të mund të shpëtojnë veten e tyre nga zjarri i xhehenemit. Ali ibën Ebu Talibi rreth ajetit: **“Shpëtojeni veten dhe familjen tuaj nga Zjarri”** ka thënë: “Edukojeni familjen tuaj dhe mësojeni atë.”

Ibën Abasi, rreth ajetit: **“Shpëtojeni veten dhe familjen tuaj nga Zjarri”** ka thënë: “Punoni në adhurimin e Allahut, ruhuni nga gjynahet ndaj Allahut, urdhërojeni familjen tuaj që të përkujtojë Allahun, që Allahu t’ju shpëtojë nga Zjarri.” Ndërsa dijetari me emrin Muxhahid ka thënë: “Frikësojuni Allahut dhe këshillojeni familjen tuaj që të ketë frikë Allahun.” Një dijetar tjetër me emrin Kudate, ka thënë: “Njeriu mund ta mbrojë familjen e tij duke i urdhëruar ata që t’i binden Allahut, duke i ndaluar që të bëjnë gjynahe, duke i nxitur të zbatojnë urdhëresat e Allahut, duke i urdhëruar dhe ndihmuar ata për këtë. E kur të shohë se dikush prej tyre e kundërshton Allahun, e zmraps dhe e kritikon.”

Në *Tefsirin El Mujeser* thuhet: “O ju, që i keni besuar Allahut dhe të dërguarit të Tij! Ruheni veten tuaj duke iu bindur asaj që Allahu ka urdhëruar dhe duke braktisur atë që Ai ua ka ndaluar. Ruheni familjen tuaj prej asaj që ruani vetveten nga Zjarri, lënda djegëse e të cilit janë gurët dhe njerëzit, për dënimin e të cilëve janë ngarkuar engjëjt të fortë e të ashpër në sjellje, të cilët nuk e kundërshtojnë Allahun në atë që Ai i urdhëron dhe

zbatojnë udhëzimet e urdhëruara.” Ibën Sadiu thotë: “O ju, që Allahu ju ka falur mirësinë e besimit! Plotësojini detyrimet dhe kushtet që rrjedhin prej tij.

Fjala *“Shpëtojeni veten dhe familjen tuaj nga Zjarri”*; të ruash vetveten do të thotë ta detyrosh atë që të plotësojë urdhrin e Allahut dhe t’i largohet asaj që Ai ka ndaluar, të pendohet për të gjitha veprat që e zemërojnë Allahun dhe kanë si pasojë ndëshkimin e Tij. Ndërsa ruajtja e familjes, pra e fëmijëve, bëhet duke i edukuar dhe duke i mësuar, duke i detyruar të respektojnë urdhrin e Allahut. Në të kundërt, robi nuk mund të shpëtojë ndryshe, vetëm nëse zbaton për veten e tij atë që Allahu urdhëron. Nën kujdestarinë e robit përfshihen gratë, fëmijët dhe familjarët e tjerë, që janë në kujdesin e tij.

Allahu xhele shanuhu e ka përshkruar Zjarrin me të tilla cilësi, në mënyrë që t’i ndërgjegjësojë robërit ndaj rrezikut që u kanoset nëse e neglizhojnë dhe nuk e marrin parasysh atë. Ai xhele shanuhu thotë: *“lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët”*, ashtu siç thotë në një ajet tjetër: *“Ju (o banorë të Mekës) dhe ata që i adhuron përveç Allahut do të jeni lëndë djegëse e xhehenemit, në brendi të të cilit do të hidheni.”* (Enbija 98.)

Fjala e Allahut xhele shanuhu: *“Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëjt të rreptë e të ashpër”* do të thotë: Ata kanë sjellje të ashpër, qortim të fortë, të frikësojnë me zërat dhe pamjet e tyre dhe i poshtërojnë banorët e Zjarrit me forcën e tyre. Ata zbatojnë urdhrat e Allahut, që ka vendosur për banorët e Zjarrit të ndëshkohen dhe të dënohen rëndë: *“nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë dhe bëjnë atë me të cilën urdhërohen.”* Gjithashtu në këtë ajet lavdërohen engjëjt bujarë për bindjen e tyre të plotë ndaj urdhëresave të Allahut xhele shanuhu.

“Njeriu mund ta mbrojë familjen e tij duke i urdhëruar ata që t’i binden Allahut, duke i ndaluar që të bëjnë gjynahe...”

Në tefsirin e tij Sheukani thotë: “Mukatil ibën Sulejmani thotë: “Shpëtojeni familjen tuaj nga Zjarri i botës tjetër duke u mësuar sjelljet e mira.” Ibën Xheriri thotë: “Ne e kemi për detyrë që t’u mësojmë fëmijëve tanë fenë dhe mirësinë, duke mos lënë pas dore mësimin e sjelljes së mirë. Për këtë flet edhe fjala e Allahut xhele shanuhu: *“Urdhëroje familjen tënde të falë namaz, e edhe ti vetë zbatoje atë...”* (Taha 136) dhe *“Dhe tërhiqja vërejtjen farefisit tënd më të afërt.”* (Shuara; 214).”

Më tej Ibën Xheriri vazhdon: *“Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëjt të rreptë”* do të thotë se Zjarri ka mbikëqyrësit e vet, të cilët marrin përsipër ndëshkimin e banorëve të tij, të rreptë dhe të ashpër me ta, pa i mëshiruar, nëse ua kërkojnë diçka të tillë, sepse Allahu xhele shanuhu i ka krijuar nga zemërimi i Tij. Disa komentues janë shprehur: “Ata janë të rreptë në zemra dhe të fuqishëm në trupa” dhe disa të tjerë janë shprehur: “Ata janë të rreptë në fjalë dhe të ashpër në vepra.” Ndërsa fjala e Allahut xhele shanuhu *“bëjnë atë me të cilën urdhërohen”* do të thotë: i zbatojnë urdhrat e Tij në kohën e vet; as nuk i vonojnë, as nuk e përshpejtojnë zbatimin e tyre.”

Ibën Ashuri shprehet në Tefsirin e tij: “Kthimi i njerëzve dhe i gurëve në lëndë zjarri tregon se zjarri i Xhehenemit do të jetë i ndezur përpara se njerëzit të hidhen në të dhe se ata (njerëzit dhe gurët) do të

ndizen prej tij, sepse zjarri i Xhehenemit është burimi i të gjithë nxehtësisë. Në librin Muveta është shënuar hadithi i Profetit *sal-lallahu alejhi ue selem*: “*Zhegu është prej shfryrjes së Xhehenemit.*” Kjo do të thotë, se nëse biri i Ademit bie në kontakt me të, lëkura e tij do të digjet, ndërsa guri do të skuqet.”

Ibën Xheuzi shprehet në Tefsirin e tij: “Ebu Salihu përcjell nga Ibën Abasi, se ka thënë: “Mbikëqyrësit e Zjarrit janë nëntëmbëdhjetë. Midis dy shpatullave të tyre është sa rrugëtimi për një vit. Forca e njëri prej tyre është aq e madhe sa kur godet me kopan merr me vete 70 mijë njerëz drejt e në brendësi të xhehenemit.”

Nisaburi thotë: “Në fjalën e Tij xhele shanuhu: **“Shpëtojeni veten dhe familjen tuaj”** është një urdhër për të ruajtur vetveten. Në hadith thuhet: *“Allahu e mëshiroftë atë njeri që thotë: “O familja ime! Bëni kujdes me namazin tuaj, me agjërimin, me zekatin, me të vobektin, me jetimin dhe me fqinjin tuaj”, me shpresën se Allahu do t’i bashkojë ata me të në xhenet.”*

Maverdiu thotë: “Rreth ajetit **“O ju, që keni besuar! Shpëtojeni veten dhe familjen tuaj nga Zjarri”** Ibën Mesudi thotë: “Nëse Allahu thotë **“o ju, që keni besuar”** dëgjoje me kujdes, sepse ose bëhet fjalë për një të mirë me të cilën urdhëroresh, ose bëhet fjalë për një të keqe për të cilën të tërhiqet vëmendja.”

Ajeti **“shpëtojeni veten”** mund të marrë tri kuptime:

1- Familja juaj le të ruajë vetveten nga Zjarri. Këtë e thotë Dahaku.

2- Urdhërojeni familjen tuaj që të përkujtojë Allahun dhe të lutet dhe Allahu t’ju ruajë juve me ta. Këtë e përcjell Ebu Talha nga Ibën Abasi.

3- Shpëtojeni veten me veprat tuaja dhe shpëtojeni familjen me këshillat tuaja.

Këtë e thotë Kudate dhe Muxhahidi.

Rreth këshillës që i shpëton ata nga Zjarri ka tri mendime:

1- T’i urdhërojë ata që t’i binden Allahut dhe t’i ndalojë nga gjynahet. Këtë e thotë Kudate.

2- Ua mëson detyrimet dhe i edukon për jetën e tyre në dynja.

3- Ua mëson mirësinë dhe i urdhëron me të, si dhe ua mëson të keqen dhe i ndalon nga ajo.

Mukatili thotë: “Kjo është detyra e tij karshi vetes, fëmijëve, robërve dhe robërreshave të tij.”

Rreth fjalës së Allahut xhele shanuhu: **“lënda djegëse e të cilët janë njerëzit dhe gurët”** ka tri mendime në lidhje me gurët dhe njerëzit:

1- Ata janë gurët që kanë adhuruar derisa të dëshmojnë se çfarë i solli fundi i tyre në Zjarr. Allahu xhele shanuhu e ka sqaruar këtë me fjalën e Tij: **“Ju dhe ajo që adhuruat juve përveç Allahut do të jeni lëndë e Xhehenemit.”** (Enbija; 98.)

2- Ata janë gurë prej qibriti, forca djegëse e të cilëve shtohet bashkë me Zjarrin. Përmendja e tyre tregon për shtimin e kërcënimit dhe të dënimit. Këtë e thotë Ibën Mesudi dhe Muxhahidi.

3- Allahu xhele shanuhu i ka përmendur gurët për të treguar se zjarri që djeg gurët arrin t’i djegë njerëzit më shumë.

Lusim Allahun xhele shanuhu që të na ruajë neve dhe familjet tona nga Zjarri i nxehtë i Xhehenemit me mëshirën dhe bujarinë e Tij të pafund. ■

Amin

O DJALOSH, RUAJE ALLAHUN...



Abdullah ibën Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: "Isha i hipur në një kafshë pas Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i cili më tha: "O djalosh, do t'i mësoj ca fjalë (do t'i jap ca këshilla): Ruaje Allahun, Allahu të ruan ty, ruaje Allahun do ta kesh në anën tënde, nëse kërkon gjë atëherë kërkoje atë prej Allahut, mos harro, se sikur i tërë njerëzimi të bashkohen për të sjellë ndonjë dobi që Allahu nuk e ka caktuar për ty, atëherë nuk do të kenë mundësi ta bëjnë atë të mirë, dhe në të kundërtën nëse mblidhen për të bërë ndonjë të keqe asgjë nuk mund të bëjnë përveç asaj që Allahu e ka caktuar. Janë ngritur lapsat dhe janë tharë letrat (në të cilat është shkruar caktimi-kaderi)."

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Në një transmetim tjetër përmendet: "Ruaje Allahun do ta kesh para vetes, njiu tek Allahu (me adhurim) në lehtësi do të njohë Ai në vështirësi. Dije se çdo gjë (mirësi, fatkeqësi...) që të është shmangur nuk ka mundur assesi të të godasë, dhe e kundërta çdo gjë që të ka goditur nuk ka pasur mundësi t'i shmangesh. Dije se ndihma vjen pas sabrit, fitorja vjen pas sprovës dhe pas çdo vështirësie vjen lehtësimi."

Zinxhiri i hadithit:

Transmetimin e parë e shënon imam Tirmidhiu në Sunenin e tij, i cili njihet ndryshe edhe me emrin "El Muxhteba",

hadithi nr. 2516. Ai transmetohet me sened të saktë, të gjithë transmetuesit, përveç dy prej tyre, janë transmetues nga të cilët shkruajnë Buhariu dhe Muslimi në librat e saktë të tyre. Transmetuesi i parë, prej dy të veçuarve më lart, është Kajs ibën Haxhaxhi nga i cili transmetojnë shumë nxënës të tij dhe të cilin e konsideron besnik në transmetim Ibën Hibani në librin e tij "Eth Thikat", ndërsa Ebu Hatimi për të thotë: "Transmetues i mirë" hadithet e të cilit i saktëson edhe vetë Tirmidhiu. Kurse transmetuesi i dytë është Hanesht Sanani, transmetues nga i cili ka shënuar hadithe vetëm Muslimi, kurse Buhariu jo. Sido që të jetë, transmetimi i parë është i saktë, të cilin e saktëson (bazuar në këtë zinxhir) vetë imam Tirmidhiu, shejh

Albani etj. Kurse transmetimin e dytë e shënon imam Ahmedi, 1/293, Ebu Jala, nr. 2556 etj., transmetime këto zinxhiri i të cilëve është më i dobët, se i të parit, por duke u bazuar në transmetimet dhe rrugët e shumta të këtij teksti më e pakta që mund të gjykohej rreth këtij hadithi do të ishte ta quanim **“hadith të mirë”** (hasen). Është për t’u përmendur fakti se imam Ahmedi në transmetimin e tij i ka bashkuar të dy këto transmetime në një hadith të vetëm duke mos e ndarë atë, siç vepruam ne në ndarjen e tij.

Rëndësia e hadithit.

Hadithi i lartpërmendur është prej më madhështorëve në temën e tij. Ai në vetvete përmend udhëzime bazë, të cilat nuk kanë të zëvendësuar në kapitujt e tyre. Hadithi është i ndarë në këshilla, të cilat nëse do të ndaleshim dhe t’i shpjegojmë secilën veç e veç do të duhej të shkruheshin fletë të tëra. Kjo edhe për faktin se këshilla të tilla janë formula dhe çelësa për kapitujt rreth të cilëve ato flasin. Ky është një hadith, të cilin çdo prind duhet ta mësojë së pari vetë e pastaj edhe fëmijëve të vet. Kjo për arsye se rregullat e përmendura në të janë pjesë e besimit pa të cilat ai do të ishte i mangët.

Disa nga dijetarët thonë: “Meditova rreth këtij hadithi kuptimi i të cilit më bëri aq shumë përshtypje, sa për pak e humba vetëdijen. Mjerë për ata që nuk kanë njohuri rreth këtij hadithi”

Komentimi i hadithit.

Nëse do të ndaleshim për t’ia dhënë hakun këtij udhëzimi dhe këshille profetike pa dyshim do të na duhej shumë kohë dhe hapësirë, gjëra të cilat nuk i kemi në dispozicion, as njërën e as tjetrën. Sa për t’u argumentuar për atë që thashë dua të përmend faktin se Ibën Rexhebi, Allahu e mëshiroftë, këtë hadith e komentoi në një vëllim të plotë të përbërë prej disa qindra

faqesh. (Ky vëllim titullohet: *“Nurul iktibas fi mishkat uesijetin-nebiji libni Abas”*, libër i cili u botua për herë të parë në vitin 1347 h. në Mekë, ndërsa po përgatitet botimi i tij edhe në gjuhën shqipe). Në këtë rast do t’i veçoja me përgjigje dy pyetje, e para: çfarë do të thotë shkurtimisht çdo këshillë e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, pra, cili është kuptimi i drejtë i secilës prej tyre dhe pyetja e dytë: cila ishte strategjia profetike që zgjodhi një djalosh të moshës së re për ta këshilluar me fjalë të tilla madhështore, pse ato nuk ia tha dikujt më të moshuar, cila ishte prapavija e zgjedhjes së këtyre fjalëve dhe kësaj moshe dhe çfarë i lidh ato të dyja ndërmjet tyre.

“O djalosh, do t’i mësoj ca fjalë (do t’i jap ca këshilla)”

Kjo mënyrë se si e fillon këshillën në psikologji njihet si ndër më të efektshmet për të zgjuar interesimin e dëgjuesit për fjalët që vijnë në vazhdim, gjë të cilën çdo mësues apo pedagog duhet ta përdorë me nxënësit e vet. Pra, Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dëshironte të zgjonte interesimin maksimal tek Ibën Abasi, *radjallahu anhu*, që këshillat t’i mbante mend sa më mirë, sepse do të vinte dita që ai t’ua mësonte të tjerëve. Sipas historisë ashtu ndodhi, pra, Ibën Abasi i mbajti mend mirë ato fjalë, i transmetoi ato pa i harruar dhe ajo që është për t’u habitur është se i vetmi sahabi, i cili transmeton këtë hadith ishte Ibën Abasi. Kjo gjë na jep të kuptojmë se interesimin që donte të ngjallte Profeti te ky djalë nuk ishte pa qëllim.

“Ruaje Allahun Allahu të ruan ty, ruaje Allahun do ta kesh në anën tënde” (Ruaje Allahun do ta kesh para vete)

Allahu nuk ka nevojë që dikush ta ruajë, kjo për arsye se Ai nuk ka frikë nga askush dhe nuk ka nevojë për askënd, është i Gjithëfuqishëm dhe Zot i çdo sendi. Për të ka nevojë çdokush e Ai s’ka nevojë për askënd. Pra, me fjalën *“Ruaje Allahun”* këtu është si qëllim ruaji kufijtë e caktuar nga Allahu,

kryeji urdhëresat e Tij dhe largohu nga ndalesat e Tij. Nëse vepron kështu, atëherë si rezultat i saj është që Ai të të ruajë ty nga çdo e keqe. Pra, ruajtja jote e Allahut nuk i kthehet askujt tjetër me dobi përveçse vetes tënde. Njeriu nuk e ruan Allahun, pra Qenien e Tij, nuk e ruan gjithësinë e Tij, planetët, yjet, diellin e as hënën, por vetëm dy gjëra që në krahasim me ato të parat janë shumë kërkesa të vogla, pra, kërkohet prej njeriut t'i kryejë farzet dhe të largohet nga haramet, e nga mirësia e madhe e Zotit, Ai si shpërblim e ruan njeriun në këtë botë dhe në botën tjetër, ia ruan trupin dhe shpirtin e tij. Nga njeriu kërkohet shumë pak kurse kundrejt saj i jepet si shpërblim shumë më tepër, e kjo është mirësia e Zotit, që ia jep atyre që do nga robërit e vet.

Jo vetëm që e ruan besimtarin, por edhe kalon në anën e tij apo para tij. Pra, kur besimtari është në telashe Allahu do të jetë në anën e tij dhe do ta ndihmojë atë, por edhe nëse është në mëdyshje për ndonjë problem dhe nuk di nga t'ia mbajë, atëherë Allahu do ta udhëzojë tek më e mira dhe më e drejta.

“nëse kërkon gjë atëherë kërkoje atë prej Allahut”

Kjo porosi është përmendur edhe në ajetin e Allahut, të cilin e lexojmë shumë herë në ditë në pesë kohët e namazit, pra, është këshillë e nxjerrë nga ajeti i katërt i sures Fatiha: *“Ij-jake nabudu ue ij-jake nestein”*, që do të thotë: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”**

Kërkimi i gjërave ndahet në dy lloje: gjëra për të cilat mund të ndihmojë vetëm Allahu dhe të tjera në të cilat mund të ndihmojnë edhe krijesat. Në këtë hadith futet lloji i parë i këtyre kërkesave, prej tyre do të veçonim: udhëzimin, faljen e gabimeve, forcimin në adhurim, faljen e xhenetit, ruajtjen nga zjarri etj.; pra, shumica e tyre kanë të bëjnë me çështje të fesë. Kurse lloji i dytë është: ndihma mjekësore, ndihma me të holla për të

ndërtuar shtëpi, dërgimi i shokut me makinë nga një qytet tek tjetri etj., në këtë porosi profetike futet lloji i parë, sepse gjëra të tilla kërkohen vetëm nga Allahu Fuqiplotë, që është i Vetmi që e ka mundësinë për të realizuar gjëra të tilla. Me këtë këshillë Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, donte të krijojë tek Ibën Abasi besimin e patundur, se për çdo fatkeqësi duhet të kthehesh tek Allahu dhe vetëm Atij duhet t'i lutemi. Zakonisht njerëzit, të cilët kanë bindje të tilla mundësia për të devijuar tek ata është shumë e vogël, sepse ata për çdo gjë i kthehen Zotit dhe vetëm Atë e konsiderojnë Qetësues të brengave të tyre.

“Mos harro se sikur i tërë njerëzimi të bashkohen për të sjellë ndonjë dobi, të cilën Allahu nuk e ka caktuar për ty, atëherë nuk do të kenë mundësi ta bëjnë atë të mirë, dhe në të kundërtën, nëse mbledhen për të bërë ndonjë të keqe asgjë nuk mund të bëjnë përveç asaj, të cilën Allahu e ka caktuar”

Përmes kësaj këshille Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dëshironte që tek Ibën Abasi të mbjellë besimin në caktimin (kaderin) e Allahut. Pra, çdo e mirë dhe e keqe është e caktuar nga Allahu, por duhet pasur kujdes, që në çështjet e adhurimit të mos krijohet një bindje e tillë e kështu njeriu duke menduar se nëse është shkruar tek Zoti të jetë prej adhuresve, atëherë do të jetë i tillë dhe e kundërta. Një bindje e tillë assesi nuk duhet të krijohet tek njeriu dhe kështu t'i lërë ibadetet, përkundrazi duhet të punojë sa më shumë punë të mira, duke mos pritur kaderin se çfarë do të bëjë me të. Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, na mëson që të vrapojmë tek punët e mira, sepse gjithkujt do t'i lehtësohet puna ashtu si është shkruar për të, pra, do të lehtësohen punët ashtu si do t'i drejtosh ti vetë. Punët ndahen në dy grupe: punë në të cilat njeriu nuk ka zgjedhje dhe të tjera në të cilat ka zgjedhje. Për të parat ai nuk jep llogari, sepse ndodhin me dëshirën e Zotit

“Se mësimet tilla duhet t’i jepen njerëzve në rininë e tyre, ku përmes kësaj mësimesh këta të rinj do të burrërohen dhe do të kaliten për të ardhmen, e cila është në duart e tyre...”

duke mos pasur asnjë mundësi që njeriu të ndërhyjë në to, ku për këtë shkak edhe nuk pyetet për to apo nuk merret në përgjegjësi. Ndërsa lloji i punëve në të cilat njeriu ka zgjidhje dhe i punon me dëshirën e vet, ai do të pyetet për to dhe do të japë llogari për to, duke mos harruar se edhe këto të fundit njeriu i punon vetëm pas dëshirës dhe lejes së Allahut, sepse sikur të mos dëshironte Zoti, as ato nuk do të mund t’i punonte rob. Në këtë pikë nuk dua të zgjerohem më shumë, sepse është një temë mjaft e gjerë dhe që nuk kemi hapësirën e duhur ta konkretizojmë më tepër.

“Janë ngritur lapsat dhe janë tharë letrat (në të cilat është shkruar caktimi-kaderi).”

Kjo fjalë na jep të kuptojmë, se kaderi i gjërave tashmë është i caktuar dhe i shkruar. Lapsat me të cilët është shkruar ai janë ngritur, ngjyra me të cilën është shkruar dhe letra në të cilën është shënuar janë tharë. Kaderi është shkruar pesëdhjetë mijë vite para se të krijoheshin të gjitha krijesat, sipas transmetimeve të sakta të haditheve.

“Njiu tek Allahu (me adhurim) në lehtësi do të njohë Ai në vështirësi.”

Ky është një rregull mjaft i qartë për të gjithë njerëzit, pra, nëse dëshiron që Allahu të të njohë dhe të ndihmojë, atëherë kur je në vështirësitë më të mëdha duhet edhe ti ta njohësh Atë kur je në lehtësi. Kjo që

përmendet në këtë hadith u vërtetua në rastin e Junusit, *alejhi selam*, dhe të Faraonit, ku i pari ishte i njohur tek Allahu me adhurim në kohë të mira, mirëpo kur ai hyri në vështirësi, atëherë Allahu iu përgjigj në çastet e tij më të vështira, pikërisht kur ai ishte në barkun e peshkut. Kurse me Faraonin ndodhi e kundërta, ai nuk e njihte Zotin e vet në lehtësi e atëherë kur kërkoi ndihmë nga Allahu gjatë vështirësisë së mbytjes në ujë Ai nuk iu përgjigj, pra, nuk e njohu.

“Dije se ndihma vjen pas sabrit”

Nuk ka ndihmë e fitore pa sabër, e sabri është veti e burrave. Ajo krijohet në zemrën e njeriut pasi ai të kalojë shumë peripeci me vendosmëri dhe bindje në fitore. Me sabër në adhurim fitohet xheneti, me sabër në lexim fitohet dija, me sabër ndaj armikut fitohet beteja, me sabër ndaj lezeteve të dynjasë fitohet lufta ndaj shejtanit. Pra, kushdo prej nesh duhet ta ketë të pjekur në kokën e vet, se kurrfarë ndihme nuk vjen pa sabër, gjithashtu ndihma vjen veç pas telasheve, sepse po të mos kishte telashe, atëherë as nuk do të kishte nevojë për sabër.

“Fitorja vjen pas sprovës dhe pas çdo vështirësie vjen lehtësimi.”

Më lart përmendëm se ndihma vjen pas sabrit, gjithashtu përmendëm se ndihmës i paraprin zakonisht sprova, sepse sikur të mos kishte provë njeriu, nuk do të kishte nevojë për sabër. Pra, ajo që u përmend më lart vërehet shumë qartë në këtë pjesë të hadithit, në të ceket se fitorja vjen pas sprovës, gjë e cila duhet ta stimulojë besimtarin, që kur ta godasë ndonjë provë të mos mërzhitet, përkundrazi fillimisht duhet të bëjë sabër e pastaj të shpresojë në fitoren sa më të shpejtë. Dhe pas çdo vështirësie duhet ta dijë se vjen lehtësimi. Sado që sprovat dhe vështirësitë të shtohen, aq më afër është fitorja dhe lehtësimi. Sa më shumë që njeriut fillojnë t’i shtohen sprovat, atëherë fillojnë t’i humbin shpresat nga njerëzit, gjë e cila e lidh

shpresën e vet vetëm me Allahun, ku si shkak i saj është edhe ndihma e shpejtë e Zotit, sepse prej kushteve të fitores është edhe t'i këpusësh shpresat nga çdokush tjetër dhe të lidhesh me Allahun.

Pra, këto ishin këshillat, të cilat Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ia ka dhënë Ibën Abasit. Fakti pse Resulullahu e zgjodhi këtë djalë të ri për këto këshilla kaq madhështore na jep të kuptojmë, se çdo udhëheqës fetar dhe çdo prind duhet t'ia ngulisë në zemër fëmijëve të tij këto fjalë, duke ia shndërruar ato në pjesë të besimit. Pra, të gjithë të rinjtë duhet të kenë dije rreth ruajtjes së kufijve të Zotit, rreth kaderit, të mbështetjet dhe të kërkojë ndihmë vetëm nga Allahu, Atij t'ia kushtojë adhurimin, kur është në lehtësi dhe ta dijë se ndihma vjen me sabër dhe ajo vjen pas çdo sprove, si dhe çdo vështirësi pas vetes sjell lehtësimin. Nëse të gjitha këto i rrënjosim në zemrën e çdo të riu, atëherë pa dyshim ai djalosh në jetën e tij do të jetë më i përgatitur për çdo sfidë të saj dhe i gatshëm në çdo kohë që të sakrifikojë për Allahun.

Sa i përket shkakut pse Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, zgjodhi një djalosh për këto këshilla kaq madhështore, duke mos ia thënë ato dikujt tjetër më të vjetër se ai; ndër urtësitë që do të veçonim është fakti se Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, mësoi një të ri, të cilit këto këshilla do t'i duheshin në jetë. Ato kanë të bëjnë me jetën e një besimtari dhe meqë janë madhështore duhet t'i mësoheshin çdo të riu, që t'i ketë si çelës për jetën e tij dhe peripecitë me të cilat do të ndeshet në të ardhmen. Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, gjithashtu duke i dhënë këtij djaloshi këto këshilla na jep të kuptojmë, se mësimet të tilla duhet t'i jepen njerëzve në rininë e tyre, ku përmes kësaj mësimesh këta të rinj do të burrërohen dhe do të kaliten për të ardhmen, e cila është në duart e tyre.

Raste të ngjashme me të Ibën Abasit, *radijallahu anhu*, në historinë profetike kemi shumë, ku i Dërguari i Zotit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i mësonte dhe i këshillonte të rinjtë, të cilët më vonë do të bëheshin bartës të mësimëve profetike dhe udhëheqës të umetit. Ai, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i tregoi Muadh ibën Xhebelit në rininë e tij, se çfarë haku ka Allahu ndaj robërve të Vet dhe çfarë haku kanë ata ndaj Zotit. Enes ibën Malikut që në fëmijëri i tregonte shumë fshehtësi dhe punë të rëndësishme, të cilat nuk ia ka treguar as edhe sahabëve të mëdhenj, e kishte raste kur Enesi pyetej nga nëna e tij se çfarë pune kishte kryer për Profetin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e ai ja kthente se nuk mundej të tregonte, ngase është një e fshehtë mes tij dhe të Dërguarit. Pra, e edukoi ta mbajë fjalën dhe të mos e zbulojë fshehtësinë e tjetrit.

Abdullah ibën Omerin, *radijallahu anhu*, e mori në betejën e Uhudit akoma pa i mbushur të njëzetat. Urame ibën Zejdin e caktoi komandant suprem në një ekspeditë nën komandën e të cilit ishin edhe sahabet më të mëdhenj të asaj kohe, i cili edhe pse vdiq Profeti nuk u zbraps e as nuk u demoralizua nga një fatkeqësi e tillë e kështu ta humbte betejën, por përkundrazi vazhdoi përpara derisa korri fitore.

Raste të tilla në historinë profetike ka shumë, përmes të cilave vërehet qartë se Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i kushtonte shumë rëndësi rinisë, edukimit të tyre, mbjelljes së akides së pastër në zemrat, vetëdijesimit të tyre, i burrëronte ata me veti nga më madhështoret, duke e ngritur vetëdijen tek ta përtej viteve dhe moshës në të cilën jetonin. Kjo mënyrë edukimi ishte shumë e suksesshme, ku si pasojë e saj shumë djelmosha u bënë në të ardhmen njerëz të mëdhenj, udhëheqës të umetit dhe historia e tyre ruhet e gjallë edhe sot e kësaj dite. ■

EMIRATET E BASHKUARA ARABE (U. A. E.)



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Emri i plotë: Emiratet e Bashkuara Arabe

Kryeqyteti: Abu Dhabi.

Sipërfaqja: 83,600 km².

Banorët deri më 2006 : 4,621,399

Përqindja vjetore e rritjes së banoreve (2000 - 2005): 1.7 %

Përqindja e muslimanëve (vendasve): 100 %.

Gjuha: Arabe.

Monedha: Dërhem i Emirateve. (AED)

Pavarësia: 2 Dhjetor 1971 (Ishte nën protektoratin e Britanisë së Madhe)

Anëtar i Kombeve të Bashkuara: 9 Dhjetor 1971

Anëtar i Konferencës Islamike: 1972.

SHKRUAN: DRITON LEKAJ

ato janë: Imareti (principata) i Abu Dhabit, Dhabit, Sharikas, Ras Al Hajmanit, Axhman, Umul Kajejin dhe Fuxhejres.

Ana Gjeografike:

Emiratet e Bashkuara Arabe është një shtet arab në lindje të Gadishullit Arabik dhe në perëndim të kontinentit aziatik. Emiratet gjenden mbi bregdetin jugor të gjirit arabik. Ata kanë kufij detarë në veri-perëndim me Katarin, në perëndim me Arabinë Saudite dhe në jug-lindje me Sulltanatin e Omanit. Emri emiratet (principatat) rrjedh nga shtatë emiratet të cilat formuan mes tyre unionin e

Ana Historike:

Islami ka arritur në Emirate gjatë jetës së Pejgamberit *sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem*. Pas përfundimit të luftërave të *Rides*, Halid ibën Velidi u nis nga ky vend për çlirimin e Irakut dhe të vendeve të tjera.

Emiratet e Bashkuara Arabe bashkëkohore konsiderohen si pjesë e krahinës, e cila historikisht njihet me emrin “Oman” dhe sot përfshin Sulltanatin e Omanit dhe

Emiratet. Kjo krahinë ka përjetuar shumë ngjarje gjatë historisë së saj. Gjatë paqes, përvoja detare e banorëve të saj si dhe flota e tyre ka pasur ndikim të madh në zhvillimin e tregtisë mes shteteve që kishin dalje në Oqeanin Indian, qofshin ato nga Azia, Afrika apo Evropa, duke përdorur rrugët e njohura tregtare, gjithashtu kjo ka qenë edhe një nga shkaqet e luftërave në këtë zonë.

Në vitin 1968 Britania e Madhe pas një pranie të gjatë në ato brigje vendosi të tërhiqet nga Gjiri Arabik. Më parë Britania e Madhe kishte marrë nën protektorat emiratet e atëhershme. Kjo tërheqje u mundësoi emirateve të bashkoheshin nën një sistem federal e që u realizua në vitin 1971. Themelues i këtij unioni ishte Zajid ibën Sultan Ali Nehjan, i cili edhe i udhëhoqi Emiratet deri më 2 Nëntor 2004 kur edhe vdiq.

Ana politike:

Sistemi i qeverisjes në Emiratet e Bashkuara Arabe është federal dhe udhëhiqet nga kushtetuta, e cila u firmos më 2 Dhjetor 1971 nga gjashtë emirate përveç asaj të Ras Al Hajmes, e cila iu bashkua asaj më 10 Shkurt 1972. Kushtetuta e atëhershme ishte e përkohshme gjersa u mbështet përfundimisht me disa përmirësime në vitin 1996.

Kryetari i Emirateve zgjidhet nga Këshilli Suprem i Federatës dhe zakonisht është nga familja Ali Nehjan – familja udhëheqëse e Abu Dhabit dhe nënkryetari zgjidhet zakonisht nga familja Maktum - familja udhëheqëse e Dubait.

Këshilli Suprem Federal konsiderohet organi më i lartë legjislativ dhe ka si detyrim përcaktimin e politikave të përgjithshme dhe nxjerrjes së ligjeve federale. Ky këshill përbëhet nga udhëheqësit e shtatë emirateve.

Gjithashtu ekziston edhe Këshilli Kombëtar, i cili përbëhet nga 40 anëtarë nga

“Emiratet të cilat formuan mes tyre unionin e ato janë: Imareti (principata) i Abu Dhabit, Dubait, Sharikas, Ras Al Hajmanit, Axhman, Umul Kajevin dhe Fuxhejres...”

shtatë emiratet. Numri i anëtarëve të emirateve vendoset në bazë të numrit të banorëve. Ky këshill e ka rol këshillimor dhe nuk ka ende kompetenca për nxjerrjen e ligjeve. Politika e jashtme e Emirateve dallohet zakonisht për paanshmëri dhe mosndërhyrje në punët e të tjerëve. Emiratet kanë përfaqësitë e veta në shumicën e vendeve të botës përveç Izraelit.

Duhet theksuar se Emiratet e Bashkuara Arabe kanë marrë një qëndrim konstruktiv për çështjen e Kosovës, që nga fillimi, i cili u mishërua me përkujdesjen ndaj refugjatëve të vitit 1999, pastaj investimin në disa projekte zhvillimore dhe me karakter fetar, si dhe u kurorëzua me njohjen e pavarësisë së saj më 14 tetor 2008.

Ana fetare:

Të gjithë banorët e Emirateve janë muslimanë. Në Abu Dhabi është i përhapur medhhebi Maliki dhe në Dubai e në emiratet e tjera është i përhapur medhhebi Hanbeli. Gjithashtu një pjesë e vogël e banorëve janë shiitë, por me këtë statistikë kemi parasysh banorët vendas dhe jo në përgjithësi ata që banojnë aty, sepse në Emiratet banojnë një numër i madh të huajsh, të cilët përbëjnë së paku dy të tretat e banorëve në përgjithësi dhe që i përkasin feve të ndryshme.

Kur flasim për Islamin në Emirate nuk mund të mos ndalemi pak te principata e

¹ Luftërat e Rides: janë zhvilluar gjatë kalifatit të Ebu bekrit kundër atyre që lanë fenë islame pas vdekjes së Pejgamberit sal-lallahu alejhi ue selem apo mohuan disa nga detyrimet e Islamit.

Sharikas (Sharja), një nga emiratet në të cilat ana fetare është më e theksuar. Sharika është përpjekur të mbaj ritmin e zhvillimit me emiratet e tjera, duke mos lënë anash aspektin fetar dhe duke iu përmbyajtur atij në një masë të madhe edhe në arkitekturën e saj. Ajo është e njohur për xhamitë e saj të bukura dhe me aktivitetet e shumta fetare islame. Gjithashtu Sharika ka një qytet universitar, që ngërthen në vetvete shumë institucione arsimore dhe qendra hulumtuese, por më të njohurat janë: Universiteti Amerikan i Sharikas dhe Universiteti i Sharikas. Sharika udhëhiqet nga familja Al-Kavasim, e cila është një ndër familjet më të vjetra aty.

Edukimi dhe Arsimi në Emirate

Që nga zbulimi i naftës dhe fillimi i periudhës së zhvillimit shteti i Emirateve i kushtoi rëndësi të posaçme arsimit. Shteti u tregua bujar kundrejt çdo projekti, i cili kishte si qëllim ngritjen e cilësisë së arsimit, kështu që u rrit gradualisht një brez i shkolluar mirë dhe i aftë.

Rëndësia e arsimit për këtë vend del në pah po të kemi parasysh, se kur u themeluan Emiratet më 1971 ata që dëshironin të vazhdonin studimet detyroheshin të dilnin jashtë vendit, sepse në Emirate arsimi më i lartë ishte ai i mesmi.

Mu për këtë shteti investoi shumë në ndërtimin e infrastrukturës së arsimit, kështu që u themeluan shkollat dhe universitetet në të dyja sektorët, në atë qeveritar dhe atë privat. Sot Ministria e Arsimit dhe e Edukimit ka plane të reja për ngritjen e

nivelit të arsimit në nivelet dhe kriteret më të larta ndërkombëtare, që të jenë në përputhje me strategjinë e re kombëtare. Mjafton të përmendet se 30 % e buxhetit të shtetit në vitin 2007 u caktua për arsimin.

Ekonomia:

Emiratet konsiderohen një nga shtetet më të pasura arabe, si dhe radhitet e dyta pas Arabisë Saudite. Të ardhurat personale janë shumë të larta. Emiratet janë një nga shtetet që ekonomia e tyre mbështetet kryesisht në naftën dhe derivatet e saj. Por kohët e fundit Emiratet janë duke zhvilluar ekonominë e saj, duke pasur si qëllim që të mbështeten sa më pak tek nafta. Qyteti i Dubait konsiderohet qendra kryesore financiare e Emirateve, si dhe e shteteve të Gjirit Arabik në tërësi. Ai konsiderohet gjithashtu si një ndër qendrat financiare kryesore në botë dhe është qyteti më i shtrenjtë arab. Vlen të përmendet se Emiratet kanë shkallën më të lartë të të pasurve në botë, ku numri i milionerëve ka kaluar shifrën e 75 mijë personave e që kap përqindjen rreth 8.8 %.²

Në Emirate kanë lulëzuar edhe industri të tjera krahas industrisë së naftës dhe gazit natyror, sikurse prodhimi i aluminit, industrisë ushqimore dhe asaj të rrobave. Emiratet gjithashtu eksportojnë prodhime bujqësore, si pemët dhe perimet duke i shtuar kësaj edhe industrinë e peshkut. Emiratet tashmë konsiderohen si një ndër vendet më tërheqëse turistike dhe si shkak kryesor është lehtësitë që ofrojnë në shërbimet hoteliere, sportive etj., të cilat janë të një niveli të lartë. ■

² Disa departamente qeveritare dhe shoqëria civile në Emirate i drejtojnë kritikën e tyre herë pas here ndaj të pasurve në Emirate, duke i ftuar që të shpenzojnë një pjesë të pasurisë së tyre në bamirësi dhe programe me karakter social. Departamenti i planifikimit dhe i ekonomisë së Abu Dhabit njofton se humbja rrolit bamirës dhe shoqëror i të pasurve dhe firmave private në Emirate ka arritur përqindjen më të lartë diku aty te 99 %. Për shkak se ky rol nga të pasurit po vjen në rënie shumë shoqata bamirëse detyrohen të ndajnë 25 % të buxhetit të tyre për publicitet. Sidoqoftë mbetet shpresa se po të ekzistonin programe të organizuara për donacione do t'i përgjigjen një pjesë e mirë e të pasurve. (<http://www.aljazeera.net/NR/exeres/326DB1D2-22DC-417A-92C6-9F0438889EAB.htm>)


RREZIKU QË NA KANOSSET NGA FILMAT VIZATIMORË

PËRGJIGJET: BEKIR HALIMI

Pyetje: Kohëve të fundit filmat vizatimorë janë përhapur shumë, brendia e tyre është e ndryshme, disa prej tyre kanë edhe defekte në fushën e besimit, e të tjerët kanë defekte në fushën e moralit, madje edhe kanë ndikim psikologjik negativ te fëmijët. Cilat mënyra duhen përdorur për të ruajtur fëmijët tanë nga këta filma vizatimorë, duke pasur parasysh varshmërinë e fëmijëve nga këto filma, dhe cilat janë alternativat e mundshme. Ju lutem më jepni përgjigje?

Përgjigje: Allahun e falënderojmë, paqja dhe bekimi qofshin mbi Muhamedin, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Si përgjigje të kësaj pyetje mund të themi:

Një: S'ka dyshim se filmat vizatimorë ndikojnë shumë te fëmijët, ky ndikim vjen e shtohet me zhvillimin e teknologjisë dhe kinematografisë dhe në mungesë të elementeve të refuzimit tek fëmijët, siç janë pjekuria, logjika e zhvilluar dhe besimi i fuqishëm. Kinematografia ka arritur një nivel shumë të lartë dhe shkakton ngasje të madhe dhe të fuqishme jo vetëm te fëmijët, por edhe tek të mëdhenjtë. Nëse i pyesim ata që i kanë përcjellë këto filma vizatimorë në kohën e fëmijërisë do t'i tregojnë të gjitha ato me shumë hollësi.



Një studim i bërë nga një studiuese muslimane në vitin 2006 mbi ndikimin e filmave të vizatuar tek fëmijët mes të tjerave nxjerr në pah këto të vërteta:

Filmat vizatimorë të prodhuar nga jomyslimanët ndikojnë negativisht në besimin e fëmijëve muslimanë, për shkak se zotërojnë ide të devijuara, të cilat e luhatin

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në revista@albislam.com

besimin e fëmijëve, prandaj na duhet të bashkojmë forcat për përmirësimin e kanaleve televizive dhe satelitore për të ruajtur fëmijët tanë.

Sipas këtij studimi meshkujt e moshës tre vjeçare dhe vajzat e moshës pesë vjeçare kanë varshmëri të lartë nga televizori dhe kjo moshë është mosha më e rrezikuar nga mediet dhe ndikon negativisht në zhvillimin e fëmijës, ndërtimin e mendimeve dhe besimit të tij.

Ky studim konstaton se një përqindje e lartë e nënave nuk janë të vetëdijshme për rolin e filmave vizatimorë në mbjelljen e besimit të shëndoshë apo të gabuar, saqë 75 % e tyre nuk besojnë se filmat vizatimorë ndikojnë në formulimin e besimit tek fëmija. Kjo tregon nevojën e madhe që kemi për të rindërtuar atë që shikon fëmija jonë në ekranet televizive, meqë roli i filmave vizatimorë është shumë i madh në ndërtimin e imagjinatës së fëmijës, gjë e cila prodhon bindjet e tij, të cilat mund të jenë shumë të rrezikshme për psikologjinë e fëmijës.

Dy: Ata që kanë në dorë menaxhimin e medieve duhet të kenë frikë Allahun dhe të kontribuojnë me këtë mjet të komunikimit masiv për të mbjellë një besim të shëndoshë dhe vlera morale tek fëmijët tanë, e jo të bëhen kontribuues për shkatërrimin e shoqërive, përhapjen e imoralitetit, dhunës, abuzimit etj. Ata nuk mjaftohen me lloj-lloj serialesh dhe gjërash, që i prishin të rriturit, por kontribuojnë edhe për prishjen e fëmijëve.

Tre: Ata muslimanë që posedojnë media, ata që posedojnë studio, hoxhallarët, intelektualët, shkrimtarët, të gjithë këta duhet të kontribuojnë për të ofruar alternativa për fëmijët muslimanë, që të mos kenë nevojë për këta filma vizatimorë të rrezikshëm. Alternativa është e llojllojshme, prej tyre mund të jenë:

Prodhimi i filmave vizatimorë me domethënie islame ose përkthimi dhe dublimi i filmave të ndryshëm vizatimorë, që kanë porosi dhe mesazhe të mira dhe në përputhje me mësimet islame.

Në lidhje me këtë, e kanë pyetur **dijetarin Ibën Uthejmin**: “Kohëve të fundit janë shfaqur disa filma vizatimorë, që i quajnë islamë, siç është “Çlirimi i Konstandinopojës”, “Udhëtimi i paqes”, “Djaloshi besimtar”, i cili përmendet në suren Buruxh, apo në hadithin që e përcjell Imam Muslimi në Sahihun e tij. Këto filma vizatimorë i llogarisin si alternativë të filmave vizatimorë me ndikim negativ. Hoxhë i nderuar, cili është vendimi juaj për këto filma vizatimorë?

Ai u përgjigj: **Unë mendoj se këto filma vizatimorë nuk kanë ndonjë të keqe, sepse realisht, sikurse edhe e parashitrova në pyetjen tënde, ato i mbrojnë fëmijët tanë nga gjërat e ndaluara, prandaj ajo që mund të themi më së paku, nëse marrim mendimin e ashpër është se kjo gjë është më e lehtë se filmat e tjerë vizatimorë, ato që sikurse kemi dëgjuar fusin dyshime mbi besimin, personifikojnë Zotin, Zoti na ruajt, e gjëra të tjera të ngjashme... sidoqoftë mendoj se nuk ka ndonjë të keqe në to...”. (Shih: “Likaul Babil Meftuh”, 127, pyetja nr. 10).**

Përzgjedhja e disa programeve kulturore dhe edukative, të cilat grumbullojnë gjërat e këndshme argëtuese dhe arsimimin. Këso programesh ka shumë. Programe që flasin për botën e oqeanëve, për botën e kafshëve etj.

Angazhimi i fëmijëve me programe shëndetësore të dobishme, sikurse është sporti, noti dhe lojërat e tjera të lejuara. Angazhime që përfshijnë në vetvete, edhe dëfrimin, edhe përfitimin.

Përcjellja e disa ueb faqeve të dobishme, ku ka seksione që kujdesen për fëmijët, ku

paraqiten *fleshe* të dobishme, lojëra argëtuese, filma vizatimorë me bazë jetën e pejgamberëve, betejat islame etj.

Duhet pasur kujdes ne nuk duhet të sillemi me fëmijët tanë sikurse sillemi me të mëdhenjtë. Ne duhet t'u mundësojmë fëmijëve, që të ngopin kureshtjen e tyre, të lozin, të dëfrehen, mirëpo jo t'i lëmë ata tërësisht pa kontroll, e të bien në kundërshtime fetare. Ne duhet t'i kontrollojmë fëmijët, që mos të na shndërrohen në njerëz të prishur dhe prishës të të tjerëve, prandaj të gjithë ne duhet të mobilizohemi dhe të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin, që t'u ofrojmë fëmijëve materiale sa më të mira dhe tërheqëse.

Në lidhje me prodhimin e materialeve islame për fëmijë studimi në fjalë jep edhe disa sqarime në këtë drejtim, aty i gjejmë edhe këto sugjerime: prodhuesit e programeve për fëmijë duhet të ikin nga pamjet që shkaktojnë frikë dhe trishtim te fëmija, sepse është në një moshë ku psikologjikisht është i përgatitur të bjerë nën ndikimin e këtyre gjërave, meqë fëmija prej moshës dy vjeçare e deri në moshën pesë vjeçare frikësohet nga vetmia, nga zjarri, nga kafshët, nga gjërat imagjinuese, siç është lugati, djalli, dragoi etj. Pamja e këtyre sekuecave nga fëmijët shkakton humbje të baraspeshës psikologjike tek ata.

Këto programe sipas studimit duhet të kujdesen edhe për mbjelljen e vlerave dhe mos të japin doza të mëdha të qarjes, sepse në këtë formë ndihmojmë në ndërtimin e një personaliteti të dobët, i cili nuk mund të mbartë vështirësi. Këto vlera duhen mbjellë në korniza argëtuese dhe me ide optimiste e të lumtura.

Media për fëmijë është shkencë dhe art e nuk është hobi, prandaj duhet të kujdesemi për këtë tërësi shkencore, profesionale dhe artistike, dhe nuk duhet ta teprojmë me

“...meshkujt e moshës tre vjeçare dhe vajzat e moshës pesë vjeçare kanë varshmëri të lartë nga televizori...”

përdorimin e imagjinatës, sepse është një çështje shumë e rrezikshme për mendjen e fëmijës.

Katër: Veprimet që duhet të ndërmarrin prindërit për të ruajtur fëmijët nga këto sulme janë:

1- Mësoji fëmijës Kuranin dhe shfrytëzoje moshën fëmijërore për të nxënë përmendësh, sa më shumë nga Kurani.

2- Edukoje fëmijën që ta dojë Pejgamberin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, shokët e tij fisnikë, duke iu lexuar biografinë e tyre në forma të përshtatshme për moshën e vogël.

3- Mësoja disa gjëra nga besimi i pastër Islam në formë të thjeshtë dhe të lehtë, aq sa mund ta kuptojë mendja e fëmijës, sikurse është fakti se Allahu është Një, se Atë duhet ta duam, prej Tij duhet të shpresojmë, Atij duhet t'i frikësohemi, Ai është Krijuesi, Furnizuesi etj.

4- T'i edukojmë të mohojnë të keqen, ta urrejnë atë, sikurse është gënjeshtria, vjedhja, spiunimi etj., si dhe ta duan të mirën dhe ta përhapin atë.

Pra, këto do të kishin qenë disa veprime, që duhet t'i ketë parasysh çdo prind që dëshiron të mbrojë fëmijën e vet nga rënia nën ndikimin dhe varshmërinë e filmave vizatimorë apo programeve të tjera për fëmijë, të cilët kanë ndikim negativ në edukimin e tyre.

Para së gjithash na duhet të theksojmë brengën që duhet të ketë çdo prind për edukimin sa më të mirë të fëmijëve të vet, zjarrin që duhet të ketë në zemër dhe që

nuk duhet ta lërë rehat aspak, derisa të arrijë suksesin në edukimin e fëmijëve të vet. Allahu e di më së miri.

Pyetje: Në kohët e fundit jemi dëshmitarë të përhapjes së një libri dhe filmi vizatimor me të njëjtin titull Hari Poter. I është bërë një reklamë e madhe këtij filmi dhe thuajse ka depërtuar në çdo shtëpi. Si t'ia bëjmë?

Përgjigje: Allahun e falënderojmë, paqja dhe bekimi qofshin mbi Muhamedin, *salallahu alejhi ue selem*.

Një: filmat vizatimorë modern janë përvjedhur në mendjen e të vegjëlve dhe të mëdhenjve, fatkeqësisht. Ato kanë arritur të bëhen edhe filma të vërtetë për shkak të pranimit shumë të ngrohtë nga miliona njerëz. Shumë njerëz janë bërë të varur nga ndodhitë e këtyre filmave dhe personaliteteve që figurojnë në këto filma. Pjesa dërrmuese e këtyre filmave në brendësinë e tyre kanë besime të ndryshme, që i kundërvihen besimit Islam, i sjellin në dyshim premisat dhe besimet islame, përhapin sjellje të çoroditura, kanë brenda tyre tregime dashurie dhe epshi.

Prania e këtyre filmave vizatimorë në shtëpitë e muslimanëve dhe kalimi i një kohe të madhe i fëmijëve muslimanë duke i shikuar është një fatkeqësi e madhe.

Dy: Nga tregimet që kanë sjellë fitne të madhe në botë është edhe romani Hari Poter i autores **Xhoan Kethlin Rouling**, që në përmbajtjen e vet ka personazhin Hari Poter i lindur nga dy prindër magjistarë, të cilët i ka vrrarë një magjistar i keq, mirëpo nuk ka arritur të vrasë edhe djalën e tyre Hari Poter, e kur ky djalosh mbush të njëmbëdhjetat e kupton se edhe vetë është magjistar. Pastaj vazhdon vargu i ndodhive që kanë të bëjnë me magjitë, besëtytnitë dhe imagjinatën. Janë shitur me miliona kopje dhe është përkthyer edhe në mbi gjashtëdhjetë gjuhë të botës. Defektet që shfaq ky roman dhe që

janë në kundërshtim me rregullat e Fesë Islame janë këto:

- Tregimi ofron si shembull për një të ri Hari Poterin, d.m.th. një magjistar, kurse Feja Islame paraqet një shembull tjetër, i cili është në kundërshtim të plotë me këtë shembull.

- Ata në mungesë të personaliteteve të dobishme dhe për të mbushur boshllëkun e brendshëm që kanë shpikin heronj si Supermeni, Betmeni, Herkuli, për të zbavitur fëmijët dhe për t'u ofruar personalitete që ndryshojnë botën dhe shembin kodrat në mënyrë shumë të shpejtë dhe të lehtë. Kjo tregon paaftësinë e tyre për të ofruar shembuj të vërtetë dhe realë, të cilët duhet të tërheqin fëmijët e tyre.

- Ofrohet magjistari si shpëtimtar nga të gjitha vështirësitë e pakalueshme dhe problemet e pazgjidhshme, kurse magjistari për një çast me një fjalë magjike e zgjidh problemin, gjë e cila padyshim krijon te fëmija një defekt të madh në fushën e besimit, sepse vetëm Allahu është Ai që në Dorën e Tij është zgjidhja e të gjitha problemeve dhe kalimi i të gjitha vështirësive.

Allahu, *subhanehu ue teala*, thotë: ***“Nëse Allahu të godet me ndonjë të keqe, s’ka kush që ta largojë atë pos Tij, e nëse të dhuron ndonjë të mirë, duhet ditur se Ai është i gjithëfuqishëm për çdo send. Ai është mbizotërues ndaj robërve të Tij. Ai e di***

“Media për fëmijë është shkencë dhe art e nuk është hobi, prandaj duhet të kujdesemi për këtë tërësi shkencore...”

hollësisht punën e Tij dhe të robërve të Vet". (Enam: 17-18).

Të gjitha fetë dhe të gjithë peygamberët kanë treguar pozicionin negativ, që kanë magjistarët në shoqëritë ku ata jetojnë, kjo dëshmohet edhe sot në shumë shoqëri, mirëpo këto tregime krijojnë një pasqyrë tjetër për magjistarët, saqë secili të dëshirojë të bëhet magjistar!!

- Perëndimi e zhvillon jetën e vet duke patë si epiqendër njeriun, përfitimin dhe dobitë e tij, kurse Feja Islame na mëson se epiqendra e mendimit të njerëzve duhet të jetë arritja e kënaqësisë së Allahut. Respektimi i Allahut është epiqendra e jetës së njeriut. Këtë na e mëson Allahu, Famëmadh, kur thotë: ***"Thuaj: "Namazi im, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve"***". (Enam: 162).

Tregimi i Hari Poterit na ofron një personazh, i cili i bën të gjitha ato mrekulli në bazë të magjisë dhe për t'u sjellë njerëzve përfitime, kurse asnjëherë nuk mund të jetë legjitime madje as legale largimi i të keqes me të keqe.

- Tregimi në thelb trishton dhe shkakton llahtari në mendjen e fëmijëve, meqë paraqet imagjinata djallëzore, qarkullimin e tyre në kanalizime, tualete, vende të ndyra, etj., gjithmonë sipas romanit, kurse natyra e pastër e njeriut e refuzon një jetë të këtillë dhe i largon fëmijët nga këto pamje trishtuese dhe tmerruese për ata. Kjo mund të kuptohet edhe si një parapërgatitje për të arritur me njerëzit deri tek adhurimi i djallit.

- Ky roman e paraqet magjistarin, si një njeri, i cili mund të ngjallë dhe vdesë dikë. Ky është një defekt i qartë në formulimin psikologjik dhe ideologjik të fëmijëve tanë, të cilët Kurani Fisnik i mëson se: ***"Zoti që më krijoi, Ai më udhëzon mua. Dhe Ai që më ushqen dhe më jep të pijë. Dhe kur të***

sëmurem Ai më shëron, Ai më bën të vdesë e mandej më ngjall, Ai tek i cili kam shpresë se do të m'i falë mëkatet e mia në Ditën e Gjykimit"". (Shuara: 78- 82).

- Perëndimi nuk e edukon fëmijën që t'ia mbushë zemrën me dashuri ndaj Allahut dhe dëshirën për ta adhuruar Atë, por kujdeset për ta argëtuar dhe për ta befasuar me gjëra të çuditshme, prandaj edhe shohim se ato rriten si materialistë dhe si pragmatistë dhe të shkujdesur ndaj gjërave shpirtërore, larg prej çështjeve të zemrës dhe të vërtetave të gjithësisë.

Tre: Ligji Islam i ndalon librat e fallit dhe të magjisë, kurse ky vendim nuk bën dallim mes leximit dhe shikimit, meqë filmi është realizim praktik i asaj që shënohet në libër. Të gjithë dijetarët muslimanë ua kanë ndaluar muslimanëve leximin e librave që flasin për mënyrën si bëhet magjia dhe mësimin e magjisë, sepse magjia e shpie njeriun në mosbesim.

Si përmbledhje e tërë kësaj mund të themi, se nuk i lejohet muslimanit të blejë romanin Hari Poter e as shikimin e filmit vizatimor me të njëjtin emër, për shkak të ndikimit të madh që mund të ketë në besimin dhe sjelljen e atij që e shikon këtë film vizatimor apo e lexon atë roman.

Shtojcë: Në këtë përgjigje kemi sjellë si shembull filmin vizatimor me emër Hari Poter, mirëpo ka edhe shumë filma të tjerë vizatimorë që kanë të njëjtat defekte, ndoshta edhe më të rrezikshme për mendjen dhe besimin e fëmijës. Për këtë shkak çdo prindër duhet të jetë shumë i kujdesshëm në lidhje me këtë temë dhe duhet të zotërojë kulturë të gjerë në këtë drejtim dhe të dijë se për çfarë bëhet fjalë në filmat vizatimorë, që i ofrohen fëmijëve tanë nëpër kanalet televizive, satelitore apo kablovike, madje edhe nëpërmjet dvd-ve. Allahu e di më së miri. ■



HERONJ DHE HEROIZMA

Historia islame është e mbushur plot me shembuj të heronjve muslimanë. Veprat dhe fjalët e tyre i vulosi koha dhe mbetën si yje që shndrisin rrugën e bijve të këtij umeti. Në vijim do të përmendim disa raste dhe disa fjalë të këtyre kolosëve.

PËRGATITI: AGIM BEKIRI

Musa ibën Nusajri dërgon njërin prej robërve të tij të quajtur Tarik ibën Zijad për të çliruar Andaluzinë. Ashtu edhe ndodhi. Ky i fundit nisi çlirimin qytet pas qyteti derisa tha: Pasha Allahun sikur të më bindeshin arabët do të arrija deri në Romë dhe ta çliroj atë me ndihmën e Tij. Musa ibën Nusajri pas çlirimit i rrëfeu udhëheqësit të besimtarëve Sulejman ibën Abdulmelikut: “Tarik ibën Zijadi hyri në betejën Vadi Luka, e cila zgjati një javë derisa e çliruan përfundimisht të tërë Andaluzinë. U zhyt me atin e tij në det dhe tha: O udhëheqës i besimtarëve, pasha

Allahun nuk devijoj nga qëllimi im derisa të arrij në oqeanin Atlantik.”

Prej komandantëve që krijuan historinë e myslimanëve është Ebu Seid Xheradetul Safra. Imam Dhehebiu na tregon për të: Ai ka kryer shumë heroizma kundër romakëve. Ai në fakt ishte edhe më meritori për kalifat se vëllezërit e tij. Çliroi Saifen dhe shumë kështjella të tjera, kurse romakët i dëboi në skaj të botës. Gratë kur dëshironin t'i heshtnin fëmijët e tyre ua përmendnin emrin e tij.

Emra të mëdhenj muslimanë, që u bënë sinonim i arritjeve të mëdha çlirimtare dhe që ndryshuan rrjedhën e historisë janë të shumtë, sa që nuk na lejon hapësira e kësaj rubrike për t'i përmendur veprat dhe emrat

e tyre. Më të spikaturit janë: Numan ibën Mukrin Muzeniu, Hasan ibën Numan Ezdiu, Kutbudin Meududi, Nurudin Zenkiu, Esedudin Shirko, Salahudin Ejubi, Nexhmudin Ejubi, Sejfudin Kutuz, Bibris Bunekdari, Abdurahman Dahili, Kutejbe ibën Muslimi, Muhamed ibën Kasimi, Abdurahman Gafikiu, Jusuf ibën Tashefini, Muhamed Fatihu dhe shumë të tjerë.

Disa fjalë të heronjve:

-Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit. Prej Halid ibën Velidit deri të mbretërit persianë: Falënderimi i takon Allahut, që e uli sistemin tuaj, mposhti kurthin tuaj, futi mes jush përçarjen dhe sikur të mos e kishte bërë një gjë të tillë me ju do të ishte sërish keq për ju. Hyni në fenë tonë ju lëmë të qetë juve dhe tokën tuaj pastaj kalojmë te të tjerët. Ndryshe do të bini në duart e një populli, të cilët e duan vdekjen aq sa ju e doni jetën.

-Ukbe ibën Nafi Fihriu, komandant i njohur musliman. Historia e ka regjistruar si çliruesin e Afrikës Veriore prej Tripolit deri në Malijan buzë oqeanit. Kur e pa oqeanin tha: O Zoti im! Sikur të mos ishte ky oqean do të ecja përpara në rrugën tënde! Pastaj tha: O Allah, dëshmo se e dhashë tërë mundin dhe sikur të mos ishte para meje oqeani do të ecja si luftëtar në rrugën Tënde për t'i luftuar të gjithë ata që të mohojnë, derisa të mos mbetet asnjë që adhuron dikë tjetër përpos Teje.

-Zuhej ibën Kajs Beleviu, komandanti i betejës së mirënjohur Mumis, pasi mposhti shumë ushtri dhe çliroi shumë vende të Afrikës që hynë nën mbretërinë e tij tha: Unë erdha këtu vetëm për xhihad, kam frikë që të lëshohem në kënaqësitë e kësaj bote dhe pastaj të shkatërrohem.

-Musa ibën Nusajr Lahmiu kur deshi që të vazhdojë me çlirimet e mëtejshme dhe njerëzve që ishin me të kjo gjë iu duk e

“O Allah, dëshmo se e dhashë tërë mundin dhe sikur të mos ishte para meje oqeani do të ecja si luftëtar në rrugën Tënde...”

vështirë iu tha atyre: Pasha Allahun, sikur të më bindeshin do t'i dërgoja deri në Romë, që Allahu ta çlirojë atë me duart e mia.

Ky komandant deshi që të arrijë në Lindje nëpërmjet Kostandinopojës, pastaj në Sham, pastaj në Andaluz, të kalojë nëpërmjet popujve të krishterë joarabë dhe të arrijë te muslimanët. Sipas kësaj ai dëshironte të çlirojë të gjithë shtetet e Evropës dhe të arrijë në Turqinë e Sotme, pastaj në Siri, pastaj në Mauritani, pastaj në Andaluz.

-Kur Musa ibën Nusajri e lajmëroi Tarik ibën Zijadin, se Velidi ia kishte dhuruar atij Andaluzinë, ai nuk u mahniti me këtë post, por tha disa fjalë që s'i harron historia: O udhëheqës i besimtarëve, pasha Allahun, nuk e ndryshoj qëllimin tim derisa të arrij në oqean dhe të zhytem me atin tim.

Po e përfundojmë këtë shkrim të shkurtër me disa fjalë të Muhamed Fatihut. Shumë raste të këtij udhëheqësi që janë shënuar në histori flasin për singëritetin e tij të thellë në Fe dhe bindjen e tij të fortë.

Ai thoshte:

-nijeti im është të zbatoj urdhrin e Allahut: **“Luftoni në rrugë të Allahut”.**

-vullneti im është: të jap mundin tim për t'i shërbyer fesë time.

-vendosmëria ime: t'i mposht jobesimtarët me ushtrinë time.

-meditimi im është: të çliroj dhe të triumfoj me ndihmën e Allahut. ■